Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (165) / 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

Bigmarket
DI ÇFARË ZGJEDH!
NË PESHKOPI
Çdo muaj me
SUPER OFERTA

VLERËSIMI

Profesor Shaban Sinani zgjidhet me vota maksimale si anëtar i Akademisë së Shkencave

Disa ditë me parë u zgjodh edhe si sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave

Cilësi e studimeve të Sh. Sinani është *ndërdisiplinoriteti*. Etnosi shqiptar në trashëgiminë gojore, kodikët e Shqipërisë dhe vendi i tyre në traditën botërore të shkrimeve, *sjelljet etnotipike të shqiptarëve* ndaj të huajve (hebrenjtë, kulturat e vendeve fqinje, kulturat e ardhura me perandoritë ku është përfshirë populli shqiptar), *letërsia në periudhën totalitare* dhe kushtëzimet e saj me traditat dhe autorët më të rëndësishëm të mëhershëm, janë disa prej fushave në të cilat janë ndërthurur dije të albanologjisë nga antropologjia, etnokultura, gjuhësia, historia, burimologjia dhe letërsia.

FAQE 12-13



HISTORI

Vendi i Dibrës në Kongresin e Lushnjës

Nga **PROF. DR. BAJRAM XHAFA** — Faqe 19

HISTORI

Sheh Sula i Zerqanit, kleriku patriot, pjesëmarrës në të gjitha lëvizjet kombëtare të kohës

Nga **HYSEN LIKDISHA** — Faqe 14

HOMAZH

Ndërron jetë Veli Bici, Doktor i Shkencave Filologjike

— Faqe 23


REPORTAZH NGA **DEFRIM METHASANI** / DY DITË PLOT MBRESA FAQE 3

Kënga dibrane jehon në Korfuz...

Dibranët në ishullit të bukur grek kanë bërë emër të mirë me punë, djersë, ndershmëri e sakrifica...

BOTIME

Mysafir i ri në çadër



Nga prof.asoc.dr.
VESEL HOXHA
— Faqe 16-17

PROFIL

Agron Strazimiri, mjeshtri që mban gjallë cirkun në Dibër



Nga **OSMAN XHILI** — Faqe 9

Jeta në Bulqizë mes vdekjeve në miniera dhe padrejtësisë

Nga **GERI EMIRI, SAMI CURRI** | BIRN

Minatorët që vdesin në galeritë e kromit fajësohen shpesh për aksidentet tragjike që u marrin jetën; ndërkohë që të plagosurit dhe familjarët e viktimave përballen me kompanitë minerare dhe ato të sigurimit për dëmshpërblimet si dhe me dyert e gjykatave për drejtësinë e munguar.

FAQE 4-5

cyan magenta yelloë black 1

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (165). Shkurt 2020
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit Mars 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Kamber FARUKU
Ngadhnjim AVDYLI /K.0
Atdhe MULLA /K.0
Geri EMIRI
Enver HALILI
Namir LAPARDHAJA
Bajram XHAFA
Mevlud BUCI
Ilmi DERVISHI
Xhafer MARTINI
Halil RAMA
Arif MURRJA

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Lura dhe feja, disa përkufizime

Nga **HEKURAN VLADI - LURA**



Në foto: Pamje nga Lura / Facebook/Ketumblidhendibranet

1. Ajo që quhet nga tallavaistët e historisë si "harmoni fetare" apo "tolerancë fetare" është togfjalësh pa kuptim.
Lura nuk është Jeruzalemi dhe çështja se si do ta lëmë punën e Biblës me Kuranin, apo të katolicizmit me muslimanizmin nuk vendoset, as nuk vlerësohet në Lurë. Pra, ka qenë e është punë e feve katolike dhe muslimane, jo e lurasve.

2. Togfjalëshi i pakuptimtë i dhënë më sipër duhet zëvendësuar me togfjalëshin "tolerancë njerëzore".
Pra, fakti është, që pavarësisht instalimit të fesë muslimane, lurasit nuk konsideruan fare dasinë që mbillej me këtë rast, pra konfliktin fetar dhe bënë sikur nuk kishte ndodhur asgjë dhe vazhduan të jetonin në paqe dhe harmoni, ose pothuajse në harmoni.

3. Toleranca njerëzore, pavarësisht dasisë fetare ishte kryesisht meritë e shumicës së konvertuar në muslimane.
Lurasit u konvertuan të fundit në Dibër nga katolikë në muslimanë. Megjithatë, lurasit braktisën kishën, por jo besimin e krishterë. E kësisoj, pavarësisht se ishin një shumicë (rreth 85%), kurrë nuk e vunë në përdorim forcën që mund të prodhonte kjo shumicë. Sot e kësaj dite festat kryesore, që festohen janë ato të krishtera.

4. Lura ishte një nga epiqendrat e qytetërimit ilir. Kështu që, kisha romake ishte me rrënjë shumë të vjetra në Lurë.
Mendohet që, 5 nga kishat e para katolike në Ballkan ishin në Lurë. Kështu që, doktrina muslimane e importuar ishte kulturalisht shumë më e dobët se kultura ekzistuese. Për shkak edhe se sekti musliman i instaluar, ai bektashian, ishte shumë liberal, nuk bëhej realisht ndonjë konkurim mes feve, në mënyrë që të kishte konflikt.

5. Toleranca dhe bashkëjetesa njerëzore, pavarësisht feve, në Lurë ishte vërtet unike, por jo për atë arsye që përmendin lart e poshtë tallavaistët e historisë.
Shembuj të tolerancës pavarësisht feve kemi shumë nëpër Shqipëri. Promotori i kësaj ishte rilindja kombëtare shqiptare. At Gjergj Fishta e mbushte me stringla rrugën prej kishës ke xhamia në Shkodër ditën e Bajramit. Etj, etj shembuj domethënës. Por këto ishin vepra dhe sjellje të njerëzve të shkolluar. Në Lurë ishin vepra të krejt popullsisë, e cila ishte në fakt analfabete.

6. Bashkëjetesa pavarësisht dasisë fetare është një fenomen që ka lënë shumë pak gjurmë në trashëgiminë kulturore të lurasve. Deri njëfarë kohe kjo u ndoq me fanatizëm dhe ishte vërtet për t'u respektuar. Ka ndodhe që katoliku nuk e ka mbajtur derrin në shtëpi veç për hatër të bashkëfshatarëve muslimanë dhe ka shkuar puna që familja muslimane e ka ruajtur derrin në shtëpi (disa familje e kanë bërë) dhe katoliku vazhdon të mos e mbajë. Por, siç u tha më lart, toleranca njerëzore nuk është ndjekur si shembull. Ka 20 vjet, që demokratët pinë kafe në lokalet poshtë rrugës dhe socialistët në lokalet sipër saj. Me fjalë të tjera, paraardhësit nuk janë ngatërruar për Krisht e Muhamed, kurse brezat e sotëm ngatërrohen për Fatos e Sali e kollankusur. Ky është një fenomen që do të marrë fund shumë shpejt.

7. Historia nuk është tallava, ajo është shkencë.
Historia e Lurës është pasuri kombëtare. Si e tillë duhet të trajtohet, duke filluar në fillim nga intelektualët lurjanë.

8. Larg duart nga historia e Lurës të gjithë tallavaistët.
Lurasit nuk do të lejojnë që me historinë e Lurës të bëhet gallatë. Do denoncohen të gjitha tallavatë me historinë e Lurës. Ky denoncim fillon që këtu me dy emisionet e Marin Memës dhe Alma Çupit për Lurën, që janë kryevepra të historisë tallava.

Vazhdojnë punimet në rikonstruksionin e rrugës Ceren – Radomirë



Fshati Radomirë është porta hyrëse, për në malin më të lartë të Shqipërisë- Korabi. Pjesë e "100 fshatrave turistike" është një nga zonat më të bukura për nga natyra dhe resurset e saj.

Në vëmendje të veçantë nga Qeveria Shqiptare, përmes programit "Infrastruktura Vendore Rajonale", tashmë është në rikonstruksion të plotë aksi "Ceren – Radomirë".

Rrugë e cila do të përmirësojë aksesin drejt destinacioneve turistike të zonës. Prej "Liqenit të Zi" e deri në harmoninë e lëndinave e përroit të Veleshicës, mund të qëndrosh të përjetosh traditën e bjeshkëve, para se të nisësh ngjitjen për në Korab.

Përmirësimi i infrastrukturës rajonale synon të krijojë një rrjet të mirëfilltë zhvillimi. Duke rritur lëvizshmërinë, nxitur mundësi të reja turizmi aventure (kamping, hiking etj) të cilat do të ndihmojnë ekonominë lokale (punësim për banorët e zonës) dhe rritjen e kohezionit social.

Burimi: Fondi Shqiptar i Zhvillimti

reportazh

Dy ditë plot mbresa dhe një mbrëmje festive

Kënga dibrane jehon në Korfuz...

Nga **DEFRIM METHASANI**

Dibranët në ishullit të bukur grek kanë bërë emër të mirë me punë, djersë, ndershmëri e sakrifica...

Në Korfuz në fakt nuk ishte hera e parë që shkoja, por këtë herë kishte një tjetër qëllim udhëtimi. Së bashku me mikun tim Musa Riçku, njëherësh nënkryetar i LID dhe bashkëshorten e tij Hasien, ishim të ftuar në një mbrëmje të bukur dibrane në një qytet buzë detit, në Sidar, ku jetojnë shumë dibranë së bashku me familjet e tyre.

Trageti ndaloi rreth orës 16-të të së premtes dhe aty një grup miqsh ishin bëre bashkë duke na pritur. Vërtet ndonjëherë të duket se je në tokën dhe shtëpinë tënde, kur dëgjon togfjalëshin: "Mirë se erdhët" që në takimin e parë me ta. Sadik Laçi, Ali Krrashi, Habedin Hasi, Robert Manarkolli dhe mjaft të tjerë na presin në stilin shqiptar dhe pastaj ndalojmë në një kafe ku diskutojmë për itinerarin e lëvizjes dhe qëndrimit tonë. Mbrëmja muzikore është të shtunën në darkë, ndaj pjesë e kohës deri atëherë duhej menaxhuar.

Një vizitë në kalanë e qytetit dhe sheshin më të madh të Korfuzit, ia vlen për të fiksuar kujtimet e para në këtë ishull kaq të vizituar prej turistëve nga e gjithë bota. Më pas afroi mbrëmja dhe darka ish rezervuar tipike si në shtëpitë tona në Dibër tek miqtë tanë që dhurojnë vërtet një respekt të veçantë. Trokitjet e gotave na shoqërojnë dhe sytë e tyre janë të buzëqeshur, sepse secili prej tyre vuan shpirtërisht mungesën e gjuhës shqipe dhe njerëzve të gjakut.

E ndërsa mbrëmja kalon me miqtë tanë, dita e nesërme nis bukur duke u ngjitur në majën më të lartë të Korfuzit, aty ku qëndrojnë të gjitha antenat, qofshin këta të kompanive celulare, por edhe ato të televizioneve e radiove. Shqipëria duket si në pëllëmbë të dorës me Sarandën e bukur që të ngjan me një sy blu. Fotografitë dhe videot shoqërojnë qëndrimin tonë aty në një ditë të bekuar edhe nga Zoti me diellin që shndriste dhe ngrohte si në një ditë pranvere. Musai ecën më shumë se ne të tjerët dhe duket se rikthen rininë e tij.

Më pas bëjmë disa vizita në familjet dibrane në qytet dhe fshatrat e Korfuzit, si



Dy vëllezërit Klodi dhe Eri Bardhi



Një vend të veçantë patën edhe valët dhe nderimi që ju bë atyre që nuk ishin dibranë në sallë, duke respektuar kësisoj edhe një traditë të odës dibrane dhe traditave të saj. Më në fund, këngët e vjetra dhe patriotike e tradicionale ulën këmbëkryq te burrat e asaj mbrëmje duke rikthyer kohët e dikurshme dhe duke i kënduar së bashku me ritet e Dibrës në raste të tilla.

tek Shaziman Meda, Miri Çaushi, Ali Krrashi, Irakli Gjika, Destan Sina dhe mezi kapim orën e ndeshjes, ku ishim të ftuar të shikonim dy vëllezër dibranë nga fshati Laçes i Fushë Alies, konkretisht Klodi dhe Eri Bardhi, me numrat 7 dhe 11. Stadiumi i Ankaravit kishte më shumë shqiptarë se grekë dhe vërtet ishte kënaqësi kur spikeri komentonte lojën e tyre. Skuadra e Ankaravit luante në kategorinë e tretë me një ekip të ardhur nga Janina dhe fitoi 1-0. Por loja e Klodit dhe Erit binte në sy dhe pas ndeshjes trajneri grek foli me superlativa për dy vëllezërit Bardhi. Klodi në vitin 2019 ishte shpallur edhe futbollisti me i mirë në Korfuz nga të huajt. Kjo vërtet përbënte lajm për ne dibranet qe ndiheshim krenar. Pas ndeshjes u futëm në fushë dhe festuam bashkë me ta. Realizuam foto dhe inkurajuam këta djem kaq të rinj dhe të talentuar. Njëri ishte 22 dhe tjetri 20, por pjekuria në lojën e tyre dhe teknika bënte diferencën. Pasi u takuam edhe me stafin e skuadrës së Ankaravit, morëm edhe pëlqimin e tyre për një ndeshje miqësore të këtij ekipi me "Korabin", skuadrën dibrane që militon në kategorinë e parë në futbollin shqiptar dhe është në katër më të mirat për këtë sezon që po mbyllet.

Stadiumi i Ankaravit kishte më shumë shqiptarë se grekë dhe vërtet ishte kënaqësi kur spikeri komentonte lojën e tyre. Por loja e Klodit dhe Erit binte në sy dhe pas ndeshjes trajneri grek foli me superlativa për dy vëllezërit Bardhi. Klodi në vitin 2019 ishte shpallur edhe futbollisti me i mirë në Korfuz nga të huajt.

Post ndeshjes, rikthehemi te shtëpitë e vëllezërve dhe miqve tanë dibranë. Gatimet tradicionale dhe mikpritja të kujton odën dibrane dhe aromën e gjellëve të nënave tona dikur. Fatbardha është një kuzhiniere duarartë, ndërsa bashkëshorti i saj Habedin Hasi është kuzhinier profesionist dhe punon në hotelet më luksoze të Korfuzit. E gjithë ajo zonë është populluar nga dibranët, që më së shumti ishin nga Muhurri, Sina, Arrasi, Kastrioti, Brezhdani, Zall-Dardha, Fushë – Alia, Blliçja dhe plot fshatra të tjerë të Dibrës. Secili prej tyre kishte marrë familjet dhe jetonin e punonin me djersën dhe ndershmërinë e tyre duke fituar besimin e pronarëve grekë, madje shumë prej tyre ishin edhe sipërmarrës, si Sadik Laçi, Luan Karriqi, Habedin Hasi, Selim Gjoni, Miri Çaushi e plot të tjerë që nuk arritëm dot t'i takonim.

Afroi ora e spektaklit dhe aty do të takonim qindra njerëz. Mbi 99 përqind e tyre ishin dibranë dhe të veshur bukur së bashku me gratë dhe fëmijët, erdhën dhe mbushën sallën e lokalit të madh "Olympic Palac", një sallë që oshtiu nga fillimi në fund me këngën dhe fjalën e bukur shqipe.

Këngëtarët brilantë të muzikës dibrane Vera Laçi dhe Dritan Jashari, së bashku me muzikantët virtuozë Dash Skarra dhe Leonard Gjoka, mbajtën peshë atmosferën që nuk u ul për asnjë sekondë. Pas përshëndetjes së organizatorit Sadik Laçi dhe shokut të tij bashkorganizator Artan Kaca, nisi vallja e bukur shqiptare, e cila ftoi në pistë mbi 200 pjesëmarrës që ishin të etur për të dëgjuar këngët tona dhe për të kërcyer valët e bukura shqiptare.

Si moderator, shpeshherë m'u desh të ndërhyj edhe në sallë, sepse edhe aty kishte mjaft talente të spikatur si Muharrem Elezi dhe Dritan Bradhi, por edhe një zonjë me mbiemrin Haraçiu, të cilët fituan edhe çmimet përkatëse si valltarët dhe këngëtari më i mirë, çmime që janë dhuruar nga Big Market dhe zoti Musa Riçku si administrator i këtij supermarketi tashmë edhe në qytetin e Peshkopisë të këtij rrjeti kaq të fuqishëm të tregut ushqimor.

Ora kalonte pa u kuptuar aspak dhe një tjetër moment interesant dhe emocionues ishte ditëlindja e Selim Gjonit, e cila u festua nën ritmin e këngës së kënduar nga të gjithë pjesëmarrësit dhe një tortë të përgatitur enkas nga organizatorët. Emocionet s'kishin fund edhe pse ora kish kaluar 3 e mëngjesit dhe njerëzit duhet të ishin të nesërmen në punë.

Një vend të veçantë patën edhe valët dhe nderimi që ju bë atyre që nuk ishin dibranë në sallë, duke respektuar kësisoj edhe një traditë të odës dibrane dhe traditave të saj. Më në fund, këngët e vjetra dhe patriotike e tradicionale ulën këmbëkryq te burrat e asaj mbrëmje duke rikthyer kohët e dikurshme dhe duke i kënduar së bashku me ritet e Dibrës në raste të tilla.

Kështu si pa kuptuar kishim kaluar orën 4 dhe na duhet ta mbyllnim këtë natë ku flitej dhe këndohej vetëm shqip, duke i bërë ata njerëz të harronin hallet e ditës dhe të kishin një copë Dibër në një vend të huaj.

Mbrëmje të tilla natyrisht duhet të organizohen më shpesh dhe ne morëm edhe zotimin e vëllezërve tanë në Korfuz për t'i shtuar takime të tilla kaq të vlefshme edhe në njohjen e njerëzve, por edhe zakoneve e traditave të bukura që ka Dibra dhe dibranët kudo ku ata jetojnë.

E nesërmja na gjeti sërish tek porti, aty ku do të ndaheshim me njëri-tjetrin, duke premtuar për një rikthim tjetër aty, si një detyrim për dibranët e Korfuzit, të cilët kanë bërë emrin e mirë dhe kanë fituar kaq shumë respekt dhe besim në një vend të huaj si Greqia.



Rruga e Arbërit nr. 165

Në 6 vitet e fundit, inspektimet e Inspektorati i Punës kanë konstatuar 427 punonjës pa kontrata individuale pune dhe 391 punëtorë u identifikuan si të punësuar në mënyrë informale, ndërkohë që aksidentet dhe dëmtimet në punë vazhdojnë të jetë shpeshta.

investigim

Jeta në Bulqizë mes vdekjeve në

Minatorët që vdesin në galeritë e kromit fajësohen shpesh për aksidentet tragjike që u marrin jetën; ndërkohë që të plagosurit dhe familjarët e viktimave përballen me kompanitë minerare dhe ato të sigurimit për dëmshpërblimet si dhe me dyert e gjykatave për drejtësinë e munguar.



Galeri në zonën mineral mbajtëse "D" në Bulqizë | Foto : Geri Emiri/BIRN

Nga **GERI EMIRI, SAMI CURRI** | BIRN

Pas disa kthesave që gjarpërojnë në lagjen e Qytetit të Ri në Bulqizë, në këmbët e një pallati të vjetër të periudhës së ish-regjimit komunist, Flora Koçi ka ngritur një barakë prej llamarine ku mundohet të sigurojë të ardhura për veten dhe djalin e papunë, duke shitur mallra ushqimorë dhe kinkaleri.

"Unë isha në dyqan, erdhi një këtu tek kopshti se e kemi afër dhe më tha që burri jot është vrarë dhe po shkon tek spitali," kujton 57-vjeçarja, nënë e dy fëmijëve. "Mbrapa më morën në telefon që ka vdekur," shtoi ajo.

Ruzhdi Koçi humbi jetën në një galeri kromi në Bulqizë më 10 nëntor 2016, ku kishte punuar për më shumë se 20 vjet. Drejtuesit e minierës i thanë familjes se 55-vjeçari vdiq nga një infarkt i papritur në zemër, por bashkëshortja jeton ende me dyshime.

"Këto thanë që i ka ranë infarkt, po infarkt nuk i ka rënë se nuk ka qenë sëmurë asnjëherë, as edhe një gjilpërë s'e ka pas bërë," shprehet Flora Koçi.

"Për me pushu çështjen edhe për mos me e zgjat më andej, ata kanë thënë që i ka rënë infarkt dhe s'kanë dash me dhënë lekë më shumë, siç i takon një punëtori kur vitet në galeri," shtoi ajo.

Sipas të dhënave të siguruar nga BIRN nëpërmjet ligjit për të drejtën e informimit nga Inspektoriati Shtetëror i Punës, në 6 vitet e fundit, 38 punonjës humbën jetën dhe 152 të tjerë u plagosën në sektorin e minierave dhe karrierave. 27 prej viktimave i përkasin qarkut të Dibrës.

Edhe pse aksidentet e regjistruara në miniera janë të shumta, ato rrallëherë sjellin pasoja penale për kompanitë minerare, që fajësojnë viktimat dhe punëtorët për aksidentet.

Minatorët e aksidentuar janë shpesh të pasiguruar. Por edhe në rastet kur viktimat janë të siguruar, familjarët përballen me procese të gjata gjyqësore kundër kompanive të sigurimit për dëmshpërblimet.

DYERVE TË GJYKATAVE PËR DËMSHPËRBLIM

Të gjitha subjektet që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të vendit, janë të detyruara të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet pranë një shoqërie sigurimi.

Referuar bazës ligjore, kontrata e sigurimit mbulojnë rastet e humbjes së jetës, paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme dhe paaftësisë së përkohshme, të plotë ose të pjesshme dhe shuma në çdo rast është minimalisht 6 milionë lekë.

Por jo të gjithë punonjësit në sektorin minerar janë të siguruar. Sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, AKBN, gjatë vitit 2018, vetëm në Bulqizë raportoheshin 283 minatorë pa siguracion jete nga një fuqi punëtore prej 3170 punonjësish.

Shahin Peti humbi jetën në një aksident në minierë në vitin 2013, duke lënë pas 2 fëmijët dhe bashkëshorten. Margarita Peti kujton se në atë kohë edhe ajo punonte si seleksionuese minerali dhe kur ishte kthyer nga puna dhe po bënte gati darkën, e ëma e kishte lajmëruar se i shoqi kishte thyer këmbën.

"Në moment që ka thënë burri ka thyer këmbën, i kam thënë -jo nuk është e vërtetë, ai paska vdekur se telefonin e ndez me dorë ai, jo me këmbë," rrëfen Margarita.

Pas aksidentit, Margarita mësoi se vdekja e bashkëshortit të saj ishte tentuar të fshihej, duke e larguar trupin e pajetë nga vendi i aksidentit, me qëllim që firma ku ndodhi ngjarja të mos mbante përgjegjësi. Ajo kujton se i shoqi ishte i pasiguruar dhe e vetmja mbështetje që ka marrë nga kompania, ka qenë 'një kafe' prej 1.5 milionë lekësh.

"Dhe ato me thënë të drejtën, kur i kanë prurë ia kanë dhënë njerëzve të burrit, jo mua vetë, por kanë thirrur aty se kanë qenë duke pirë kafe të gjithë dhe më thanë mua një kafe," kujton Margarita. "I kam thënë 'unë dua të më siguroni fëmijët, nuk dua një kafe, se unë vetëm që kam bërë shpenzimet e mortit, se nuk është se paguan shpenzimet e mortit," shtoi ajo.

Edhe në rastet kur kompanitë kanë paguar siguracion jete për viktimat, jo gjithmonë kompanitë e sigurimit janë të gatshme të paguajnë. Sipas raportit mjeko-ligjor, vdekja e Ruzhdi Koçit nuk është cilësuar si aksidentale, por si pasojë e sëmundjeve kronike.

Sipas të dhënave të siguruar nga BIRN nëpërmjet ligjit për të drejtën e informimit nga Inspektoriati Shtetëror i Punës, në 6 vitet e fundit, 38 punonjës humbën jetën dhe 152 të tjerë u plagosën në sektorin e minierave dhe karrierave. 27 prej viktimave i përkasin qarkut të Dibrës. Minatorët e aksidentuar janë shpesh të pasiguruar. Por edhe në rastet kur viktimat janë të siguruar, familjarët përballen me procese të gjata gjyqësore kundër kompanive të sigurimit për dëmshpërblimet.


Flora nuk e ka pranuar këtë raport dhe ka hedhur në gjyq kompaninë e sigurimit, duke kërkuar dëmshpërblimin për siguracionin e jetës; megjithatë, beteja ligjore ka qenë e gjatë dhe e mundimshme. Pas dy vjetësh në gjyq, ajo u detyrua të pranonte një dëmshpërblim me marrëveshje prej 2 milionë lekësh.

"Çfarë vlen ajo 20 [milion lekë të vjetra], asnjë gjë," tha Flora. "Mua ato lekë më kanë shkuar rrugëve, nëpër gjykata," shtoi ajo.

Kontratat e punës, sigurimi shëndetësor dhe ai i jetës janë një problem që ka shoqëruar ndër vite punonjësit e nëntokës, një sektor që punëson rreth 10 mijë punonjës në të gjithë vendin.

Në 6 vitet e fundit, inspektimet e Inspektorati i Punës kanë konstatuar 427 punonjës pa kontrata individuale pune dhe 391 punëtorë u identifikuan si të punësuar në mënyrë informale, ndërkohë që aksidentet

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore përgjatë vitit 2018 raportoi të regjistruara 255 leje minerare për nxjerrjen e mineralit të kromit në Shqipëri, ndër të cilat vetëm 50 leje nuk kishin regjistruar prodhim. Totali i mineralit të nxjerrë në vend ishte në sasinë e rreth 1.1 milionë tonëve krom –aktivitet i cili gjeneron sipas INSTAT rreth 100 milionë euro në vit. AKSEM i tha BIRN se ka hetuar 33 raste të humbjes së jetës në miniera dhe 77 aksidente të raportuara si plagosje në gjashtë vitet e fundit. Ndërkohë, vetëm 13 prej rasteve të hetuara nga AKSEM janë referuar në organet e drejtësisë për vazhdim të mëtejshëm të hetimeve.
Në total nga viti 2014 deri në tetor 2019, AKSEM ka lëshuar 266 masa administrative në sektorin minerar. Këto masa administrative përfshijnë "ndalesa të plota të aktivitetit minerar" në 20 raste, "ndalesa të pjesshme e aktivitetit minerar" në 100 raste, dhe "gjoba" në 56 raste, "vendime të ndërmjetme për masa urgjente në 16 raste dhe paralajmërime në 74 raste – për shkelje apo neglizhencën e subjekteve private.



Minator në njërën nga galeritë e nxjerres së kromit në zonën mineral mbajtëse "D" të Minierës së Bulqizës. Foto Geri Emiri/BIRN

miniera dhe padrejtësisë



Galeritë e nxjerres së kromit në zonën mineral mbajtëse "D" të Minierës së Bulqizës. Foto Sami Curri/BIRN

dhe dëmtimet në punë vazhdojnë të jetë shpeshta.

AKSIDENTET NË PUNË

Aksidentet në sektorin minerar janë të shumta. Vetëm në dy muajt e fundit në kompaninë Albchrome, që ka numrin më të lartë të të punësuarve në Minierën e Bulqizës, u aksidentuan tre minatorë.

Një prej këtyre minatorëve, Tush Asllani u aksidentua më 19 dhjetor 2019 në syrin e djathtë pasi u godit nga një masiv gurësh. Asllani e ka humbur përfundimisht shikimin dhe ka nisur procedurat për të përfituar dëmshpërblimin nga kompania. Më 6 janar 2020 u aksidentuan në punë edhe dy minatorë të tjerë, Mentor Gjeta dhe Altin Kola.

Burime nga Spitali i Bulqizës i thanë BIRN në kushtet e anonimatit se në Bulqizë ndodhin edhe shumë aksidente që nga minatorët nuk raportohen se kanë ndodhur në vendin e punës, por japin arsye të tjera.

Agroni*, një tjetër minator i kësaj miniere u aksidentua në vitin 2015 në zonën e njohur si "pusi". Teksa ishte turni i dytë, një pasdite dimri nga pakujdesia e mekanikëve ai dëmtoi 3 gishtat e njërës dorë.

"Duke ngritur vagonin, normalisht që vagoni ngrihet me duar, zinxhiri i vagonit më kapi dorën e djathtë dhe pesha e vagonit më nxori tre gishta të dëmtuar," tregoi ai.

Nga Spitali i Bulqizës përfundoi në atë të Peshkopisë, ku qëndroi për 2 javë. Pasi nuk pa asnjë përmirësim, vendosi t'i drejtohej Spitalit të Traumës në Tiranë. Agroni tregon se u takua me bordin e administrimit të kompanisë, shefin e burimeve njerëzore, me idenë që kompania të merrte përsipër shpenzimet mjekësore. Kur kompania e njoftoi se nuk do t'i mbulonte shpenzimet mjekësore, ai vendosi t'i drejtohej drejtësisë.

"Gjykata kërkoi një mjek për të konstatuar problemin që unë kisha dhe nxori që unë kisha tre gishta jashtë funksionit," tha Agroni, i cili pas një kalavari gjyqësor që zgjati 2 vjet arriti të fitonte dëmshpërblimin dhe të rikthehej në punë. "Një dorë me dy gishta, normalisht që është shumë e vështirë që të punosh," përfundoi ai.

PËRGJEGJËSIA U MBETET VIKTIMAVE

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore përgjatë vitit 2018 raportoi të regjistruara 255 leje minerare për nxjerrjen e mineralit të kromit në Shqipëri, ndër të cilat vetëm 50 leje nuk kishin regjistruar prodhim. Totali i mineralit të nxjerrë në vend ishte në sasinë e rreth 1.1 milionë tonëve krom –aktivitet i cili gjeneron sipas INSTAT rreth 100 milionë euro në vit.

Në 6 vitet e fundit, Inspektorati i Punës ka kryer në subjektet me aktivitet në miniera dhe karriera 895 inspektime rutinë ose për shkak të ankesave dhe në 159 raste inspektimet janë për shkak të aksidenteve në punë.

Nga numri total i aksidenteve të raportuara nga Inspektoriati i Punës, një tjetër institucion- Autoriteti Kombëtar i Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera, AKSEM ka kryer hetime për një pjesë prej tyre.

AKSEM i tha BIRN se ka hetuar 33 raste të humbjes së jetës në miniera dhe 77 aksidente të raportuara si plagosje në gjashtë vitet e fundit. Ndërkohë, vetëm 13 prej rasteve të hetuara nga AKSEM janë referuar në organet e drejtësisë për vazhdim të mëtejshëm të hetimeve, kryesisht me motivacionin për shkelje të "Rregullores së Sigurimit Teknik për Minierat dhe Karrierat". Hetimet e Prokurorisë kanë ngarkuar me përgjegjësi kryesisht viktimat, zjarrmëtarët, drejtuesit teknikë apo brigadierët dhe vetëm në dy raste punëdhënësin.

Në total nga viti 2014 deri në tetor 2019, AKSEM ka lëshuar 266 masa administrative në sektorin minerar. Këto masa administrative përfshijnë "ndalesa të plota të aktivitetit minerar" në 20 raste, "ndalesa të pjesshme e aktivitetit minerar" në 100 raste, dhe "gjoba" në 56 raste, "vendime të ndërmjetme për masa urgjente në 16 raste dhe paralajmërime në 74 raste – për shkelje apo neglizhencën e subjekteve private.

Në relacionet e mbajtura nga AKSEM për verifikimin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë nëntokë rezultojnë një sërë problematikash, duke filluar që nga përgatitja e punëtorëve për përdorimin e makinerive, vendosjen e sinjalistikës paralajmëruese ndaj rreziqeve në punë, përdorimi i pajisjeve mbrojtëse individuale të punës e deri te kushtet higjieno-sanitare.

RRETHI VICIOZ

Pas vdekjes së bashkëshortit, Margarita Peti vazhdoi të punonte duke seleksionuar mineralin që atij i mori jetën për të mbështetur financiarisht familjen. Ajo punon si seleksionuese kromi në një galeri 1 orë larg apartamentit ku banon me fëmijët. Puna si seleksionuese ka rreziqe e saj. Vetëm në vitin 2018, sipas Inspektoriatit të Punës, një seleksionuese humbi jetën në Bulqizë dhe dy të tjera u aksidentuan.

"Jam e detyruar se ku do shkosh tjetër, ku do punosh?! Në Bulqizë nuk ke ku shkon," shfajësohet Margarita me djalin 15 vjeçar dhe vajzën 13 vjeçe pranë vetes.

Megjithatë, ajo ankohet se pas kredisë për shtëpinë dhe detyrimet e tjera, paga prej 30 mijë lekësh në muaj dhe pensioni prej 7 mijë lekësh, nuk mjaftojnë as për t'u kujdesur si duhet për shëndetin e fëmijëve.

"Do doja t'i bëja një kontroll të ri çunit, se unë e kam kontrolluar dhe ia kam blerë njëherë syzet," tha ajo. "Edhe tek goca më kanë thënë për operim, por s'pata mundësi sepse më kanë thënë se ka migrenë," shtoi Margarita.

Në anën tjetër të banakut të vogël të kioskës prej llamarine, Flora Koçi tregon se jeton me të ardhurat e pakta që nxjerr nga shitja e artikujve që tregton dhe një pension të bashkëshortit prej 6500 lekësh.

"Të punosh njëzet e ca vjet në galeri edhe të marrësh 6,500 lekë, a kalohet?! Nuk kalohet", shfryn ajo.

Ka raste që djemtë e minatorëve që humbasin jetën në minierën e Bulqizës, zëvendësojnë baballarët në galeritë e kromit, të cilin e shohin si të vetmen rrugë të ndershme për të siguruar të ardhura për familjen.

Por Margarita Peti thotë se do të bëjë të pamundurën që i biri 15-vjeçar të mos përfundojë në galeritë e kromit ku humbi jetën i ati.

"Që ta çoj të punojë me një vend, aty ku ka humbur jetën babi i vet, e të shkoj të çoj çunin, nuk bëhet fjalë ajo punë," tha ajo. Megjithatë, Margarita ka frikë se varfëria mund t'i detyrojë që të bëjnë një zgjedhje të tillë.

"…nuk i dihet se çfarë ndodh pastaj, se po të ngelesh pa bukë aty do shkosh ku vjen fundi," përfundoi ajo.

**Emri është ndryshuar për të ruajtur identitetin e minatorit që kërkoi të mbetej anonim*

Ky investigim është shkruar për reporter.al. Shkrimin origjinal e gjeni në linkun: https://www.reporter.al/jeta-ne-bulqize-mes-vdekjeve-ne-miniera-dhe-padrejtesise/

Riaktivizimi i Qafë Buallit

AlbChrome: 25 milionë USD investime për vend-burimin e kromit

Faza e parë përfshin projektimin e Planit të Zhvillimit të Vendburimit të Kromit në Thellësi të Zonës së Qafë Buallit, në Bulqizë.

ALBCHROME ka nisur për vitin 2020 zbatimin e një tjetër projekti madhor minerar, atë të projektimit të punimeve të Hapjes dhe Zhvillimit të Vendburimit të Qafë Buallit.

Faza e parë përfshin projektimin e Planit të Zhvillimit të Vendburimit të Kromit në Thellësi të Zonës së Qafë Buallit, në Bulqizë.

Kosto totale e ndërtimit mbulon investimet e të gjithë punimeve minerare, punimet civile, blerjet e makineri-pajisjeve, etj dhebazuar në studimin paraprak, investimi përllogaritet të jetë rreth 25 milion USD dhe periudha e parashikuar për realizimin e tijështë rreth 2 vite.

Jetëgjatësia e këtij vendburimi është përllogaritur të jetë rreth 12 vite, me një kapacitet prodhues prej rreth 100.000 ton në vit. Vendburimi i kromit në Qafë-Buall ndodhet në masivin ultrabazik të Bulqizës, dhe konkretisht rreth 2.2 km deri në 2.5 km më tutje në perëndim të vendburimit të kromit tëBulqizës, në Jug-Lindje të kryqëzimit Bulqizë-Batër.

Punimet e kërkim-zbulimit në Qafë Buall kanë filluar nëvitin 1981. Bazuar në punimet e kërkim-zbulimit te SHGJSH,është hartuar projekti për hapjen e vendburimit të Qafë Buallit dhe në vitin 1985 u projektuan dhe filloi hapja e dy traverbankëve A dhe B.Pas vitit 1995, këto punime u ndërprenë për mungesë fondesh dhe u përmbytën nga ujërat nëntokësore, duke dëmtuar të gjithë infrastrukturën.

Riaktivizimi i punimeve në këtë vendburim filloi në Shtator 2013 nga AlbChrome. Pas riaktivizimit të vendburimit të Qafë Buallit nëmaj 2015, lindi nevoja e hartimit dhe zbatimit të një projekti të ri kërkim-zbulimi tëhollësishëm për të përmirësuar parametrat e projektit fillestar dhe mundësuar vazhdimin e punimeve kapitale për hapjen e minierës në Qafë Buall.

Sipas raportit gjeologjik të hartuar në 2018 nga Shërbimi Gjeologjik i Minierës Bulqizë, rezerva gjeologjike tënxjerrshme nëtotal janë rreth 700,000 ton me cilësi në dalje.

Ky investim vjen pas ndërtimittë pusit 9, me vlerë gati 20.5 milion USD, Traverbankuttë Klosit me vlere rreth 5,2 milion USD dhe montimittëmakinerisë së re ngritëse në Pusin nr. 3 me vlerë 1.6 milion USD.

Në vitin 2020, AlbChrome ka planifikuar të investojë 10 milionë USD. Investimet do të jenë të fokusuara në: hapjen e vendburimit të Qafë Buallit, zhvillimin e projektit të thellësisë të Minierës së Bulqizës, zbatimin e projektit të sistemit të pluhur-kapjes në UFK Elbasan, në drejtim të teknologjisë dhe automatizimit të uzinave dhe minierës, si dhe në remontin e furrës nr. 3 në UFK Elbasan.

Që nga viti 2013, vlera totale e investimeve të AlbChrome në sektorin minerar në Shqipëri ka prekur shifrën e 55.6 milionë USD, shifër kjo e cila do t'i kalojë 70 milionë USD brenda vitit 2021. Këto investime mekanizojnë proceset në sektorin minerar, duke e bërë më të sigurt punën e punonjësve, si dhe i rrisin jetëgjatësinë sektorit, duke e bërë të qëndrueshëm dhe afatgjatë punësimin në të.

Burimi: **albchrome.al/**

Tregimet e Drinit

Në Bulqizë ka rënë dëborë e madhe

Nga **DIONIS XHAFA**



Pamje nga Bulqiza. Foto Sami Curri / Facebook / Bulqizaime

Bulqiza është qyteti më interesant, jo vetëm në qarkun e Dibrës, por në mbarë Shqipërinë e më gjerë. Me siguri që, po të ishte gjallë shkrimtari i njohur Dostojevski do të kishte plot material për qytetin minator, që vazhdon të lëngojë nga plagët e saj, që njohin vetëm tmerre e vuajtje. Kjo është Bulqiza dhe për sa kohë ky qytet të jetë në këmbë, përherë do të ketë lajme, përherë do të ketë jetë, përherë do të ketë histori, ku brenda saj patjetër që do të jetë edhe kromi, floriri i qytezës, minatorë më në zë të Veriut.

Kromit po i dëgjohet sërish zëri, në largësi dhe në thellësi të maleve të kësaj zone, që e rrethojnë qytetin, e ngjan sikur e kanë zënë përposhtë. Malet nga ana tjetër janë edhe krenaria e burrëria e Bulqizës, e Dibrës mbi të gjitha.

Kështu, sërish minatorët janë ngritur në protestë, ata kërkojnë të drejtat e tyre, që puna t'iu paguhet, që të mbrojnë djersën dhe gjakun që lënë në galeritë e nëntokës, ku kanë lënë mish e kocka, kanë bluar mendje e shpirt. Tashmë që miniera ka kaluar në duar të tjera, raportimet thonë se pagat janë ulur, duke thënë se kjo bëhet që kushtet të jenë më të mira.

Aty ka paga normale për Shqipërinë, në një punë që është e barabartë disa herë me vdekjen, ku vdekja vjen përballë, shpesh herë duket nëpër male si një fantazmë e poshtër, që ngrihet përmbi sy e ballë. Ky është fati i minatorit bulqizak e dibran, në një jetë plot ngërcë e vështirësi, të cilat duket se është vështirë të mbarojnë. Më shumë duhet bërë për minatorët, palcën e krenarisë kombëtare, që nxjerrin floririn e vendit, të shtetit, të mbarë kombit shqiptar. Paga më të mira duhet të kenë minatorët, që hyjnë në galeri dhe nuk e dinë më a do të dalin prej andej apo jo. Miniera flet sot, flet me gjuhën e vuajtjes, me gjuhën e dhimbjes krenare, me gjuhën e bukës të përditshme, me gjuhën e djersës që derdhet përditë në tokë dibrane, bash në atë vend ku ka luftuar Gjergji ynë i madh, Skënderbeu.

Në Bulqizë, në mënyrë figurative ka rënë borë në male, duke penguar të mirën, duke ia zënë frymën, e dielli nuk po shihet, nuk shihet zjarri, nuk shihet prushi, nuk shihet ndriçimi dhe ngjyrat. Ka vetëm zezonjë, dëborë e shi. Por kjo duhet të marrë fund,

Minatorët meritojnë trajtim me respekt, jo paraja të shkojë në duart e pak njerëzve, jo sistem skllavo-pronar në kohën e modernizmit, jo më shkelje me këmbë, por bukë e dinjitet normal, të rrosh me nder e jetë plot ndriçim e diell, mbi të gjitha diell, atë që duan të gjithë e duhet ta duan edhe të pasurit, edhe pushtetarët.

e pushtetarët të bëhen më njerëzorë, më humanë, për të paguar minatorët aq sa iu takon, aq trup e shpirt sa japin, aq të kthehen në para, që janë të tyret, duhet të jenë të popullit, të këtij populli të vuajtur që jeton mes malesh, në ato male të heroit tonë kombëtar, nga Valikardha në Korab, në malet që nuk u tundën as nga turqit, as nga serbët dhe as nga pushtuesit më të egër që kanë kaluar në këto zona. Bulqiza duhet ta zhbëjë dëborën e të ndriçojë dielli e hëna e bukur, në fushat e në kodrat e malet të popullatës që është ngritur gjithmonë në mënyrë rebele ndaj të huajve pushtues, ndaj së keqes, pjesë e popullit më të vjetër në Ballkan, e në Europë, të lashtë sa stalaktiket e shpellave të zonës.

Ndaj minatorët meritojnë trajtim me respekt, jo paraja të shkojë në duart e pak njerëzve, jo sistem skllavo-pronar në kohën e modernizmit, jo më shkelje me këmbë, por bukë e dinjitet normal, të rrosh me nder e jetë plot ndriçim e diell, mbi të gjitha diell, atë që duan të gjithë e duhet ta duan edhe të pasurit, edhe pushtetarët.

Edhe këta të fundit duhet ta duan diellin e jo borën, sepse kjo botë rrotullohet e ku i dihet nesër janë ata që kanë nevojë për ndriçim, për pak rreze, andaj dielli e vetëtima e fortë, vezullimet duhet t'i predikojnë të gjithë, për të jetuar si njerëz, si familjarë, si minatorë, ndershëm, si bulqizak, si dibran e shqiptar me dinjitet.

NJOFTIME

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit.

JU KUJTOJMË SE SHKRIMET DUHET TË JENË TË KORRIGJUARA/ REDAKTUARA.

Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6** ose në faqen tonë **www.rrugaearberit.com**

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:

Në Shqipëri: 600 lekë.

Në Europë: 10 Euro.

Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Çdo pajtim në gazetë është i mirëpritur dhe konsiderohet si kontribut për vazhdimësinë.

Gjejmë rastin të falenderojmë të gjithë miqtë dhe lexuesit tanë që i kanë kryer abonime si dhe veçmas, falenderojmë mikun e gazetës sonë, z. **Irfan Zebi** për kontributin prej 50 Eurosh për gazetën.

Ju kujtojmë se pajtimet vazhdojnë dhe çdo kontribut është i mirëpritur!

NJOFTIME

Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastet kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një faturë të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6** ose në faqen tonë **www.rrugaearberit.com**

investime

Rritja e njohurive ndërmjet banorëve dhe brezit të ri në zonat rurale për kapacitetet e mundshme të zhvillimit të blegtorisë dhe krijimit të tufëve të reja, si mundësi për përmirësimin ekonomik familjar

Mbështetja për blegtorinë e imët, mundësi zhvillimi

OSMAN XHILI
MAKSIM HAJRULLAJ



Projekti ***"Menaxhimi i fermave blegtorale,qendrueshmeria dhe sipërmarrja nga te rinjtë - Bashkia Dibër" ,*** financohet nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetet lokale.

Objektivat kryesore të projektit janë:

a- Krijimi i kushteve për zhvillimin e fermave ekzistuese dhe shtimin e fermave të reja me sipërmarrjen e brezit te ri në bashkinë Dibër.

b- Menaxhimi i qëndrueshëm i fermave blegtorale duke ndaluar shpopullimin dhe emigrimin në funksion të zhvillimit ekonomik rural.

c- Mbrojtja dhe shërbimi ndaj mjedisit në zonat ku shmanget largimi i banorëve nëpërmjet zhvillimit të fermave blegtorale.

Sektori i blegtorisë ka qenë sektori bazë në prodhimin e produkteve ushqimore blegtorale të nevojshme, si bazë e të ushqyerit të popullatës për nevojat në qumësht dhe nënproduktet e tij, mish, lesh, vezë, mjaltë etj. Vlerësohet që blegtoria përbën 52% të vlerës së prodhimit të përgjithshëm bujqësor. Prodhimi blegtoral ka njohur rritje të ndjeshme dhe luan rolin kryesor në të ardhurat e fermerëve. Ata sigurojnë 70% të të ardhurave nga shitja e prodhimeve blegtorale.

KULLOTAT VERORE PËR TË IMTAT

Asnjë sektor tjetër në Shqipëri, nuk ka një ndikim kaq të rëndësishëm mbi popullsinë rurale të prekur nga varfëria, se sa sektori i blegtorisë dhe kullotave. Numri i krerëve në blegtori (të dhëna nga ARSHVMB) janë në rënie si në numër krerësh dhe në tufë. Karakteristikë e dallueshme është që zona fushore mbarështon më shumë gjedhin dhe zona malore, delet dhe dhitë. Kjo për arsye të kushteve mjedisore, sepse kullotat janë më të shumta në zonën malore dhe mbarështimi stallor është më i përshtatshëm në zonën fushore. Sipërfaqja e tokës lejon që ky numër të jetë disa herë më i madh, duke shkuar deri në dyfishimin e numrit të krerëve.

Përpunimi i qumështit është një tendencë e investimeve në zonën e Dibrës. Zhvillimi i blegtorisë, kryesisht në zonën malore dhe kodrinore, me orientim drejt bagëtive të imëta, duke shtuar numrin e krerëve dhe rritur prodhimtarinë është një potencial plotësisht i realizueshëm. Për zonën e vargmalit Deshat-Korab duhen më shumë të leshta, sepse ka më shumë kullota alpine dhe për zonën e malësisë Reç-Lurë, Selishtë, më shumë nevojiten të dhirtat, pasi bimësia është më e favorshme. Rritja e numrit të krerëve dhe sasisë së prodhimit ndihmon ekonominë e përpunimit të qumështit dhe ngritjen baxhove të reja.




PERSPEKTIVAT E TRASHËGIMIT TË FERMAVE NGA TË RINJTË.

Zhvillimi ekonomik i zonave rurale varet në një shkallë të gjerë nga gjendja e rezervave natyrore dhe sipërmarrja nga brezi i ri në zhvillimin e fermave blegtorale dhe shumëllojshmëria e tyre në prodhimet e kërkuarar nga tregu aktual. Përmirësimi i përgjithshëm i gjendjes së tyre, të varfër aktualisht, kërkon investime të rëndësishme me afat të gjatë. Shumë të anketuar, individë dhe organizata presin që kushtet në menaxhimin e burimeve blegtorale dhe kullotave të përmirësohen. Pas përfundimit të projektit, duhet të theksohet që optimizmi i përfitimeve në të ardhmen bazohet së pari në shpresën që investimet, që aktualisht sigurohen nga banorët, duhet të sigurohen edhe nga shteti nëpërmjet mbështetjeve me financime të fermave blegtorale. Në të njëjtën kohë, shumë kontaktues e konsiderojnë përdorimin e financimit të pa mjaftueshëm nga buxheti i shtetit, një nga faktorët frenues në zhvillimin e blegtorisë. Kjo shifër është mjaft e vogël, e krahasuar me vendet fqinje kufitare ku mbështetja është ne nivele shume më të larta. Blegtorët paraqitën shkurtimisht mënyrën se si ata organizojnë kullotën e tufës së tyre dhe ngritën disa problematika rreth përdorimit të këtyre kullotave. Shqetësimet më të rëndësishme të tyre ishin:

- Vështirësitë për tu përshtatur me ndryshimet klimatike që kanë efekte mbi burimet foragjere dhe shëndetin e kafshëve;
- Mungesa e burimeve ujore në disa zona, gjë që ul mundësinë e largimit nga fshati në mënyrë të veçantë gjatë verës;
- Lidhja midis cilësisë së burimeve foragjere dhe cilësisë së veçantë të produkteve (qumësht, dhe mish);
- Dëshira për të zgjeruar tregjet e shitjes së mishit, me tregje të reja më interesante dhe pse jo drejt eksportit.
- Dëshira për të jetuar në mënyrë më të qëndrueshme, por duke ruajtur cilësinë aktuale të jetës, këtë organizim familjar, këtë zanat në kontakt me blegtorinë dhe natyrën;
- Vëzhgimi se hapësirat po mbyllen si pasojë e një ulje globale të numrit të blegtorisë në Dibër.
- Sigurimi i financimeve në nivel më të lartë, për të motivuar brezin e ri në sipërmarrje dhe eliminimin e braktisjes të resurseve natyrale që afrojnë zonat rurale.
- Ndjen vërtetë një kënaqësi e optimizëm, kur sheh dhjetëra fermerë të rinj, që e quajnë nder dhe privilegj të merresh me profesionin e bukur të blegtorit dhe në mënyrë të veçantë me të imta. Vetëm në katër komunat, që përfshin projekti, ne patëm takime e shkëmbime përvojash me shumë prej tyre. Do të veçonim fermerët Blerim Datja, Ervin Kallçishta në Maqëllarë, Astrit Elezi, Jusuf Vranezi në Tomin, Romeo Voka, Gentian Lleshi në Muhur dhe Ambri Fida, Qerem Shqefni në Melan. Ata vlejnë shumë më tepër se ky emër i përmendur, vlejnë të falënderohen, të ndihmohen dhe të financohen për punën që bëjnë dhe për shembullin që japin.

ECURIA E NUMRIT TE KRERËVE TË BLEGTORISË IMËT 1938-2019

Në censusin e realizuar në dhjetor 2019 -janar 2020 numri i krerëve është në një nivel më të ulët dhe kjo shifër lëviz me - 30 % më e ulët, ku numri i krerëve në bashkinë Dibër është në kufijtë 50 000 krerëve, nga këto 38 000 të leshta dhe 13 000 të dhirta.



Grafiku i ecurisë së blegtorisë imët në vitet 1938-2020

Problemet:

Shpopullimi i zonave rurale të përshtatshme për mbarështimin e blegtorisë se imët.

Largimi blegtorëve me eksperiencë dhe traditë nga zonat kullosore rurale drejt zonave urbane.

Tkurrja e blegtorisë dhe rënia e interesit për mbarështimin e tufëve të imta.

Rinia ka përparësi për emigracionin dhe i janë larguar sektorit të blegtorisë.

Mosha e blegtorëve që shërbejnë është mbi 60 vjeç.

Mbështetja dhe financimet janë të reduktuara dhe me kufizime rajonale.

Sipërmarrja për hapjen e pikave të grumbullimit të qumështit dhe e përpunimit është në nivel të ulët.

Shërbimi veterianar jo i shpërndarë sipas territoreve dhe mungesë e specialisteve veterinarë.

Mungesë e degëve në shkollat e mesme teknike - profesionale për zhvillimin e fermave bujqësore dhe blegtorale.

Njësitë vendore nuk kanë burime financiare për të mbështetur blegtorët si në fermat e tyre ashtu dhe në përmirësimet e kushteve në stanet, lerat dhe kullotat verore.

Menaxhimi i fermave blegtorale kërkon:

Fermerë të pregatitur profesionalisht dhe që zbatojnë teknologjitë e reja.

- ✓ Të njohë politikat e shtetit për sektorin e blegtorisë.
- ✓ Të zgjedhë rracën dhe të plotësojë dokumentacionin teknik.
- ✓ Të njohë nevojat ushqimore të tufës, të zbatojë higjenën e tufës.
- ✓ Të plotësojë treguesit e stallës, të njohë sëmundjet kryesore.
- ✓ Të njohë faktorët që maksimizojnë prodhimin.
- ✓ Të njohë të drejtat mbi pronësinë dhe qiramarrjen.
- ✓ Të vlerësojë kapitalin financiar që disponon.
- ✓ Të plotësojë dokumentacionin bazë të fermës, si shpenzime, të ardhura, blerje, shitje etj.
- ✓ Të njohë tregjet e prodhimeve blegtorale, kreditimin dhe financimet.
- ✓ Të mbajnë lidhje me organizmat e shërbimit dhe informacionit bujqësor-blegtoral.
- ✓ Të afrojë në tregje produktet blegtorale të standartizuara, sipas kërkesës së tregut.
- ✓ Të njohë ofertat dhe çmimet e shitjes.
- ✓ Të planifikojë prodhimin dhe vendin e shitjes.
- ✓ Të përsosë lidhjen midis prodhuesit dhe konsumatorit për cilësinë dhe çmimin.

PRITSHMëRIA.

Rritja e njohurive ndërmjet banorëve dhe brezit të ri në zonat rurale për kapacitetet e mundshme të zhvillimit të blegtorisë dhe krijimit të tufëve të reja, si mundësi për përmirësimin ekonomik familjar.

Identifikimi dhe mundësitë e zhvillimit të ekotipeve të imtave në zonë si mundësi në krijimin e fermave blegtorale të qëndrueshme.

Nxitja e mundësive të zhvillimit të blegtorisë, duke përfituar nga tradita dhe përvoja e trashëguar në shekuj.

Përmirësimi i të ardhurave dhe nivelit të jetesës nëpërmjet rritjes së prodhimit në fermat blegtorale, marketimit, shitjes të produkteve jashtë fermes.

Rritja e bashkëpunimit me donatorët dhe institucionet që mbështesin zhvillimin e blegtorisë nëpërmjet aplikimeve dhe financimeve për fermat blegtorale.

Rritja e kontaktit me AREB dhe ARSHVMB ne Dibër si mundësi bashkëpunimi, informacioni dhe zhvillimi të fermave dhe shkëmbimit të eksperiencave në zona më të zhvilluara.

Krijimi i mundësive të bashkëpunimit midis fermerëve blegtorë, grumbulluesve dhe përpunuesve në një grup të përbashkët, që plotësojnë të njëjtin qëllim, rritjen e nivelit ekonomik familjar dhe rajonal.

Bashkëpunimi mes operatorëve të agro–turizmit duke i kthyer fermat e tyre edhe si burim kontakti nga turistet për konsum dhe përvojë me ndikim edhe në ekonominë e fermave blegtorale.

Ky material është prodhuar ose publikuar në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e "Agro Eko Dibra" dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Karari i çidhnakëve të mençurisë thotë:
“Lum kush mban me vete tre armë: Pasqyrë, peshore dhe gërshërë

Mësuesi MENSUR LELA, gjithnjë i lidhur ngushtë me mësimdhënien dhe nxënësit

Nga MEVLUD BUCI

Zakonisht apo më troç, që në krye të herës të themi, shkruhet për të dekoruar, për intelektualë që shuhen nga jeta apo shtetarë të lartë. Sigurisht edhe kjo duhet, nuk mund të quhet e gabuar. Por e vërteta, provat e punës e të jetës dëshmojnë se edhe në bazë, edhe larg kryeqytetit apo qyteteve “të mëdha” ka plot intelektualë, bij e bija që jetojnë me kohën, që kanë dëshmi përkushtimi e përvoja, që rrezatojnë kulturë e kanë plot gjurmë diturie e tradite, plot prova që u rrezatojnë kohës edhe brezave. Puna e njeriut ngjan me atë të galerive të thella që mbartin minerale të çmuara. Minerali ndodhet në thellësi, vetëm inxhinieri i talentuar gjen mineral të çmuar.

Mensur Hysen Lela i pasionuar i thjeshtë e kurdoherë kërkues ndaj vetes e ndaj të tjerëve. Me të drejtë karari i çidhnakëve të mençurisë thotë: “Lum kush mban me vete tre armë: Pasqyrë, peshore dhe gërshërë...”.

***

Mensur Hysen Lela u lind më 20 qershor 1963 në Vakuf të Kastriotit. Prindërit e nderuar Hyseni dhe Xhibja e rritën dhe edukuan më së miri, me virtytet e kulturën e familjes, me zellin e dashurinë për mësimin, për vendlindjen, në respektin për fisin, për shokët e miqtë. Mensuri u rrit dhe edukua me dritën e diturisë. Nxënës e studentë i përkushtuar, i interesuar për udhët e dijes, për shtigjet e bukura, por tepër të vështira të mësuesisë.

Më 1982-1986 Mensur Lela mbaron Institutin e Lartë Pedagogjik “Luigj Gurakuqi” në Shkodër për Bio-Kimi. Më 16 gusht 1986 deri më 15 shtator 1993 shërben mësues kimie në shkollën e mesme “Gjergj Kastrioti” në Kastriot.

Më 16 shtator 1993 deri më 10 janar 1994 shërbeu mësues Kimie në shkollën e mesme Muhurr. Në vitin 1994 shërbeu ekspert policie (antidroge) komisariati i policisë Delvinë.

Kurdoherë korrekt, i matur e vendosur, i përkushtuar për detyrën. Nga 1 shtatori 1994 deri më 16 shtator 2001 Mensur Lela drejton shkollën 8-vjeçare Vakuf, të komunës së Kastriotit. Me takt, pasion e shpirt krijues udhëheq kolektivin pedagogjik shembullor si drejtues, mësimdhënës, organizator e veprimtar i kudondodhur.

Nga 16 shtatori 2001 deri më 2 dhjetor 2005 punon mësues në shkollën 8-vjeçare



Kastriot. Nga 3 dhjetori 2005 deri më 31 gusht 2007 shërbeu drejtor i shkollës 9-vjeçare “Irfan Hajrullai” në qytetin e Peshkopisë.

Si kudo shërbeu me përkushtim durim e shembull personal, duke ngulmuar tek mësimi reformues, tek puna me talentet dhe model i përgjithësimit të përvojave në kolektiv e komunitet. Provat e ndihmesës organizative, kërkesat rigoroze ndaj vetes e më pas ndaj të tjerëve bëjnë që Mensur Lela nga 1 shtatori 2007 deri më 9 janar 2012 të drejtojë shkollën 9-vjeçare “Myslim Shehu” të qytetit të Peshkopisë. Nga janari 2012 deri në 31 dhjetor 2013 shërbeu përgjegjës i SKC DAR-Dibër.

Mbresëlënëse është edhe puna si mësues në shkollën “Shehat Halili” Shimçan më 1014-2016. Nga 13 shtatori 2016 e në vazhdim Mensur Lela shërben mësues në shkollën 9-vjeçare Koben (me portal të MAS).

DËSHMI DRITE

Nderimet që njeriu gëzon janë vërtet krenari, urtësi, thjeshtësi, por mbi të gjitha janë dëshmi drite. Mensur Lela në vitin 1988 dekorohet me Distinktivin e MA të Republikës së Shqipërisë “Mësues i dalluar” për kontributin e dhënë në ngritjen e kabineteve të kimisë në shkollat e mesme. Plot certifikata trajnimi “Legjislacioni dhe Negocimi” (2003) “Microsoft Ëord, Excel, Programet Ëindoës, QEK, Peshkopi (2003). Dëshmi kualifikimi, kategori e parë (2007), certifikatë trajnimi “Paketa e Gjelbër”, Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) (2007), Certifikatën Linkoln, Certifikimi bazë për kompjuter dhe internet IC3, (2007), Certifikatë vlerësimi “Për objektivat e nxënësve nga Instituti i Kurrikulave të trajnimit Tiranë (2008), Certifikatë vlerësimi “Plani vjetor i shkollës”, nga Instituti i Kurrikulave dhe trajnimit Tiranë.

Midis shumë e shumë vlerësimeve për mësuesin e punëtorin e drejtimit arsimor Mensur Lela (punëtor, ndonëse s’është titull, por hijeshon titullin, gradën, dekoracionit (autori M. B.) është certifikata e vlerësimit 2011 “Për përdorimin pedagogjik të laboratorëve” në lëndën Kimi, arsimi bazë nga MASH. Ngas qershori 2014 – qershor 2018 mori certifikatën “Kurrikula me bazë me kompetencat dhe risitë e saj”.

Gjithnjë i lidhur ngushtë me mësimdhënien me nxënësit, kolegët e prindërit gjithnjë këmbëngulës, i respektuar dhe shembëllim i korrektësisë. Edhe bashkëshortja Flora Lela (Krosi) shëmbëllen në mësimdhënie në shkollën “Myslim Shehu” të qytetit të Peshkopisë. Fëmijët: Arlindi inxhinier elektrik, Olsi (emigrant mbaruar për menaxhim biznes dhe Edi nxënës i klasës së 8, tre djem, tre fëmijë si yje drite, të rritur e të mirëedukuar nga këta dy prindër punëtorë, shembullorë të mësimdhënies, me dëshmi e prova të diturisë, të reformimit në frontin e nderuar të arsimit. Dëshmi diturie, dëshmi drite.

Një peng i kahershëm, për të shkruar për të thjeshtin, të përkushtuarin, punëtorin e mësimdhënies e të drejtimit (pra, punëtor titulli e posti më i çmuar, autori M.B) Mensur Lela. Ai ka një “Ma” me punë, një shëmbëllim prej mësuesi e drejtuesi të palodhur, të përkushtuar me pasion, takt e reformim e meriton me çiltërsi atë që e karakterizon: Mensur Lela dëshmi e përkushtimit dhe e përvojave arsimore.

TRINOMI I KUSHËRINJVE LELA

Pasion, takt dhe reformim, ky është trinomi i kushërinjve Lela të Vakufit: Mensur e Ramiz Lela. Në fakt Ramizi ish mësuesi, drejtori e shefi i arsimit Dibër është me moshë më i madh se Mensuri. Me zemër në dorë, si i thonë, mendova të gdhend pak fjalë edhe për shokun e bashkëmoshatarin tim, gen selishtjan Ramiz Elez Lelën. Nisur nga provat, arritjet në frontin e arsimit e të kulturës Ramiz Lela është e mbetet ndër shefat më të suksesshëm të arsimit krahas Selim Alliut, Shemsi Manjanit, Beqir Shehut, Elmaz Lalës e plot të tjerëve. Pas 51 vitesh nga Durrësi, kur i telefonova nga Lukani, në prezencë të bashkëshortes time më bëri një vërejtje shoku, dashamirësie: “I shtrenjti Mevlud si ka mundësi që nuk ke shkruar sadopak për punën tonë para 50 viteve kur unë isha mësues në Kacninë e thellë të Katër-Grykëve e punonim bashkë me shpirt vetëmohimi, së bashku me shokët bënim atë që donte detyra, mësimi, kultura. Si nuk u shkrove pak radhë për këto gazetës tonë të nderuar “Rruga e Arbërit”?!

U zura shumë ngushtë. E pranova me çiltërsi kritikën e shokut tim të shkollës e shokut tim të shkollës Normale e të punës Ramiz Lela. Sidoqoftë për Ramiz Lelën do të kemi objekt një shkrim tjetër, fakte e prova prej modeli të mësimdhënies e të drejtimit, intelektualit që vlerëson e nderon brezat që krenohet me të kaluarën, të sotmen e atë që pret të vijë. u mundova, meditova dhe pendova.

Pse? Vërtet para më shumë se 50 vitesh me ish nxënësit dibranë të Normales së Elbasanit bënim epokë, gati çdo dy a tri herë në javë shpërfaqen emrat para gati 1 mijë nxënësve që merrnin veç nota 10 si Ramiz Lela, Mensur Murrja, Elmaz Lala, Qemal Begu, Rustem Murra, Mehmet Hasani, Iljaz Bande, Islam Meçe, Ilir Tola e plot të tjerë.

Altoparlanti që përgjithësonte provat e zotësisë kumbonte për nxënësit e dalluar dibranë, të cilëve u printe Ramiz Lela me shokë...

Një faqe e ndritur historie, një faqe rrezatuese pedagogjie trinomi i kushërinjve Lela: Pasion, takt, reformim; tri shtylla që lartësojnë punën e përvojat arsimore. Lum kush bën pronë të shpirtit e të veprimtarisë arsimore trinomin e kushërinjve Lela.

Pasion, takt, reformim.

***

Një peng i kahershëm, për të shkruar për të thjeshtin, të përkushtuarin, punëtorin e mësimdhënies e të drejtimit (pra, punëtor titulli e posti më i çmuar, autori M.B) Mensur Lela. Ai ka një “Ma” me punë, një shëmbëllim prej mësuesi e drejtuesi të palodhur, të përkushtuar me pasion, takt e reformim e meriton me çiltërsi atë që e karakterizon: Mensur Lela dëshmi e përkushtimit dhe e përvojave arsimore.



profil - cirk

Yjet e cirkut dibran me fjalët e një intelektuali të njohur dibran, që shprehet: Ata vlejnë me të vërtetë. Ata vlejnë shumë, më shumë se mosha...

Agron Strazimiri, *mjeshtri që mban gjallë cirkun në Dibër*

Nga **OSMAN XHILI**


Ekisha të vështirë të shkruaja për Agron Strazimirin, mjeshtrin e cirkut dibran. Ai kishte lënë gjurmë kudo, në gazeta të ndryshme, në emisione televizive, pse jo dhe në libra që i kushtoheshin këtij sporti të bukur dhe këtij mjeshtri të madh. A do të shtoja ndonjë gjë interesante, apo do të përsërisja të tjerët para meje? Nuk u tërhoqa. Në historinë e një mjeshtri të madh si ai gjen plot vlera, që flenë si minerale të pazbuluara akoma, apo të tjera spektakle që ai na dhuron për çdo ditë, javë e muaj.

Kisha dëshirë ta ndjek nga afër një ditë pune të mikut tonë të palodhur. Aty në krahun e majtë të shkollës së mesme të Peshkopisë, ishte një derë që të çonte te salla e cirkut. Ora dy pasdite. Nxënës që sapo kishin lënë mësimin afrohen tek kjo sallë, tek ky mjeshtër cirku, tek ky sport që u ka pushtuar zemrën e do të bëhet bashkëudhëtar i përhershëm në jetën e tyre. Nga dhjetra grupe që ka përgatitur maestro Agroni gjatë karrierës së tij të gjatë, ky është më i riu. Vetëm disa javë stërvitje kanë bërë. Nxënësit dhe trajneri i pasionuar sapo kishin filluar stërvitjen për atë ditë. Lenë për një moment stërvitjen, sa për tu përshëndetur, një prezantim të shkurtër dhe prapë në stërvitje. Shumica janë vajza. Që nga klasa e tetë e deri tek Orkide Qoka, në klasën e dytë, që mban dhe emrin e një luleje të bukur. Xhesika Mani, Klarisa Rizani, Artiola Derti, Gabriela Murrja, Eklivia Rustani, motrat Milani dhe Amaerta Lusha e më pas tre vajza me mbiemrin Selami: Anxhela, Blerina dhe Liljana. Këta janë vetëm disa emra, pasi grupi është i madh, me afër 25 veta.

Pasi kanë bërë pak vrap në palestër dhe disa pjesë të tjera të nxemjes, grupi punon me rrathët gjimnastikor. Vërtetë që është një sport i magjishëm, që të rrëmben fort e të bën për vete. Vetëm pak ditë më parë, kur profesori mundohej tu mësonte ushtrimet me rrathë, vajzave u dukej e pamundur. Të vesh njërin rreth në mes dhe dy të tjerë në duar e të tre rrathët të lëvizin në frekuencë të njëjtë. Por tani ata qeshin me frikën dhe mendimin e parë dhe po e ndjejnë dhe vetë që po bëhen mbretëresha të skenës. Rrathët u binden ideve të tyre, bile dhe lëvizjet e gjithë grupit janë në një perfeksion të plotë.

Pak minuta më vonë grupit i bashkohet dhe një djalë në klasën e tetë, por me një trup të gjatë e të bukur. Quhet Mario Mandri. Pasi bën nxemjen, demonstron disa ushtrime të mrekullueshme të kapërdimjeve në tavolinë, ushtrime në formë T- je, apo një ushtrim kinez me cilindrin plastik, që e realizon bashkë me profesorin dhe disa të tjerë. Dhe një djalë i vogël, Ernest Kunesha, në klasën e dytë, ka mësuar të lëvizë rrethin në mesin e tij dhe kjo gjë e kënaq pa masë.

Ata janë vetëm në hapat e parë, nuk kanë dalë akoma në shfaqje, në performanca dhe aq më pak në konkurrime, por jemi të sigurt që shumë shpejt këto do të ndodhin. Do të ketë konkurrime dinjitoze, por shpresojmë që të ketë dhe medalje të varura në qafat e tyre, siç kanë bërë grupet pararendëse vite më parë.





HISTORI SUKSESESH

Kanë kaluar shumë vite, që atëherë, kur Agron Strazimiri, vetëm gjashtë vjeçar do të debutonte në këtë sport, që do ta thithte përjetë në brendësinë e tij. Palestra e tij kishte qenë toka e paanë, tapeti i tij kishte qenë livadhi me bar e me lule. Ashtu e filloi karrierën e tij, pa ditur dhe pabesuar, që diku nga viti 1978, ai jo vetëm do të bëhej një aktor i mrekullueshëm cirku, por dhe drejtues i trupës së këtij sporti për Bulqizën, që e kishte ngritur Riza Gjeta vite më parë. Aktiviteti i tij lëkundej mes Bulqizës dhe Peshkopisë, për tu instaluar përfundimisht në qytetin e blireve. As vetë ai nuk e beson se si e ka kryer një volum të tillë pune. Ndoshta dhe njëmijë vetë mund të ketë stërvitur deri tani. Disa prej tyre e kanë lënë këtë sport, disa të tjerë e vazhdojnë akoma, por vlerat kënaqësinë dhe autoritetin që u dha ky sport, nuk do ti harrojnë kurrë.

Aktivitetet e kësaj trupe janë të shumta e të shumëllojta. Interpretimet e saj kanë qenë si në nivel fshatrash e komunash, brenda qarkut, në qytete të ndryshme të vendit, por pse jo dhe jashtë shtetit. Krasta, Martaneshi, Ulëza, Maqëllara, Kastrioti, janë disa nga stacionet brenda rrethit, kurse qytetet e Shqipërisë janë të shumta. Bulqiza, Peshkopia, Laçi, Tirana, Durrësi, Vlora, Kruja, Shkodra dhe shumë e shumë të tjera. Gjithandej spektakël, emocione, adrenalinë për spektatorët e shumtë.

Kur shfaqja kishte mbaruar në Shkodër dhe njerëzit përpiqeshin kush e kush ti takonte akrobatët e vegjël, njëri prej tyre, që e kishte pasion të shkruarin dhe humorin, siç e kanë gjithë shkodranët, i afrohet profesor Agronit dhe i dhuron një kartolinë. Kartolina ishte shumë e thjeshtë, tipike si ato që dërgonim dikur për Vitin e Ri te njerëzit tanë të dashur. Pak rreshta të shkruar në të. Agroni i lexon me një frymë dhe përlotet:

"Profesor, më fal një fije, / Ti lëvdatat i ke hak, / Duke i ba kta fëmijë yje, / Ja shton Dibrës një bajrak. - nga Qemal Hykaj."

Ajo kartolinë e thjeshtë e një artisti shkodran vlente shumë më tepër se medaljet e dekoratat e ndryshme, pasi buronte nga populli dhe jepej prej tij.

Profesor Agroni dhe ata fëmijë, plot shije, art e talent i kishin shtuar Dibrës një bajrak në sytë e shkodranëve të shquar. Po dhe sa bajraqe të tjerë i kanë shtuar ato Dibrës? Atje në Pallatin e Kongreseve, kur debutuan para katër mijë dibranëve të mbledhur për Rrugën e Arbërit, i'a shtuan një tjetër bajrak, aty në "Top Channel", kur doli në finalen e madhe dhe ai me katër akrobatët u vlerësuan nga publiku si fitues moralë të aktivitetit, u shtua një tjetër bajrak. 13 javë pa humbur, si një Skënderbe që koleksionoi aq shumë fitore në një çerek shekulli. Presjada Kacani, Aurel Istrefi, Fabiola Neli dhe Rubin Kacnia u bënë sundimtarët e vetëm të skenës. Sa shumë i dhanë Dibrës dhe sa pak Dibra u dha atyre. Ndoshta do të kishte mjaftuar ai sukses i madh tek "Ti vlen", që Agroni të kishte fituar titullin "Qytetar Nderi i Dibrës". Por ai nuk e ka atë akoma sot e kësaj dite. Jo se ai punon për tituj të tillë, por do të ishte një gjest minimal i mirënjohjes tonë kolektive për të.



Si për ta mbyllur këtë historinë e bajraqeve, po përmendim një tjetër rast në Fushë Krujë. Ka vite që aty organizohet festivali mbarëkombëtar i këngës për fëmijë. Ishin ftuar kolosët e artit shqiptar, Rexhep Çeliku, tashmë i ndjerë, Margarita Xhepa, Edit Mihali, Irini Qirjako. Ishte i ftuar dhe maestro Agroni me një grup prej tetë akrobatësh të vegjël. Kur interpretuan dibranët e vegjël, Irini Qirjako ngjitet dy herë në skenë dhe po qante nga emocionet që dhuruan talentet dibranë. Të tjerë artistë të mëdhenj u shprehën me superlativa për aktorët e vegjël.

DOBITE E KËTIJ SPORTI

Ato janë kaq të shumta, saqë nuk i numërojmë dot. Po të llogaritësh metrat e kilometrat që bën fëmija në një seancë stërvitore, është një shifër goxha e lartë. Ndoshta është sporti unik, që i përfshin të gjitha gjymtyrët e trupit në një masë të barabartë. Ushtrimet e belit dhe të qafës luftojnë si problemet reumatizmale, mbipeshën dhe sëmundjet e qafës. Kalitja fizike, durimi, largimi nga celulari, nga veset dhe injoranca, janë të tjera vlera që i dhuron njeriut ky sport i bukur e kreativ. Njohja me njerëz të rinj, me vende të reja, ku ato performojnë, është një tjetër vlerë e shtuar e cirkut. Megjithatë, duke u larguar nga pjesa teorike ne po e ilustrojmë me tre shembuj që flasin qartë.

Para disa vitesh vjen një nxënëse, Markela Çiku, për të filluar stërvitjen. Trupi i saj ishte pak mbi peshë, ndaj vajza qëndronte si e ndrojtur. A do të mundej trupi i saj ti bindej një disipline që kërkonte, forcë, shpejtësi e shkathtësi. Mjaftuan pak javë dhe gjërat po shkonin në rrugën e duhur. Muskujt po fitonin terren mbi yndyrnat e tepërta dhe muaj më vonë askush nuk mund ta besonte ndryshimin drastik. Trupi i vajzës fitoi bukurinë dhe forcën, që çdo vajzë do ta kishte dëshiruar. Për më tej ajo arriti të bëjë ushtrime të një shkalle të lartë vështirësie. Në ushtrimin në tavolinë, ajo kapte lulen nga prapa, të vendosur te këmbët e saj.

Rasti i dytë vjen nga një tjetër vajzë, Presiada Kacani. Emrin e saj e përmendëm pak më parë si debutuese dhe finaliste e programit televiziv "Ti vlen". Ajo erdhi fillimisht si një fëmijë shumë i dobët. Më e keqja ishte se kjo dobësi përfshinte dhe skeletin e saj e kockat rrezikonin thyerjen, në përplasjen më të vogël. Në një rast i bëjnë një injektim për të përballuar programin. Në pak kohë trupi i saj fiton kondicionin normal, duke arritur të bëjë ushtrime force dyshe, mbi këmbët e drejtuesit. Ndoshta këtu ka vend që mjekët e kockave dhe onkologjia të studiojnë e të eksperimentojnë dobitë që sjell ky sport në rehabilitimin e trupit në përgjithësi dhe skeletit kockor në mënyrë specifike.

Shembulli i tretë, por jo i fundit, i dobive të këtij sporti të magjishëm është vetë profesor Agroni. Mosha është ndalur te trupi i tij. Lëvizjet dhe shkathtësia e tij janë si të një njëzet vjeçari, por dhe në fytyrë tregon gjysmën e viteve që ka. Ai ka mbushur 64 vjet dhe si moshë po i drejtohet pensionit. Por duket se dhe pension nuk do të ketë për të. Ky sport i ka rinuar jo vetëm trupin, por dhe shpirtin e jetën. Ndaj ne i themi Agron Strazimirit, se ti vlen, se Dibra ka shumë nevojë për ty, se ajo kërkon që t'ja lartësosh akoma më shumë emrin në piedestale të larta.

Do të desha ta mbyll këtë shkrim për Agronin dhe yjet e cirkut dibran me fjalët e një intelektuali të njohur dibran, që shprehet: Ata vlejnë me të vërtetë. Ata vlejnë shumë, më shumë se mosha! Ata vlejnë më shumë se gjithë zyrtarët e shtetit në Dibër, të marrë së bashku. Ata vlejnë, jo vetëm se na bëjnë të ndjehemi krenarë, por se na tregojnë se mes nesh ka akoma njerëz që ruajnë vlera njerëzore, ruajnë përkushtimin dhe vullnetin për t'i bërë gjërat me dashuri dhe zemër!

A e kanë forcën e Llan Kaloshit qeveritarët e Shqipërisë, të Kosovës, të Shqipërisë Lindore dhe shqiptarët kudo që janë për ta ndalë kthimin e gjakut në ujë? Apo janë bâ realistë politikë, kozmopolitë, modernë. Ruejna Zot, e mos na lësho doret!

Për *misionin e* **Enver Kaloshit,** *arketipin* **Llan Kaloshi** *dhe* **Irfanin - një Kalosh**

PROF. DR. BAJRAM XHAFA

(vijon nga numri i kaluar)

Te pragu i derës, zani i të nipit u ndigjue i kthjellët e kumbues që ta ndigjonte mirë: *"Or babgjysh, shko pa merak, se, si të jetë Halili gjallë, ke me pa se ç'kam me bâ"*. Nuk vonoi shumë, si shkoi Haxhi Llani te shpia e vet, Halili me disa njerëz të vet ua vu pushkën atyne që kishin hy në tokat e Llan Kaloshit, i zgjidhën qetë dhe sa mund hikshin për nga shtëpitë e veta, tue i lanë parmendat në ara. Kjo qe e papritme për miq e armiq, me Kaloshin s'qenka punë, Kaloshi asht Kalosh e s'e jep të vetin për të huejin. Sidoqë t'i kenë punët midis tyne, nuk e lanë ta shkelë i hueji, se gjaku s'bahet ujë. (f. 87, nënvizimi B. Xh.)

* * *

Or babgjysh që ke një shekull nën dhé! Or shqiptarë që keni mbetë mbi dhé, që jeni në këtë tokë "këtu e 40 shekuj më parë, përmendur në këngët e Homerit", siç shkruan Pashko Vasa! "Janë tue na qitë". Ka mbi 200 vjet që armiqtë nuk na e (n)dâjnë pushkën që të na "qesin fare". E na e mbajmë pushkën në gropë të hinit, kundër njeni- tjetrit. Bjer njeni e bjer tjetri, njeni-tjetrit e tjetri njenit; sa mundet e si të mundet. Shqiptari me shqiptarin, shqiptari kundër shqiptarit, pa dâ e pa prâ, pa ndryshim kahje. Na i paskan ditë mirë huqet, na paskan njohtë mirë se për natyrë jemi edhe ujë i shtruem, shpirt i pastër, transparentë e xham kristali. Ja tregojmë ândrrën tjetrit ashtu siç e shohim.

Duke i ditur këto "cene" të shqiptarëve, nuk qe e vështirë që për Shqipërinë të bëhej gati një projekt politik perfid (djallëzor): Gjatë Luftës së Dytë Botërore vrasjen ndër vedi na e futën në sistem, e "konstituuan", e bënë dhe na e bënë "zakon politik".

Së pari krijuan "INSTRUMENTIN", veglën, PKSH-në, natyrisht, pasi hoqën Mbretin dhe: ... "LUFTË CIVILE", në daç quaje Revolucion Popullor, Revolucion Komunist, Bolshevik, Nacional Demokratik, a, quaje si të duash. Me këtë le të merret doktrina.

Objekti ishte dhe është një: shqiptari të vrasë shqiptarin; Shqiptarët të vrasin veten me dorë të vet; Që ata të mos kenë edhe se kujt t'ia kërkojnë gjakun (sipas Kanunit). Kombi Shqiptar të vetëvritet. Shqiptari e ka qafën të shkurtër dhe gjakun të nxehtë. Atyre shpejt i bie gjaku në kokë dhe me lehtësi mund t'i ngresh në pallë. Shqiptari e ban dekën si me le (me vëllanë). *Bijtë e nanës kuku për mu, / ju m'sho-shojnë, dynjaja m'ju*. Programi mason i "luftës civile" vazhdoi në "socializëm" me "luftë klasash". Pastaj, ndërroje modelin! Në të ashtuquajturin tranzicion e dhimokrati me "luftë partish" e bandash kriminale. Evropa na zhyti e na mbyti në antagonizëm. Kështu do të vijë edhe "hyrja" në BE. Atëherë Evropa luftën ndërshqiptare do ta bëjë "çështje të brendshme". Kështu bëhet gjaku ujë e kombi masë homogjene pa identitet. Kjo ndodh vetëm me kombin shqiptar, se me të tjerët, si bie fjala Maqedoninë e maqedonasit i krijojnë, në fillim si "çeshtje" reformash e si popullsi, me miell hua, pastaj si shtet (edhe pse pa emër e pa shugurim) e më së fundmi edhe si "komb", duke i nxjerrë nga sirtari, si Zeusi Athinanë nga koka. E na rrimë e diftojmë përralla folklori me besë e bujari, përralla dushkut e dokrra hinit. O shqiptari im! "Janë tûe më qitë".

Shihe si lakohen, gjymtohen e shkurtohen pa mê e pa dâ kufijtë e Shqipërisë. Ka dyqind vjet që vetëm copëtohen e tkurren. S'ka si bahet namë ma e madhe për Shqipërinë. Mo Zo ma keq! Popull i rrezikuar me zhdukje. Para 150 vjetësh ishim sa dyfishi e serbëve, shkruan Ami Bue. Genocid. A e kanë forcën e Llan Kaloshit qeveritarët e Shqipërisë, të Kosovës, të Shqipërisë Lindore dhe shqiptarët kudo që janë për ta ndalë kthimin e gjakut në ujë? Apo janë bâ realistë politikë, kozmopolitë, modernë. Ruejna Zot, e mos na lësho doret!

IRFANI - NJË "KALOSH"

Pas largimit tim (B. Xh.) nga shkolla teknike endé pa filluar mirë viti shkollor, nga gjysma e dytë e shtatorit 1960 i vazhdova mësimet në Pedagogjiken e Peshkopisë si i jashtëm. Në klasën e IIA ku u regjistrova, për mua pothuajse të gjithë ishin të njohur, sepse me shumicën prej tyre kisha qenë në shkollën 7 vjeçare "Demir Gashi". Vetëm pak prej tyre ishin të panjohur për mua. Midis tyre ishin edhe dy Irfanat: një Sinë e një Kalosh. Këta kishin të përbashkët moshën më të madhe se të tjerët, si ndonja 3-4 vjet. Kishin patur peripeci në vazhdimin e shkollës dhe në Pedagogjike kishin penetruar me "sforcë". Por kryesorja, ishin me hije në biografi, madje "hije" të rëndë, të "deklasuar", siç klasifikoheshin në aspektin social-politik. Ky ishte "statusi" social i tyre.

Për një "Sinë" kam shkruar para nja dhjetë vjetësh, për Musa Sinën, një mik fort i dashtun për mua dhe për shumëkend, *"Elegji për Musën"* (tetor, 2009), një kushëri i Irfanit "tonë". Sot po merrem me Irfan Kaloshin.

Në klasë Irfani rrinte në tavolinën e fundit nga e majta, në qoshe, sikur të desh të fshihej; Bashkë ne Rexhep Hoxhën nga Muhurri, "homogjenë" politikë. Irfani tjetër, Sina, ishte strehuar diku nga tavolinat e mesit të klasës, përzjerë me masën (proletare!). Në dukje, mbase kërkonte një tjetër "homogjenizim a integrim". Ky i fundit, edhe kur përziehej në muhabete e shakara me ne më të rinjtë, fliste thjesht, me fjalë plaku e me "llaf vendi" dhe fjalët tona i shihte si të "axhamive" dhe shpesh i përsëriste duke i shoqëruar me një të qeshur ha, ha, e hi, hi. Kaloshi ishte dinjitoz e serioz. Në fillim rrallë kujtoj ta kem parë duke qeshur, por ma vonë iu zbut çehrja. Por jo i errët e i vranët, as i mërzitur. Ishte i hapur dhe mësonte mirë, madje, studionte. Nuk ish i pari në klasë, por ndër më të mirët. Kishte interesa intelektuale. *Nuk i jepte vedit*, si thonë në Shkodër.

Duke qenë nxënës i jashtëm, jo qytetar i Peshkopisë, me këtë kategori nxënësish unë pata të përbashkët të jem pjesë e "Konvikteve të rrugëve", siç i quan shkrimtari dhe studiuesi dibran **Xhafer Martini** në librin ***"Pedagogjikja & Personalitete".*** Por unë prapë se prapë nuk isha në pozitën e tyre. Mua dhe disa prej tyre, që hijen e biografisë e kishin më të lehtë, na lejuan të "akomodoheshim" në një dhomë në bodrumin e konviktit të shkollës, ndërsa të tjerët strehoheshin te "Hani i Seferit" poshtë në Pazar, ku era hynte e dilte në qejf të vet ose nëpër kolibe të sajuara anash rrugëve që "mo Zo ma keq". Kështu e vazhdonin shkollën dy Irfanat tonë.

Unë në një farë mënyra, padashje bëra "kauzë të përbashkët" me këta, sidomos me Kaloshin. Si djalë me bonsens, me të ishin shokë edhe të tjerët, madje, disa më shumë se unë. Ishte i hijshëm dhe i kanshëm në shoqëri. Rexhepi e kishte të arsyetuar shokërinë me të. Por ai ishte shok i mirë edhe me Ramazanin (Ilnica), që ishte edhe sekretar i rinisë së klasës, me Lavdërimin (Shehu), me Surjain (Stafa). Me këta e lidhte më shumë edhe letërsia, sepse klasa jonë kishte lexues të mirë. Zani dhe Rakip Lasku nga Guri i Bardhë i Matit i përpinin romanet dhe, prirjet e përbashkëta bëjnë edhe "miq...të librit". Pastaj edhe me të tjerët.

Na lidhte edhe varfëria. Irfani më kërkoi këpucët për një mbrëmje vallëzimi, këpucët me shollë dhe me majë, bërë me porosi, jo fabrike, 1800 lekë, të kuqe. I kisha me lekët nga puna gjatë verës në Rruga-Ura. Sa falenderime mora, sa me të ardhë keq. Ndërsa unë edhe sot ruaj si kujtim një fotografi, dalë te shatërvani, në Parkun "Rinia", i zbukuruar me trikon prej leshi të Irfanit, të pangjyer, por me një patentë të vogël zinxhiri dhe që më rrinte aq mirë. Në atë moshë të gjitha gjërat na "rrinin bukur e mirë".

Mua shpejt më bënë vend në konvikt dhe gjatë vitit të tretë ndjehesha gjithmonë e më i sigurt. Më dhanë edhe bursën, të plotë. Ndaj më "kërceu" nji çikë mendja dhe mora pak vrull adoleshentësh. Kështu ka ndodhur gjithmonë. Një ditë të bukur pranvere ia kandisa mëndjen edhe Irfanit për të lënë mësimin e për t'u hedhur në "divertiment" (largim, zbavitje). Fundja njeriu një ditë edhe të sëmuret. Për përgatitjen e herbariumeve, profesori i zoologjisë na kish dhënë detyrë të bëjmë nga një kapse fluturash, një shkop në të cilin ishte fiksuar një rreth teli mbështjellur me grykën e një strajce pëlhure. Me të në dorë, ashtu si ilegalët dolëm fshehurazi nga rruga e spitalit, në Kamén dhe pastaj u lëshuam përpjetë djerrinave e livadheve të Staravecit. Harbuam lart e poshtë në boshllëk, kapëm a s'kapëm ndonjë flutur dhe... filluam kuturisjen me gjithëfarë muhabetesh.

Irfani kishte prirje për letërsinë dhe lexonte edhe libra të verdhë, ndërsa unë më pak, prandaj ai drejtonte muhabetin. Fliste sidomos për poezinë, për autorët e rinj të asaj kohe dhe i recitonte, për Musa Vyshkën, Bilal Xhaferrin e ndonjë tjetër. Më komentonte Fishtën dhe sidomos Mjedën. Vargjet dhe strofat Mjeda sikur i gdhend me teskë (qeser), kishte lexuar diku. Por që shkriheshim që të dy, kur merrnim "Andrrën e jetës": *"Molla t'kputuna nji deget,/ Dy qershija lidh n'nji rrfanë,/ Ku fillojnë kufijt e geget, / Rrijnë dy çika me nji nanë"*. Motive fshati, idilizëm. Më thoshte pastaj, se për vjershat gazetat edhe paguanin. Për një varg a për një stofë, gazeta "Drita" a "Zëri i Rinisë" paguante 14 lekë, gjë që ishte tunduese. Kush i dinte këto punë. Dhe aty për aty sajonte një apo dy strofa. Unë tani mund të fitoj 28 lekë dhe bënte një ha, ha, ha. Mesa duket llogariste drekën, që ai e kishte krejt të zbuluar, jo si unë që e kisha grazhdin gati. Kështu bëhesh edhe poet, edhe me pare. Se katër strofa bëjnë aq e kaq lekë dhe ashtu e kaluam kohën me "mësim në natyrë", me llogje Kavaje e me "korr e mos lidh".

U vërdallisëm sa mundëm, por koha nuk po shtyhej. U mërzitëm ndaj morëm tatëpjetën për kthim. Duke zbritur rrugës së spitalit, që nga dritaret e korridorit të shkollës dukej si në pëllëmbë të dorës, na kishte vënë re profesor Ismaili. Si profesor kujdestar ai përgjigjej edhe për disiplinën e klasës. Me të shpejtë na zuri pritë aty ku dhe do të shkonim, tek porta e hyrjes nga konviktit i vajzave, vend i sigurt nga mendonim të kalonim për t'u strehuar poshtë tek komodinat derisa të mbaronte mësimi. Sapo hodhëm hapin e parë tek pragu i derës befas u shfaq profesori, bëri me dorë një hark, një prapaktheu dhe na mori në gjendje arresti. *"Shpejt! Pas meje! Pas meje! Keni ikur nga mësimi, a?"* Asnjë fjalë më tepër dhe me pamje serte u lëshua me hap të shpejtë, siç e kishte zakon kur përshkonte shkallët dhe korridoret e shkollës. Ai para e ne prapa dhe drejt e në klasë, ku na zbrazi si thasët në një magazinë. Sapo kishte filluar ora e fundit e mësimit, e letërsisë. "Shoku drejtor! Pranoji këtë orë se këta kanë ikur nga mësimi", - mbylli derën dhe çau e iku. Mirë na e bani, deshëm edhe të divertoheshim, ne burrat e mirë! Drejtori vazhdoi mësimin pa thënë ndonjë fjalë dhe në mbarim na thirri në drejtori.

Ishte hera e parë që hyja në atë drejtori. Nuk kisha qenë ndonjëherë për ndonjë gjë dhe kjo kishte qenë edhe hera e fundit. Kisha kuriozitet. Dritarja prapa karriges së drejtorit ishte edhe derë për të dalë në ballkonin e katit të dytë, që asnjëherë nuk e pashë të funksiononte. Kishte një perde të rëndë që e errësonte zyrën. Në faqe të murit pranë tavolinës ishte ngjitur një fotografi e Tolstojt, shkëputur nga ndonjë revistë, shkrimtar të cilin drejtori e kishte si idhull.

Të tre qëndruam në mes të drejtorisë, në këmbë, para tavolinës. Së pari, u muar me Irfanin. E nisi ashpër, me zë të lartë e gjithë sforcim, madje i bërtiti, që s'e kisha parë të bërtiste ndonjëherë. Ishte një e bërtitur si e shtirë, pa shpirt, e imponuar. *Pse ke ikur nga mësimi, pse thyen disiplinën, kush të ka mësuar kështu?* E shumë pyetje të kësaj natyre që tani nuk i mbaj mend. Një ashpërsi që ishte krejt jashtë natyrës së tij fisnike. Pastaj u kthye nga unë. I skuqur deri më majë të veshit, siç bëhem zakonisht edhe për gjënë më të vogël, mua më foli me ton më të butë (mbase bëri dallim klasor, mendova). *"Ç'e ke atë fotografi të atij këngëtarit gërmuar mbi kitarë me gjunjë të përthyer kështu"*, dhe i bashkoi konkavë shpinat e duarve. Ishte fjala për një fotografi koncertesh të Adriano Çelentanos të cilën e kishte një tjetër nxënës që e kishte vënë në kapak të komodinës. Por nuk hyra në sqarime, se vetë isha pulë e lagur. Atëherë shisnim mend me fotografi artistash e këngëtarësh që shpesh i ekspozonim në kapak të komodinës që të dukeshim me "kulturë" kur shokët e shoqet dilnin nga menca, ndërkohë që ndanim librat për studimin e pasdites.

Por me drejtorin shpejt e rregulluam, sidomos gjatë maturës. Orën e letërsisë e kishim forum diskutimesh të shumta për autorë, ide, e personazhe kryesore të veprave letrare. Me ato lekët e "Rruga-Urës" që fitoja gjatë verës, përveç një palë pantallona stofi 900-lekësh dhe një palë këpucë me majë, të tjerat i bleja libra dhe kinkalerira, por edhe gazetën "Drita" të së dielës. Aty përzgjidhja ndonjë shkrim me të cilin tërhiqja vëmendjen për të "pasuruar" programin e tekstit mësimor. Në diskutime prinin Zani, Hamdija, Irfani, Lavdërimi, Surjai, Rakipi edhe unë. Një herë kisha marrë me vete edhe një broshurë të Zhdanovit, me nënvizime siç e kisha zakon, që kur drejtori ma pa nën bankë, u çudit dhe kërkoi ta shihte. Mbase ishte simpatia e dikurshme e tij për të kur kishte qenë në Moskë, një student vërtet i shkëlqyer. Në orën e letërsisë së huaj, klasa jonë ziente nga diskutimet. Drejtori i nxiste me art debatet dhe nga kjo kënaqej.

Ditë pas dite Irfani, ashtu si dhe ne, rritej, mbushte shtatin, i buzëqeshte e ardhmja. Pse jo? Ishte i ri, i shëndetshëm, shulak, me trup të ngjeshur mirë, kishte trup mundësi. Edhe mendjen po e seliste me dije. Bleu apo i blenë edhe një orë dore, siç kanë qytetarët. Se katundarët mbajnë orë xhepi. Një UMF gjerman ishte (i Gjermanisë Lindore, se mos kujtosh atë qoftëlargen, Perëndimoren), nga më të lirat, 2000-lekëshe, se të tjerat kushtonin 5000 e 7000. Më të lirën, por ama vetëm ai nga nxënësit kishte orë në të gjithë shkollën, ndoshta në gjithë historinë e shkollës. Vëllai i tij i madh, Enveri, e kishte mbaruar pedagogjiken dhe ishte mësues. Madje vazhdonte me korrespondencë Universitetin e Tiranës për Histori-Gjeografi dhe ishte afër fundit. Edhe vëllai tjetër i tij, Kadriu, që vinte pas, po aty ishte strehuar, në Pedagogjike, për pak dije, të bëhej mësues. Kuuush?!!! Çfarë? Po ia merrnin me krahëmarrje diktaturës. Hëh!

Atë që diktatura e kishte pasë (dhe e kishte) në grykë të pushkës, Kaloshi filloi të shohë anën e butë të saj. Koha zbut gjithçka, si shiu tokën kur ajo çahet nga thatësira. Më në fund familja e Mehmet Kaloshit ishte mbledhur e tëra në shtëpi: I zoti i shtëpisë, shtylla e saj, Babë Meta, siç i thoshin për shkurt, gruaja e tij, Nanë Sibja dhe tre djemtë, Enveri, Irfani dhe Kadriu ishin përreth votrës së shenjtë të familjes. I kishte planifikuar Zoti me dorë të vet. Tre vllaznit motër nuk kishin, që t'i jepte më shumë rreze drite shtëpisë, por aní, s'ka dert. Ato janë punë të Allahut. Familja kishte ra "pushim".

Babë Meta e kishte kryer të plotë me 15 vjet të rrasta "riedukimin", siç i thoshin me eufemizëm burgut, me gjuhë të figurshme. Një jetë njeriu dhe në ma të mirën kohë, por shyqyr u kthye më së fundi në shtëpi. Nuk kishte shumë që kishte dalë nga hapsana, më 1961, nga ajo skëterrë. Kishte frikë ta kujtonte atë makth të stërgjatë dhe desh ta shtynte sa më tutje e të distancohej sa më shpejt prej tij. T'i gëzohej kësaj që i kishte kishte e që shihte. Sepse, jo pak nga shokët e tij vazhdonin të ishin atje ku i kishte lënë, në kaushë e në qelítë e mbushura plot e përplot, që kur i kujtonte i shkonin mornica në trup. Vërtet nuk ishte më parí (derë e Parë, thënë ndryshe, bajraktar), as uniformën e oficerit të ushtrisë kombëtare dhe kapelen me stemat mbretërore nuk i kishte, por kishte vu kësulën e bardhë të Dibrës dhe kishte kapë parmendën; tek e fundit si gjithë të tjerët, me gjithë të tjerët dhe si paraardhësit e tij.

(vijon në numrin e ardhshëm)

traditë

FJALË E FRAZEOLOGJIZMA TË RRALLA

Marrë nga libri "Toponimia e Çidhnës" i autorëve

Haki Përnezha dhe Rruzhdi Bitri,

Botimet M&B, Tiranë, 2016.



FJALË TË RRALLA

L

►***liç / litʃ / líç-të:*** Penjtë në vendosje vertikale në vek.

►***letajn' / lɛtajn' / létâjn'-a:*** Rrjedhës uji shumë e shpërndarë.

►***lehes / lɛhɛs / léhes-a:*** *Lahes* (nga *laj*), një copë dërrasë për të rrahur rrobat gjatë larjes. Çabej dhe FGJSSH, për të njëjtin objekt, njoftojnë formë *kopan. Lahesa* s'është e njëjtë me *kopanin* a *pallën,* sido që të tria shërbejnë jo vetëm për të larë rrobat.

►***leran' / lɛran') / lêran'-a:*** *Leranë* quhet një dërrasë e plotë, e fortë, zakonisht prej pishe, mbi të cilën vendoset *mullarthi* i mullirit. Është pjesë që qëndron vazhdimisht në *sqotën* e mullirit, e mbuluar gjithnjë me ujë dhe rërë.

►***larëj / larəj / lárë/j,-va:*** *Lëroj*, nga *lavrë, hulli. Një lavrë tokë, tokë që punohet në një ditë me qe*. Tek Çabej del *lëvroj*. Në të folmen vendëse del vetëm me kuptimin *punoj arën*.

►***l'vraçk'/l'vratʃk')/l'vráçk'-a:***

E lëvizshme, që bën lëvizje të shumta e të shpejta. Zakonisht kjo fjalë u drejtohet femrave që janë të lëvizshme. E di unë se ajo është *l'vraçk'*.

►***lisk' / lisk') / lísk'-a:*** Quhet kështu bagëtia (dele apo dash) që kanë njolla të zeza në pjesën e kokës. Tek Çabej, *vakër.*

►***leçe / lɛtʃɛ / lêçe-t:*** *Lash leçe,* bëj figurë të keqe.

Ll

►***llad***ës / ładəs ***/ lládès-a:*** *Dëborë gjysmë e shkirë, skllotë, llohë*.

►***llokovajn' /*** łɔkɔvajn' ***/ llókovâjn'-a:*** Tokë me shumë *llokë balte*; gjithashtu dhe *dëborë gjysmë e shkrirë*.

►***llaçk' /*** łatʃk' ***/ lláçk'-a:*** Bagëti që pjellin para se t'ju vijë koha. *Më ka pjellë një dhi llaçkë.*

►***lla /*** ła ***/ llâ-na, u llâna:*** U ngopa. Nuk ha më shumë se *u llana. U ngritëm nga buka ashtu lla e pa lla.* Edhe *ia llani mullën,* ia mbushi me plumba. Çabej sjell formën *fa: asht fa dynjaja.*

►***llanajk /*** łanajk ***/ llanâjk-u:*** Drurë të prerë nga lisat e rinj me diametër 15-20 cm dhe të bërë gati për t'u ngarkuar. *E kishte mbushur kalin me llanajkë. Besojm*ë nga *lanë, landë, lanajk, llanajk*.

►***llakërdëj /*** łakərdəj ***/ llákërdè,-va:*** Flet shumë, vend e pa vend. *Boll llakërdove!*

M

►***mule-mule / mulɛ-mulɛ / mulê-mulê:*** Nxito, nxito: *muleni burra se u dogj shtëpia*. Përngjitje e një fjalie: *mos e leni*.

►***m'çere / m'tʃɛrɛ / m'çér/e-ja:*** Djathi i sapodalë nga kallëpi, ena ku përgatitet, ose napa ku është kulluar.

►***murriç / muritʃ / múrriç-i:*** I vogël, vetëm ligjërimit gojor.

►***m'çajhes / m'tʃajhɛs / m'çâjhes-a:*** *Mshisë, mshesë, fshesë*. Copë rrobe që shërben për të fshirë e pastruar. *M'çajhes çerepi; nusja jonë si lule qepi / Nana e saj si m'çajës çerepi* (pop.).

►***m'njën e veton / m'ɲə ɛ vɛtɔn / m'njèn e veton:*** *Gjëmon e veton, vetëtin*. *Mnjon, mënjon, metatezë e gjëmon, dëgjon, mënjon, mnjon*. Bubullon, bullullin. Ndërsa *veton* është formë dialektore për *vetëtin, vetëton*. Fig., me zhurmë: *ai erdhi tu mnjue.*

►***muçil / mutʃil' / muçíl'-a:*** *Moçal,* vend moçalishte.

►***m'rroçkull / m'rɔtʃkuł / m'rróçkull-a:*** Vegël e vogël, pjesë e një mjeti: ç'është kjo *m'rroçkull?* Nga *rrokull, rrotë e vogël* (krhs. *mrrokull* në të folmet e Shqipërisë së Mesme).

►***m'një / m'ɲə / m'njè-j:*** *I gjej vendin e sigurt*: *m'njoje lopatën*; *i ka m'njue mirë dhe nuk i gjen askush*.

►***maças / matʃas / mâças:*** *Shtrembër*: *ke marrë maças, nuk është ashtu* (e ke kuptuar gabim problemin). Nga *majshtas, majtas.*

►***m'lla / m'ła / m'llâ-ni:*** Lungë e vogël. Nga *mulla*, *mlla*; kjo e njëjta me *mullë*, bark. Edhe fig.: *më është ba mlla* në fyt, më ka mërzitur dikush aq shumë sa më vjen të qaj.

►***majde / majdɛ / mâjde-ja:*** Jo si tek Çabej, por me kuptimin *zotësi, dije, vështirësi*: s'*don noj majde* të madhe kjo punë.

►***manâ / mana / manâ-ja:*** Çabej fj.*manâ* e lidh me *madje.* Në të folmen vendore barazohet me fjalën *kuptim: a e more vesh kush ishte manâja e atij muhabeti*? *Ishte pune me manâ* të madhe.

►***maz' / maz / máz'-a:*** Tek Çabej, *ajkë qumështi* [298]. Në të folmet e vendit fjala *mâzë* shërben edhe për të emërtuar lopën që sapo i është ndarë viçi. Quhet *mazë* derisa ajo të ndajë për barsë dhe nuk e ka prerë qumështin. Kur lopa e kalon kohën për t'u mbarsur, atëhere quhet *kastërmâzë.* Ka shumë lopë që periudhën si *mâzë* e kanë të shkurtër, pasi e ndalin shpejt qumështin. Atëherë quhen *shterpë: lopën e pata mâzë, por iu prish gjiri e hini ndër shterpa.*

Tregim alegorik

Zgjuarsia lindi në Shkodër, hëngri drekë në Mirditë dhe qëndroi në Dibër

Tregohet ndër dibranë se Hoxhollët e Dibrës përbënin një fis të madh e të dëgjuar në ato anë, të cilët në kohën e pushtimit osman i kishin kërkuar Vezirit të Shkodrës vajzën për nuse në fisin e tyre. Kishin shkuar disa muaj që ishte rënë në ujdi dhe kishin bërë adetet e rastit që i takonin një fejese. Pritej vetëm fjala e Vezirit si babai i vajzës për të caktuar ditën e dasmës. Madje ishte lënë fjala që më pare, se brenda tre muajve do të bëhej martesa, por nuk ishte prerë data e saktë. Me që nuk po merrej përgjigje dhe kjo pengonte masat për të përgatitur dasmën, Hoxhollëve po u soste durimi.

Mirëpo, Veziri i Shkodrës siç kuptohej kish ndërruar mëndje. Duke e quajtur veten si Derë më lartë se Hoxhollët, paskej menduar për ta dhënë vajzën në një Derë "më të fisme". Për këtë shkak ai po e zvarriste fjalën. Kjo situatë pritmërie, i kish shtyrë Hoxhollët e Dibrës të dërgojnë një përfaqësi të tyren tek Veziri i Shkodrës, duke i kërkuar fjalën për herë të fundit. Përfaqësia përbëhej nga 11 dibranë, të gjithë me rroba shajaku (siç e kish zakon zona e tyre), kish në krye një që quhej Demir, i cili ishte me shtat të shkurtër dhe me hundën paksa mënjanë, veçse njihej si i zoti i fjalës. Porosia për ta ishte që nuk duhej larguar nga Veziri pa e marrë fjalën të prerë.

U ulën dibranët në konakun që priste Veziri, por ky as që u ngrit nga vendi për t'u dhënë dorën. E mbante veten rëndë-rëndë jo vetëm me këta, por me çdo lloj miku që i shkonte në shtëpi. Në këtë rast u tregua akoma më fodull nga që nuk i pëlqeu nga shtati dhe pamja, njeriu që ishte në krye të dibranëve. Sigurisht edhe veshja e tyre me rroba shajaku. Megjithatë, këmbyen llafet e para dhe dibrani Demir, foli:

-Vezir i Madh! Më kanë çue me të thanë se kemi dasmë këtë vit. Do marrim cucën tande nuse për djalin tonë. Na thuj një fjalë, kur e ke ndërmend…?

Veziri i dëgjoi me indiferentizëm fjalët e tjetrit, shkundi llullën e duhanit (nargjilenë) tek takëmi përkatës dhe si pa përfillje por edhe për ta tallur dibranin që foli, tha:

-Na vajti dëm kripa, na është prishur e tëra dhe s'po dimë si do veje puna për kripë këtej e tutje.


Në fakt kripa nuk kish si prishej, por Veziri desh t'i shihte mendjen atij që ishte në krye të dibranëve, Demirit. Mendonte se ai duke qenë me trup të vogël, e ca i shëmtuar, edhe mendjen do ta kish të mangët.

-Mos kij gajle madhëri,- ia kthen Demiri,- kripa rregullohet me qumësht mushke…!

U desh kjo përgjigje që Veziri të ngrinte sytë që deri atë kohë i mbante ulur. Nuhati që dibrani që foli nuk qenka budall, por mendjehollë, sepse mushkat përderisa nuk pillnin, s'kish si të kishin qumësht. Por me këtë "kunj" të Demirit, shpërfillej fodullëku i Vezirit.

Mbas kësaj Veziri ndërroi taktikë. Thirri ordinancën e vet dhe e porositi për t'i veshur dibranët me kostume të mira, nga ato që mbante qyteti, sepse sipas tij rrobat e tyre prej shajaku i quante "alldupshe", fshatarake. Gjithësesi, dibranët i veshën kostumet dhe nuk e kursyen falënderimin për këtë "kujdes" të Vezirit. Por ai nuk e la me aq.

-Kam dëgjuar se ju dibranët jeni ndërtues të mirë, por mesa di, shtëpive ua bëni oxhakun të shtrembër…



Nënteksti qe për hundën jo të drejtë që kishte Demiri si i Pari i dibranëve në konakun e tij.

-Ashtu asht,- ia ktheu me një herë Demiri,- por edhe kur oxhakët i bajmë shtrembër, tymin e heqin drejt, o Vezir aga…

Kjo do të thoshte, "mos më shiko hundën, por mendjen".

Tashmë Vezirit po i mbushej mëndja se ai dibrani që nuk e përfilli në fillim, po i dilte ndryshe, nuk i mungonte mençuria. Por deshi të bënte edhe një provë tjetër. I kërkoi Demirit, nëse i dinte cilët ishin Vilajetet e Shqiptarëve. Një pyetje me ligësi e Vezirit, që sipas tij me siguri dibrani nuk do kish haber dhe do t'i bënte me turp ardhësit. Por, edhe kësaj pyetje Demiri ia doli.

-Ai i Kosovës, është për luftë e besë,- tha Demiri. I Manastirit, për mëndje. I Janinës, për diplomaci. Ndërsa ky i Shkodrës ku jeni Ju, është për salltanet e kapardisje…

Mbas kësaj, Veziri nuk kish ç'të thoshte më. Thuajse mbeti i "dorëzuar".

-Hë,- vazhdoi Demiri,- më thuj, a t'i kam gjet ato që më pyete?

Veziri kish ulur kokën dhe po dukej disi "i vogël" para dibranëve që nuk ia kishin mbushur syrin.

-Për tre javë,- ia preu Demiri, tashmë si ngadhnjimtar,- do vijmë të marrim cucën. Ndryshe do kesh punë me ne dibranët…

Veziri, mbas kësaj nuk luajti më me llafe, por ra dakord.

-Tash po çohemi, por desha me më përcjellë sipas zakonit deri jashtë oborrit të shtëpisë tate,- iu drejtua Demiri, Vezirit,- se kam dhe do fjalë të tjerë për të të thanë.

Ja tha këto që ta shkulte nga vendi ku Veziri rrinte ulur rëndë-rëndë e që në asnjë rast nuk e kish prishur atë rregull. Ia tha që t'ia ulte më tej fudullëkun. Deshi, s'deshi,Veziri, u ngrit dhe në përcjelljen deri tej shtëpisë së tij, Demiri i përsëriti edhe një herë fjalët që tha tek konaku:

-Për tri javë, jemi këtu për të marrë nusen…Ja këtë desha të të them…!

I habitur Veziri me zgjuarsinë e dibranit Demir, ndonëse e quante të shëmtuar,tha:

-Zërin ta dëgjofsha or dibran, por me sy mos të pafsha më…

-Epo,- tha shkurt Demiri,- thonë se zgjuarsia lindi në Shkodër, hëngri drekë në Mirditë dhe qëndroi në Dibër…

U ndanë pa ia dhënë dorën njëri-tjetrit.

(Shkëputur nga libri "Ngjesh e qesh" -101 rrëfime me realitete, qesëndi e humor- i autorit GëzimVoda)

Profesor Shaban Sinani zgjidhet me vota maksimale si anëtar i Akademisë së Shkencave

Disa ditë me parë u zgjodh edhe si sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave

Shaban Sinani, më 21 shkurt 2020, përmes një procesi votimi nga anëtarët e Asamblesë së Akademisë së Shkencave, u zgjodh Akademik me të drejta të plota.

Ky zgjedhje kaloi përmes një procesi të fshehtë votimi, ku ai mori 34 vota pro, një kundër dhe një abstenim.

Disa ditë më parë ai zgjodh edhe në detyrën e Sekretarit Shkencor të Akademisë së Shkencave.

Për lexuesit tanë, ne po sjellim disa nga botimet kryesore si dhe vlerësime për akademik Shaban Sinanin nga personalitete të shquara brenda e jashtë vendit.



Në foto: Akademik Shaban Sinani dhe shkrimtari Ismail Kadare



Sa vite pune, aq vepra

Naim Zoto, botues:

Teza e doktoratës në fushën e antropologjisë kulturore me titull *"Mitologji në eposin e kreshnikëve"* është mbrojtur nga Shaban Sinani në vitin 1998. Kjo tezë e përpunuar dhe e zhvilluar më tej si libër ka njohur disa botime dhe ribotime, duke shërbyer si tekst bazë për degën përkatëse në universitetet shqiptare.

Rruga e formimit dhe vetëformimit të Shaban Sinanit në *antropologji* rezulton me studime për *etnicitetin* në trashëgiminë joshkrimore të shqiptarëve (tri monografi të botuara); me studime për traditën e doréshkrimeve dhe shkrimeve parashqipe në kulturën e vendit (tri monografi të botuara); me studime për praninë kulturore dhe mbrojtjen e hebrenjve në Shqipëri përgjatë dy mijëvjeçarëve (tri monografi të botuara); disa studime të tjera për shtresime, nënshtresime e mbishtresime të kulturave joshqiptare në pasurinë shpirtërore kombëtare (tre libra). Paralelisht më këto, prof. dr. Shaban Sinani ka vijuar kërkimet në historinë e letërsisë, me pesë monografi të botuara dhe disa përmbledhje studimesh, që kritika i ka cilësuar *shqyrtime antropologjike*.

Cilësi e studimeve të Sh. Sinani është *ndërdisiplinoriteti*. Etnosi shqiptar në trashëgiminë gojore, kodikët e Shqipërisë dhe vendi i tyre në traditën botërore të shkrimeve, *sjelljet etnotipike të shqiptarëve* ndaj të huajve (hebrenjtë, kulturat e vendeve fqinje, kulturat e ardhura me perandoritë ku është përfshirë populli shqiptar), *letërsia në periudhën totalitare* dhe kushtëzimet e saj me traditat dhe autorët më të rëndësishëm të mëhershëm, janë disa prej fushave në të cilat janë ndërthurur dije të albanologjisë nga antropologjia, etnokultura, gjuhësia, historia, burimologjia dhe letërsia.

Janë mbi 35 libra të botuar nga Shaban Sinani deri tani (po aq sa janë vitet në librezën e tij të punës), prej të cilëve mbi 20 janë studime monografike. Disa prej tyre janë botuar e ribotuar disa herë, dy prej tyre edhe në gjuhë të huaja.

Prof. dr. Shaban Sinani ka drejtuar projekte shkencore ndërqeveritare, qeveritare dhe institucionale, duke përfshirë projekte të BE-së. Ai është hartues programesh universitare për ciklin master e doktoratë për lëndët: histori shkrimesh e doréshkrimesh, folkloristikë e krahasuar, mitologji, trashëgimi arkivistike, etnokulturë, histori e thelluar dhe problemore e letërsisë.

www.botimenaimi.com

BOTIMET MË TË RËNDËSISHME TË AKADEMIK SHABAN SINANI

(Vetëm librat e publikuar; nuk janë përfshirë artikujt shkencorë)

1. 1997: ***Pengu i moskuptimit***, studime letrare.
2. 1998: ***Sipërore***, studime letrare.
3. 1998: ***Kosova në gjeopolitikë***, analiza dhe publicistikë.
4. 1999: ***Kosova në syrin e ciklonit***, analiza dhe publicistikë.
5. 1999: ***Kosova, një vështrim enciklopedik***, botim studimor i Akademisë së Shkencave, bashkautor (tre kapituj).
6. 2000 (bis 2001, 2002, 2012): ***Albania - a Patrimony of European Values***, botim i UNDP, bashkautor (shtatë kapituj).
7. 2000: ***Letërsia bashkëkohore shqiptare***, tekst mësimor alternativ, bashkautor, ribot. 2001-2012.
8. 2000: ***Mitologji në eposin e kreshnikëve***, studim monografik (tezë e doktoratës në antropologji kulturore), ribot.: 2006, 2011, 2015.
9. 2001: ***Kështjella e virtytit***, studime, antropologji kulturore.
10. 2002: ***Arkiva të hapur në shoqëri të hapur***, përmbledhje studimesh.
11. 2004: ***Beratinus***, studim monografik, antropologji kulturore.
12. 2005: ***Një dosje për Kadarenë***, studim dhe dokumente.
13. 2005: ***Himara në shekuj***, botim i ASH, bashkautor (një kapitull).
14. 2005: ***Një dosje për Kadarenë II***, botim me plotësime në pjesën studimore dhe dokumentare, Tetovë.
15. 2006: ***Le Dossier Kadaré***, bot. *Éditions Odile Jacob*, Paris; ribot. eBook 2014.
16. 2006: ***Ura dhe kështjella***, studime, antropologji kulturore.
17. 2006: ***Një Shqipëri tjetër***, studime etnologjike dhe ndërdisiplinare.
18. 2007: ***Përveçime***, studime historike-letrare, Prishtinë.
19. 2007: ***Prurje kulturore orientale***, studime, antropologji kulturore, Tetovë.
20. 2009: ***Për prozën e Kadaresë***, studime letrare.
21. 2009: ***Hebrenjtë në Shqipëri - prania dhe shpëtimi***, studim monografik, antropologji kulturore.
22. 2010: ***Për letërsinë shqipe në shekullin e 20-të***, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, studime për letërsinë.
23. 2010: ***Midis dy Rilindjesh***, botim i Universitetit të Elbasanit, studime ndërdisiplinare, në fushën e antropologjisë.
24. 2010: ***Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"***, studim monografik, antropologji kulturore, bot. i Akademisë së Shkencave. Ribot. Naimi.
25. 2011: ***Etnos në epos***, studim monografik, antropologji kulturore.
26. 2011: ***Letërsia në totalitarizëm dhe "Dossier K."***, studim monografik dhe dokumente.
27. 2011: ***Camaj i paskajuar***, studim monografik, botim i QSA. Ribot. Naimi.
28. 2012: ***"Njerëzit e krisur" të Dritëro Agollit***, studim monografik.
29. 2012: ***Tradita gojore si etnotekst***, studim monografik, antropologji kulturore.
30. 2013: ***Pyetje në albanologji***, studime ndërdisiplinare.
31. 2013: ***Ndajfoljet përemërore në gjuhën shqipe***, monografi.
32. 2013: ***Hebrenjtë dhe shqiptarët: mbrojtja dhe shpëtimi***, monografi, antropologji kulturore.
33. 2014: ***Albanians and Jews: The Protection and Salvation***, monograph study, cultural anthropology.
34. 2014: ***Kodikët kronografikë të Shqipërisë***, monografi, antropologji kulturore.
35. 2015: ***Berat, Beratinus, Buhara***, studime, antropologji kulturore.
36. 2015: ***Historia e letërsisë shqipe: çështje të hapura***, studim në fushën e historisë së letërsisë.
37. 2016: ***Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë***, monografi, vështrim antropologjik.
38. 2017: **Pyetje të tjera në albanologji**; Vol. 2., studime ndërdisiplinare.
39. 2017: ***Hieronymi: në botën arbëreshe***, monografi, vështrim antropologjik, botim i Akademisë së Shkencave.
40. 2018: **Antropologji e identitetit** (Studime në antropologji kulturore - Pjesa e parë).
41. 2018: **Studime krahasimtare në letërsinë shqipe**, studime.
42. 2019: **Antropologji etno-juridike** (Studime në antropologji kulturore - Pjesa e dytë).
43. 2019: **Migjeni dhe *Shkrimet***, monografi.
44. 2019: **Vepra e D. Agollit dhe Brezi i viteve 1960,** monografi, botim i Akademisë së Shkencave.

Studiuesi i Kadaresë

Dr. Nerimane Kamberi, Prishtinë:

Shaban Sinani sjell në studimet letrare të sotme shqiptare një mënyrë "ndryshe", të veçantë, të të qasurit ndaj një vepre dhe autorit të saj: përmes gjuhës së dokumentit, në formë letrash dhe raportesh të ruajtur në arkiva shtetërore, si dëshmi e një kohe pa kohë, ku të ishe shkrimtar nuk ishte gjë e lehtë dhe ku të ishe Kadare kishte një peshë të rëndë: *letërsi dokumentuese*, siç e quan poeti Visar Zhiti. Ky cilësim, pra, përbën veçantinë e studimit të Sh. Sinanit për veprën e Kadaresë. Studiuesi e rivendos veprën dhe autorin në historinë e letërsisë shqipe, si dhe në historinë e Shqipërisë. Ai zhvillon këtë pyetje: çfarë janë raportet e letërsisë dhe diktaturës, raportet e shkrimtarit me pushtetin totalitar.

(Sipas: *Akte të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturë Shqiptare*; Prishtinë 2012, nr. 31, vëllimi II, f. 215-218)

"Një monument shkrimor për kombin shqiptar"

Dr. **Hysen Matoshi**, drejtor i Institutit Albanologjik, Prishtinë:

Libri i Shaban Sinanit shquhet kundruall sprovave tona të sotme historiografike për faktin se ofron të dhëna të shumta dokumentare lidhur me materien që e trajton, sikundër që, në këtë drejtim, nuk lë anash as kontributet e autorëve të tjerë. Dokumentet e shumta shoqërohen me konstatime të qëndrueshme, me sinteza që vënë në pah faktin e pamohueshëm se si një popull i përndjekur gjeti te shqiptarët dhe te strukturat e tyre shtetërore strehën e shpëtimit. Mund të thuhet me gojën plot se autori, me librin e tij, e ka ngritur një monument shkrimor për kombin shqiptar, gurët e të cilit janë dokumentet arkivore dhe të dhënat e përdorura nga burime të ndryshme. Monografia për hebrenjtë në Shqipëri hedh drite mbi të vërtetën e plotë, mbi një të vërtetë që, parë në kontekstin e zhvillimeve të kohës, është unike; e cila, përveçse është dokumentuar gjithanshëm, mund të thuhet se, në saje të elokuencës që i karakterizon përgjithësisht shkrimet e Shaban Sinanit, është interpretuar mjeshtërisht.

(botuar në gazetën "Shqip", 30 janar 2012)

cyan magenta yelloë black

vlerësime

Një kodik i kodikëve, por edhe i disa kodeve të Shqiptarisë

Prof. dr. ARDIAN KYÇYKU

Për fat, pikërisht në kohëra të tilla (të vështira) dalin në dritë, pavarësisht se sa të dukshme bëhen, vepra me rëndësi parësore për kulturën dhe dijen e një kombi. Një libër i tillë është ***"Kodikët kronografikë të Shqipërisë"*** (*Shkrime dhe dorëshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare*) i profesorit Shaban Sinani, shkencëtar i përkushtuar dhe i pajisur jo vetëm me vullnet të pazakontë, por edhe me një paanësi, të cilën do të duhej t'ia kishin zili, në mos po t'ia përvetësonin mjaft shkencëtarë *tanët*, fqinjë e më tej. Pas një përvoje shumëvjeçare në botën e hulumtimeve shkencore dhe pas mbi dhjetë vitesh punë me librin e mësipërm, kur shtrohet çështja e ecurisë dhe fatit të (dorë) shkrimeve me vlerë, autori e shpreh qartë mendimin e vet: "*Zhvillimet kulturore dhe mendore, edhe në periudhat më të rrepta, i tejkalojnë kufijtë gjeografikë, krahinorë, shtetërorë*".

Prof. dr. Shaban Sinani, përkundër vështirësive të panumërta, ka kryer një punë vigane, prej *scrib*-i, duke shmangur natyrshëm konceptin materialist të hulumtimit të historisë dhe të kulturës, me një stil të kthjellët, që nuk mund të keqkuptohet e as të lerë vend për mëdyshje. Ai ka punuar në heshtje dhe përkushtim, njëlloj sikur të mbante një Kodik të Kodikëve të Shqipërisë, ku gjenden të dhëna shpesh vegimtare për Kishën si ruajtëse të Kujtesës, për vendin që zënë letërsia, historia dhe tekstologjia në kulturën e një kombi, për mënyrën si duhen hartuar e zbatuar rregullat e qeverisjes së qyteteve, nenet e vllazërive të tipit esnafor, për historinë se si një komb, shpesh i mbajtur peng mes padijës dhe idealizmit, hyn në Shkrim falë gjuhës së vet - dhe në vëmendjen e botës falë shkrimit, për rolin e pazakontë të Mërgatës në mbrujtjen dhe mbrojtjen e letërsisë, për një riperiodizim të drejtë të kësaj të fundit pas kaq kohësh etj.

Lexuesi gjendet para një vepre shkencore shumëplanëshe e të shumëfishtë, që jo vetëm fton, por edhe çon më tej paqen e hershme të paktën ndërballkanike (mes popujsh, gjuhësh, shkencash), dhe mirëkuptimin. Si ca dijetarë të sprovuar me bojën dhe gjakun e kulturës, faktet nuk bërtasin asnjëherë.

Për fat, pikërisht në kohëra të tilla (të vështira) dalin në dritë, pavarësisht se sa të dukshme bëhen, vepra me rëndësi parësore për kulturën dhe dijen e një kombi. Një libër i tillë është "Kodikët kronografikë të Shqipërisë" (Shkrime dhe dorëshkrime prej Rilindjes Europiane deri në Rilindjen Kombëtare) i profesorit Shaban Sinani, shkencëtar i përkushtuar dhe i pajisur jo vetëm me vullnet të pazakontë, por edhe me një paanësi, të cilën do të duhej t'ia kishin zili, në mos po t'ia përvetësonin mjaft shkencëtarë tanët, fqinjë e më tej

Bukuresht, shtator 2014



"Ndër zërat më të njohur të luftës për Kosovën"

BEDRI ISLAMI, kryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), themeluese e UÇK

Personalitete të shquara të jetës intelektuale në Shqipëri kanë më tepër se sa hisen e tyre në luftën e Kosovës. Shaban Sinani është ndër zërat më të njohur të luftës për Kosovën. Për më tepër, është ndër të parët dhe më i fuqishmi. Analisti më i mirë që kishte Shqipëria, njeriu që refuzonte vendet e ofruara me kushtin që të hiqte dorë nga mbështetja e UÇK-së...

Profesor Shaban Sinani, e gjithë familja e tij, pa asnjë mëdyshje, që shumë vite para fillimit të luftës do të ishte njëri nga figurat prominente të paraqitjes së luftës, mbështetjes së saj dhe, tashmë duhet thënë, shtëpia e tij e vogël në katin e katërt do të ishte njëra nga bazat më të rëndësishme. Në të cilën, jo rrallë herë, jo vetëm zhvilloheshin takime të rëndësishme, por edhe strehoheshin mjete moderne të logjistikës luftarake. Banesa e tij ishte strehë për të gjithë ilegalët, që nga luftëtarët e orëve të para e deri tek pjesëtarët e afërt të familjes së Adem Jasharit. Dhe kjo është bërë duke sakrifikuar nga vetja, pa asnjë lloj shpërblimi si mund të mendohet padenjësisht sot.

Gazeta "Dita", 27 prill 2015 / Sipas: http://www.gazetadita.al/27-prill-2015/



Në foto: Akademik Shaban Sinani dhe shkrimtari Dritëro Agolli

"Sprovë shkencore e analizës dhe vlerësimit"

Prof. dr. Aleksandër Meksi :

Është një fakt tashmë i njohur dhe i pranuar nga të gjithë se në tërësinë e dëshmive të trashëgimisë kulturore dhe historike të shqiptarëve një vend me rëndësi zënë dhe kodikët e kultit të krishterë, të cilët, për nga numri, koha e shkrimit, vlerat dhe faktin e ruajtjes së tyre nga besimtarët mund të bëjnë çdo popull të krenohet. Pikërisht ky evidentim dhe vlerësim i gjithanshëm i kësaj pasurie është dhe përmbajtja e monografisë së Shaban Sinanit, e cila është sprovë shkencore e paraqitjes, analizës dhe vlerësimit të përbashkët të veprave të kësaj gjinie që janë ruajtur deri sot.

KOMENTE NË RRJETIN SOCIAL FACEBOOK, PAS ZGJEDHJES:

Helena Eni: Shaban Sinani - një jetë me dije! Një pasuri kaq e çmuar për albanologjinë! Nder për Akademinë e Shkencave që e ka pjesë të saj!

Gerta Bandilli: Urimet më të mira janë pak për punën tuaj të palodhur dhe sukseset tuaja. Mbetem një lexuese modeste që gjithmonë mëson nga ajo që ju përcillni përmes librave tuaj. Ju falenderoj!

Defrim Baku: Në këtë kohë që injoranca ka zaptuar çdo hapësirë, ju dhe librat e tu jeni një shpresë për të nesërmen.

Sashenka Kamberi: I palodhur profesor Shaban Sinani! I paarritshëm në punën e tij! Frymëzon respekt!

Fehmi Neziri: Shaban Sinani është arkiv që ecën...

Mira Luca: Fisniku Sinani është shumë larg atij që fugon e vetëm kritikon. Urime profesorit të nderuar!

Dervishi Jonada: Profesori është më i miri!

Bajram Peçi: Një historian e personalitet që i bën nder Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Urimet më të mira e mbarësi Shaban Sinani!

Mariglena Meminaj: Ka ca ca njerëz të rrallë që mbështeten vetëm në Vlera, Punë e Mirësi. Ka shume të tjerë që flasin vetëm për të kritikuar këdo që u del para, të paaftë të kthejnë në vepër fjalën.

Fatmir Sulejmani: Urimet më të përzemërta për Prof. Shabanin!

Ermira Ymeraj: Lajmi më i bukur dhe i merituar.

Kopi Kyçyku: Urime të përzemërta kolosit shtatvogël e mendjendritur, profesor Shaban Sinanit!

Natasha Lako: Urime akademikut në dyert e rezultateve të reja !

Zaim Elezi: Një shpërblesë për punën voluminoze e të shkëlqyer të Shaban Sinanit. Realisht këtë titull e ka pasur prej kohësh; ky është thjesht akti formal.

Holta Sina: Urimet më të mira për akademikun ekselent Shaban Sinani! Edhe mendja më diabolike hesht para një njeriu të shkëlqyer e profesionisti të jashtëzakonshëm si ai! Titullin akademik e ka merituar me kohë, ky i sotmi është thjesht formalitet! Është në nder të Akademisë së Shkencave që të ketë një njeri e personalitet të përmasave të tilla! Sikur çdo njeri të kishte kapacitetin intelektual e njerëzor të akademik Sh. Sinani, ky vend do ishte ndryshe!

Andrea Liko: Urime për punëmadhin e nderuar!



Në foto: Me Nënë Terezën, 1992.

Agron Tufa: Suksese prof. Shabanit! Zgjedhje ideale dhe merituar!

Albert Shala: Urime, Shaban! Si plot të tjerë, kam pas rastin të të çmoj që në hapat e parë në të përpjetat e jetës.

Mujo Buçpapaj: Shumë urime për prof. Shabanin! Një titull i merituar dhe i vonuar. Prof. Shaban Sinani është një personalitet i padiskutueshëm i studimeve tona letrare.

Albert Habazaj: Urimet më të mira për Profesorin! Akademik Shaban Sinani është Bleta punëtore e mendimit albanologjik, fatmirësisht pedagog në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ardian Doka: Lajm shumë i mirë! Mundi e puna u shpërblekan edhe ndër ne. Urime të përzemërta profesorit që e nderon Akademinë tonë.

Rruga e Arbërit nr. 165

histori

Sulejman Mustafa Shehu, i njohur si Sheh Sula i Zerqanit, lindi në fshatin Zerqan të rrethit Bulqizë Dibër, në vitin 1833.

Sheh Sula i Zerqanit, kleriku patriot,

pjesëmarrës në të gjitha lëvizjet kombëtare të kohës

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Me dëshirën dhe përkushtimin personal, për të hedhur sadopak dritë, mbi figurat klerikale e atdhetare, me bëma për fe e atdhe, të Teqes së Zerqanit, mora guximin të sjell për lexuesin, veprimtarinë fetare e atdhetare, të njërit prej pinjollëve të kësaj teqeje, Sheh Sulë Zerqanit. Një ndërmarrje kjo, jo e lehtë, për arsye se sado të shkruash, përsëri do ndjehesh i mangët në atë që do mund të thuash. Kjo për faktin se veprimtaria e pinjollëve të kësaj familjeje të madhe, në udhëheqje të malit të Grykës së Madhe (Zerqanit), të Dibrës, ka qenë dhe mbetet shumë më e gjërë, nga sa mund të shprehesh në kornizat e një shkrimi. Në realizimin e këtij shkrimi, jam mbështetur kryesisht nga kujtimet familiare, të lëna me shkrim kryesisht nga të ndjerët, e kësaj familje të madhe, Hajredin Shehu dhe Myslim Shehu, si dhe kujtimeve gojore të Xhemile Shehut, të mbledhura ndër vite me shumë kujdes nga nipi i Sheh Sulës, Fadil Shehu, në formën e një dorëshkrimi, Po kështu një tjetër mbështetje ka qenë edhe libri "Zëri i Brezave", me autor Fadil Shehu dhe Gafurr Zoto, si dhe dokumenta arkivore e muzeale, shkrime e libra të shumtë, të shkruara për këtë familje të madhe, të Teqesë së Zerqanit, nga autorë e historianë të shumtë. .Zgjodha kryesisht trashëgiminë gojore ndër breza, të kësaj familje, gjë për të cilën ka merita Fadil Shehu që e ka mbledhur dhe sistemuar në formën e një dorëshkrimi, të cilin unë vetëm e sistemova, për ta bërë shkrimin më të ndjerë e sensitiv për lexuesit, por pa përjashtuar edhe të dhënat dokumentare e historike të kohës, të cilat nuk mungojnë.. .

- Sulejman Mustafa Shehu, i njohur si Sheh Sula i Zerqanit, lindi në fshatin Zerqan të rrethit Bulqizë Dibër, në vitin 1833. Lindur në familjen e madhe dhe të njohur të shehelerëve të Zerqanit, fole e klerit mysliman (sektit kadri) e atdhetarizmit, në udheheqje të Grykës së Madhe (Zerqanit), një nga 9 Malet e Dibrës, bëri që ai të përfshihet, veç angahimeve klerikale edhe në të gjitha lëvizjet kombëtare të kohës, për liri e pavarësi të vendit..

NË DHË TË HUAJ, QË NË MOSHËN 10-11 VJEÇ.

- Ngjarjet e vitit 1844, ku i ati Sheh Mustafa i Zerqanit, udhëhoqi 9 Malet e Dibrës, në Luftën e Gjoricës, kundër Portës së Lartë, e gjetën Sulejman Shehun vetëm 10-11 vjeç. Internimi dhe dënimi me burg të përjetshëm në Turqi i të atit Mustafait dhe xhaxhait,Mehmetit, në këtë periudhë, krijuan një boshllëk të madh te djaloshi i ri. Në të njëjtën kohë, kjo rriti ndjeshëm edhe urrejtjen e tij, ndaj pushtuesve osmanllinj.. Vrasjet, djegiet, plaçkitjet, dhunimet dhe rrënimet e shkaktuara nga ekspedita e Hajredin Pashës, pas humbjeve të mëdha që pësoi ne betejën e Gjoricës, do ta shoqëronin gjatë atë, në kujtesën e tij. Pasojat e luftës padyshim që lanë gjurmë të pashlyeshme në të gjithë zonën e Grykës së Madhe. - Ja çfarë shkruan Myslim Shehu në memorien e familjes: : "...Mbasi ushtria sulltanike i thej kryengrtësit, dogji aso kohe gjithë katundet e Grykës së Madhe. Dëshmi e gjallë e kësaj janë edhe sot shtëpitë-gërmadha të katundeve të djegura".

Ndërkohë që i ati, Sheh Mustafa i Zerqanit, ishte i internuar dhe burgosur në Turqi (pas luftës së Gjoricës), rrisku i rënies së djaloshit, pre e raprezaljeve te turqëve, ishte i madh. Në të tilla kushte, pikërisht për ta shpëtuar atë nga këto raprezalje të ndjekjeve të turqëve, ,djaloshi i vogël me gjithë pjestarë të tjerë të familjes, lëvizin lart e poshtë, ndër miq e shokë, që ishin të shumtë, në gjithë zonën e Grykës së Madhe. Miq e të afërm, i sugjerojnë familjes, që ta nisnin Sulejmanin për në Turqi. Në shkrime të ndryshme, vendosja e tij në Turqi është quajtur si internimi i parë i tij. Vendosja në Turqi do ta largonte nga persekucioni që e ndiqte për shkak të së kaluarës të të parëve, që kishin dalë kundër reformave Tanzimatiste, si dhe organizuar e drejtuar Luftën e Gjoricës, ku Hajredin Pasha, la në fushën e betejës, të paktën 900 ushtarë, sic thotë edhe kënga. Familja e madhe e shehelerëve të Zerqanit edhe në Turqi, kishte shumë miq e shokë, të zënë ndër vite, nga pinjollët e kësaj familjeje, gjatë shkollimit të tyre atje.. Atje kishin studiuar e veshur Sheh Sulejmani i vjetër,gjyshi nga ana e babait,Hyseni. Ndërkohë në Turqi vazhdonin të ishin në burg me denime të përjetshëme, i ati,Mustafai dhe xhaxhai,Mehmeti, mjaft të njohur tashmë nga Perandoria Osmane, për disfatën që i shkaktuan Hajredin Pashës, në Fushën e Gjoricës , . Rrugën për në Turqi kohë më parë e kishin marrë edhe shumë nga Gryka e Mëdhe (Zerqani), të cilët atje kishin krijuar një farë ekonomie e gëzonin emër të mirë mes bashkëkombasve të tyre shqipëtarë.



- Me kujdesin e tyre të drejtpërdrejtë, djaloshi u regjistrua në shkollën fillore e më pas në medresenë "Hajdar Fatihu' të Stambollit.. Që në fillim binte në sy për zgjuarsi dhe intelekt të veçantë. Interes të madh për të, vec fesë, ngjallin edhe shkencat e tjera. .Rreth vitit 1860 kreu me rezultate të shkëlqyera studimet. Për rezultate të mira, i'u akordua dekorata e "Ylldash Qoshkut" dhe grada major,, tituj këto vetëm për studentë me rezultate të shkëlqyera. Pas mbarimit të studimeve u ofrua të bëjë shërbesa fetare në njërën nga teqet e qytetit. Këtu ruan lidhjet me bashkëkombasit e tij,por edhe me bashkëfshatarë të cilët vinin dendur në teqe. Falë cilësive të spikatura dhe kulturës së gjërë, si klerik musliman, ai shpejt u vesh Sheh. Në të njëjtën kohë, shërbesa në teqenë e Stambollit, mundësoi, që Sheh Sula tashmë, të bjerë në kontakt me tregëtarë,nëpunës e intelektualë të ardhur këtu nga vise të ndryshme të Shqipërisë. Kështu, ai bie në kontakt me rilindasin Hoxha Tahsimin e atdhetarë të tjerë, me të cilët bashkëpunon në dobi të atdheut. Interes përbën për të themelimi i Shoqërisë Kulturore të Shqiptarëve të Stambollit, e cila krahas të tjerave punonte për sigurimin e mjeteve për shtypjen e librave shqip. Në këto shoqëri merrnin pjesë intelektualë dhe njerëz të thjeshtë. Sheh Sulejmani, tashmemë rreth të tridhjetave, falë influencës si klerik musliman dhe kulturës së gjërë që zotëronte, jo vetëm që bëhet pjesë e këtyre takimeve, por edhe jep ndihmesë të pakursyer në punën e saj. Ata më së shumti shërbyen për formimin atdhetar e kulturor të tij. .

KTHIMI NË VENDLINDJE ZERQAN.

Në fillim të vitev 18 70-të, vendosi të kthehet në vendlindje,Zerqan,

Kthimi i tij u prit me shumë dashuri jo vetëm nga banorët e Zerqanit, por gjithë Grykës së Madhe dhe më gjërë. U gëzuan pasi u erdhi kleriku patriot, prijësi i tyre. Tteqeja e Zerqanit me ardhjen e pinjollit të saj, të veshur Sheh, i sektit kadri, u rigjallërua. Banesa, por edhe tyrbja, të dëmtuara që në kohë të rezistencës ndaj Hajredin Pashës, duheshin rindërtuar. E ngriti atë edhe një kat. E rrethoi me mure të lartë dhe brenda avllisë ringriti tyrben

Dijet e thella klerikale muslimane dhe ata në fusha të tjera, të mbrujtura nga urtësia, fjala e matur me tolerancë, e mbi të gjitha me patriotizëm, gjatë ceremonive fetare, me besimtarët, e lartësuan shumë atë., Ashtu si dikur në kohën kur në krye të Teqesë së Zerqanit, ishte Sheh Mustafa, edhe tani me ardhjen e djalit të tij, Sheh Sula, fjala e tij, zinte vend dhe kishte shumë peshë tek banorët e zonës, por jo vetëm. Sjellim në vëmendje se klerikët e Teqes së Zerqanit, të paktën që nga Sheh Mustafa, janë shfaqur në komunikim e korrespondenca me letra , me krerët e Kosovës dhe Shqipërisë së Mesme. Aktiviteti fetar dhe patriotik i Sheh Sulës në krye të Teqesë së Zerqanit, ka lënë gjurmë të thella , duke e bërë atë jo vetëm prijës të Grykës së Madhe (Zerqanit), por fjala e tij kishte peshë të madhe, në të gjithë malësinë e Dibrës..

Veprimtaria fetare dhe patriotike e klerikëve të Teqesë së Zerqait, e plazmuar dhe zhvilluar në vijimësi nga pinjollët e saj, i lidhte ata pazgjidhshmërisht me shtresat e gjëra të popullsisë,por edhe me krerë e prijesa të tjerë të Grykës së Madhe ,Bulqizës e më gjërë.. Në këtë kuadër, Sheh Sula, i rivitalizoi këto lidhje, ndër të cilat një vend të veçantë zinte Sheh Aliu, Sheh Fejz Bulqiza, Fazli Malja, etj. ..

I shkolluar dhe me kulturë të gjërë, Sheh Sula, dallohet edhe si një politikan i mirfilltë, i ccili e kuptonte se me rënien e Perandorisë Osmane, që ishte në prag, Shqipëria kërcënohej seriozisht prej coptimit të saj, nga shtetet fqinje. Kjo bëri që ai ta kthente Teqenë e Zerqanit, jo vetëm si një vatër të predikimeve të relegjionit musliman, por edhe si një vatër të edukimit patriotik për mbrojtjen e Atdheut. Duke punuar kështu me moton; -"për fe dhe atdhe". Në këtë periudhë puna e palodhur e Sheh Sulës, e forcoi edhe ekonomikisht Teqenë e Zerqanit. Për cdo ditë Teqeja kishte hyrje-dalje të shumta, nga banorë të zonës, por edhe nga miq e të ardhur nga vise të tjera. Emri i Sheh Sulës, tashmë njihej edhe përtej Grykës së Madhe, zonave përreth e Dibrës, duke shtuar kështu, shokë e miq të tij, në të gjithë vendin.

Kjo bëri që Sheh Sula të ndërhyjë në rikonstruksionin e banesës, duke e ngritur atë edhe një kat më lart, duke shtuar kështu ambiente të reja për banim,, shërbim.për besimtarët dhe pritje-përcjellje të të ardhurve të shumtë. Në katin e dytë u kompozua një dhomë me dimensione 5x7 m. Në krye të saj,përballë derës kryesore, u ndërtua një pjesë e ngritur me dimensione 2X2.5 m dhe lartësi 20cm nga dyshemeja. Në këtë dhomë apo siç quhej ndryshe,selamllëku, rrinte e priste miq të rëndësishëm Sheh Sula. dhe të tjerë pinjollë të familjes. Ndërkohë u ndërtua edhe avllia me mure të larta, brënda së cilës u ngrit edhe "Tyrbja" duke i dhënë kështu ndërtesës, pamjen e një kompleksi ndërtimor, me cilësi të vecanta.

Kujtojmë se nisur nga vlerat ndërtimore e historike banesa komplekse e Teqesë së Zerqanit, është shpallur "Monument Kulture" në vitin 1977 dhe iu nënshtrua një ndërhyrje restauruese nga Instituti Monumenteve të Kulturës, dega Dibër. Aktualisht ndërtesa ka nevojë për rindërhyrje, në përpjekje për ruajtjen e vlerave të saj, të vecanta, historike e ndërtimore...

Konaqet e Teqesë së Zerqanit, me zgjerimin e tyre, krijuan mundësi, për më shumë pritje e përcjellje, ku porta e saj qendronte non-stop 24 ore. Dyndeshin për cdo ditë, besimtarë të shumtë, jo vetëm nga zona, por edhe zona për rreth e më gjërë, në plotësim të riteve fetare, si dhe zgjidhjes së konflikteve të mundshme që ata kishin mes tyre. Autoriteti i Sheh Sulës, rritej vazhdimisht. Fjala e tij në një farë kuptimi, në mungesë të ekzistencës së autoritetit shtetëror, ishte dhe mbetej, vendimi dhe zbatimi i saj nga ana e banorëve. Kjo bëri që në të gjithë Grykën e Madhe (Zerqanin), të mos kishte asnjë lloj hasmërie, konflikti e hamarrje mes banorëve e fiseve Sheh Sula me vizitorët e ardhur në Teqe, bisedonte e predikonte, jo vetëm për fenë, por edhe për konfliktet mes banorëve e zgjidhjen e tyre, si dhe për atdhedashurinë e fatet e të ardhmes së tij, pas tërheqjes së Portës së Lartë nga Ballkani, gjë që ishte në prag. Duke e kthyer kështu Teqenë e Zerqanit, jo vetëm në një çerdhe të relegjionit mysliman, por edhe të atdhetarizmit.

Në katin e dytë të banesës ishte një dhomë me dimensione 5x6m. Afër oxhakut,përballë derës, si i themi ne, në krye të vendit, ishte një pjesë e ngritur në formë drejtkëndëshi,2 m e gjërë ,2.5m e gjatë dhe lartësi 0.25m. Ajo ishte mbuluar me sixhade e lëkurë deleje dhe rrethonte oxhakun. Në të dyja anët e oxhakut kishte pjesë në formë dritaresh,të mbyllura. Këtu mbaheshin takëmet e Shehut.si: cigarishten e gjatë prej fildishi, kutinë e duhanit, veglat për ndezjen e cigares si dhe sende të tjera personale. Pranë mbante libra fetarë mbi të cilët kalonte një pjesë të madhe të kohës.

Në këtë dhomë ose siç quhej ndryshe selamllëku i Sheh Sulës, kalonte mes librave , miqve e bashkëfshatrëve kohën më të madhe. Aty hynin e dilnin miq e shokë të rëndësishëm të familjes nga qyteti i Dibrës së Madhe, Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Martaneshi, Mati e gjetkë. Mes tyre kish miq e shokë të të atit, Mustafait, por dhe njerëz të thjeshtë që vinin për sherbesa fetare e zgjidhje konfliktesh gjithfarësh.

Sheh Sula gjatë bisedave e predikimeve fetare, përcillte tek të ardhurit e shumtë mesazhin e vllazërimit,,paqtimit e të atdhedashurisë. Temë e shpeshtë me të pranishmit, ishte edhe ajo e marëdhënieve mes fesë e kombit. Shpjegimi fetar dhe filozofik që u bënte dukurive të tilla, ngjallnin kureshtjen e dëgjuesve. Gjatë bashkëbisedimeve, përcillte për ta, dallimin esencial mes principit të fesë mbi vllazërimin e kombeve dhe politikës antikombëtare që ndjekin pushtuesit osman. Tema të tilla që Sheh Sula i përcillte me një gjuhë të pastër e kulturë të lartë, i bënin për vete të pranishmit. pjesmarrës të shumtë në këto dëgjesa.

Falë shkollimit e formimit të tij intelektual, ai e kuptonte se Atdheu, me largimin e Turqisë, do binte pre e lakmive të shteteve fqinj, që do turreshin per coptimin e tij, në copa për vete. Kështu Sheh Sula, u njoh edhe si një figurë e rëndësishme patriotike me shumë influencë, jo vetëm në Grykë të Madhe (Zerqan), por edhe në Dibër e gjithë malësitë e saj. Veprimtaria e tij patriotike, krahas asaj klerikale, erdhi gjithnjë e në rritje, sidomos pas vitit 1975, kur sundimi i Perandorisë Osmane, sa vinte e dobësohej. Këtë situatë Sheh Sula e kuptonte mjaft mirë dhe vendosi që ta shfrytëojë atë, për rritjen e ndjenjave patriotike, tek banorët e zonës, por jo vetëm. Në cdo bisedë të tij, me besimtarët, miqt e të ardhurit, ai kurrë nuk harronte të fliste, për çështjen kombëtare shqiptare. Kjo veprimtari e tij, nuk kishte si të mos binte në sy të rretheve të patriotëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të kohës, me të cilët mbante korrespondencë të rregullt, ndër ta edhe me rilindasin e madh, Abdyl Frashërin. Viti 1878, ishte viti i ngjarjeve dhe zhvillimeve të mëdha politike,. Ishte koha kur Marrveshja e Shën Stefanit, mes Rusisë dhe Turqisë, pas firmosjes së saj, nuk i njohu Shqipërisë, asnjë të drejtë territoriale. .Kjo krijoi kushtet që Kongresi i Berlinit që pritej të zhvillohej, pas Marrveshjes së Shën Stefanit, nga Fuqitë e Mëdha, me shumë mundësi, ashtu sic edhe ndodhi, do t'i hiqte hartës shqiptare krahina të shumta, ndër të cilat edhe Dibra. Në këtë situatë, atdhetarët shqiptarë ideuan të mbajnë mbledhjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. ku do të shpallnin ndarjen përfundimtare nga sundimi osman, si dhe mbrojtjen e tërësisë territorial të shqiptarëve..

Lidhja e Prizrenit ishte lëvizja e parë shqiptare e madhe e organizuar në mënyrë administrative, politike dhe ushtarake që prej kohës së Skënderbeut. Të detyruar nga rrethanat specifike të vitit 1878, shqiptarët thirrën një Kuvend Mbarëkombëtar në Prizren, i cili synonte bashkimin e Shqipërisë dhe shkëputjen nga sundimi osman.

Sheh Sula i Zerqanit, pjesmarrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe organizimin e Kuvendit të Dibrës.

vijon



Xhafer Martini: "Të faleminderit Kadare, që këtë jetën tonë të varfër dhe të mjerë e bën disi më të bukur me veprën tënde të jashtëzakonshme"

"Kushëriri i ëngjëjve"

Nga **XHAFER MARTINI**



(vijon nga numri i kaluar)

Zhvilloheshin plot sfilata dhe gara të bukura, por këtu nuk është vendi të zgjatem. Ne nuk e përfytyronim kostumin pa njeriun. Kadare e shikon kostumin me njeriun, madje me fatin e tij historik. Prandaj kostunmi i Kadares është dhënë në lëvizje, në jetë, mes stuhive dhe bubullimave, me një kalim përherë përmes rrezikut siç ka kaluar përherë shqiptari dhe çdo gjë e tij. Kadareja mbledh të gjitha mjetet artistike: asociacione, përfytyrime, paralelizma, krahasime, metafora, epitete, dhe, si të ishin një batalion kompakt, i hedh në sulm që ta merrnin në të parën, në befasi, me shpejtësi vetëtime, "Kalanë e bukurisë", ndryshe do të mbeteshin nën muret e saj. "Një e bardhë alpine, e ndërprerë befasisht nga shpërthimi tronditës i të kuqes. Do ta besoje se kishin shpërthyer ca lule të kuqe, ose gjaku kishte vërshuar pas goditjes së sëpatës. Mbi tirqet e bardha të burrave ishte një zigzage e zezë që të kujton shenjën rrezik vdekjeje pranë kabinave elektrike. Tek krahët e xhokes kishte ca flatra të prera, thua se njeriu ishte përherë gati për t'u nisur drejt qiellit. Në gjithçka ndihej rreziku, fataliteti dhe përkohshmëria" (Kadare: Vepra: 2009: 25) Pra, kemi drita dhe ngjyra, gjakun që supozon luftën dhe shenjën e vdekjes që e ka paralajmëruar atë gjëmë; dita është me shi, madje me shtrëngatë, me bubullima dhe vetëtima, dhe nisja drejt qiellit jo se është diçka e pamundur, por edhe plot me rreziqe, siç është rreziku i moskthimit, domethënë i vdekjes. Të bëhen bashkë kaq gjëra krejt të largëta dhe të huaja për njera-tjetrën vetëm një mendje si e Kadaresë dhe një penë si e tij e bën të mundur. Por ai në një kuptim edhe është i detyruar të veprojë kështu, me alarm dhe të sulmojë "me ç't'i vijë përdore, sepse betejat nuk presin. Më kujtohet ajo vjersha magjepsëse e Kadaresë tek "Motive me diell", kur piktori po pikturon perëndimin e diellit, muzgu bie me shpejtësi, dritat dhe ngjyrat ndryshojnë , prandaj piktori duhet të nxitojë. "Kap ç'të kapësh", thotë poeti. Kadareja i ruan dhe i rimerr motivet për t'i përdorur për herë të tjera. Edhe këtu, meqë njeriun e kostumin e tij, i shikon në fluturim, në luftë, përmes stuhive dhe gjakut që çel lule të kuqe, duhet të nxitojë. Nuk ka rrugë tjerë. Nuk ka kohë për t'u engledisur me një mëngë këmishe, ose me një shami koke. E jep gjithçka shjpejt, nën dritën e shpërthimit të rrufesë.

Kostumi i burrave është i pandarë nga burrat që e vishnin atë kostum. Nëse në kostum ka shenja rrezik vdekjeje , ka flatra të prera, ka fatalitet, rrezikshmëri dhe përkohshmëri, kjo ndodh sepse burrat gjithnjë kanë qenë të rrezikuar. Edhe nusja ka qenë përherë e rrezikuar. Kadareja nuk ka thënë kot : "Krushqit janë të ngrirë". Kjo është një metaforë, përdorur për tjetër qëllim tek eseja e tij, por krushqit vërtetë kanë qenë të rrezikuar. Përderisa merrnin një nuse, një vajzë, zakonisht nga larg, ata quheshin hajna, rrëmbyes, dhe nuk ishte aspak çudi ta kishin pritën përpara për të vrarë krushqit dhe për t'u rrëmbyer nusen.

Gruaja, femra, ka qenë e rrezikur vetëm ditën e martesës, kur po shkonte tek burri, shoqëruar nga krushit. Por edhe atë ditë ajo mund të rrezikohej kur të vriteshin të gjithë krushqit. Ditët tjera ajo ishte e sigurtë, e qetë, e mbrojtur nga Kanuni, ndryshe nga ç'prrallisn disa mendjelehtë që nuk njohin as kanunin, as traditën. Femra përgjithësisht simbolizon qetësinë, paqen, lumturinë, harmoninë. Femra në Kanun ka vendin kryesor si pajtuese, si ndërmjetëse. Sikur të ishin vrarë dhjetar burra nga të dyja palët- nuk ka rëndësia për çfarë, si e kur- po të hynte gruaja në mes, pushka pushonte në çast. Kadareja i di këto, në mos i diftë i merr me mend. Prandaj kur përshkruan kostumin e gruas ka kohën e mjaftueshme për të vërejtur edhe imtësitë. Përleshja ka mbaruar dhe tani sikur ka ardhur koha të ulemi, të prehemi pak, të lëmë luftën dhe të merremi me bukurinë. Është çasti për të admiruar, por admirimi nuk mund të bëhet vetëm në qetësi. Madje është vetë femra, kostumi i saj që ta imponojnë këtë qetësi dhe këtë dëshirë për të adhuruar. Ja si shkruan Kadareja për kostumin e grave: "Kurse tek gratë, si përherë, çdo gjë ishte më qetësuese. Por ajo që e befasonte fort Angjelinin në veshjen e grave, ishte fustanin që ato mbanin, xhubleta. Ajo ishte në trajtë këmbane të valëzuar dhe, gjatë ecjes, gjithmonë lëkundej. Ajo ishte si një valle e përhershme e varur poshtë mesit të gruas". (Kadare: Vepra : 2009: 252)

Kadare ka forcë të jashtëzakonshme përfytyruese. Por fjala përfytyrim tek Kadareja nuk ka kuptimin e zakonshëm. Ne, sipas kuptimit të zakonshëm, përfytyrojmë, ose marrim me mend diçka që nuk e kemi parë, madje që e kemi shumë larg. Ne kemi dëgjuar, fjala vjen, për kopshtet e varuara të Persisë, por nuk i kemi parë. Ne ato vetëm i përfytyrojmë. Ne kemi dëgjuar për oazet në shkretërira, por i kemi parë vetëm në filma. Kurse Kadare e ka objektin përpara, megjithatë e largon për t'i dhënë forcë përfytyrimit që është përherë më i pasur se çdo realitet. Largsia të shkakton mall, dëshirë, madje të tjetrëson edhe pamjen e asaj që e ke njohur mirë, por tani e "shikon ndryshe". Kam bërë dikur një përshkrim për Lurën, kur ende nuk e kisha parë atë. Kur e pashë, sikur u zhgënjeva, sepse forca përfytyruese është gjithnjë më e madhe se sa realiteti që të shikon syri. "Mund të dallojmë dy tipa procesesh që kanë të bëjnë me përfytyrimin: ai që niset nga fjala dhe arrin tek imazhi viziv dhe ai që niset nga imazhi viziv dhe arrin tek shprehja verbale". (Italo Kalvino: Leksione amerikane: 2011: 117) Të dy këto tipe Kadare I përdor me shumë sukes. Kadareja në kalimet e tij të mrekulklueshme të kujton filamat artsitikë: Nga fjaja është kaluar tek imazhi që ka ardhur si rezultat I përfytyrimit të regjisorit. Sa më I fuqishëm të jetë tekstit letar, aq më dritdhënës do të jetë edhe imazhi viziv. Dhe e kundërta, sa më I plotë dhe emocionues të jetë imazhi viziv, skena e filmit, aq më shumë do të zgjoje tek ne përfytyrime për të shkuar tek teksti I shkruar. Natyrshëm Kadareja kalon tek dasma. Ka rastin për të krahasuar dasmën shqiptare me dasmën franceze se këtë e kërkon prania e Angjelinit. Dasma shqiptare është krejt ndryshe nga dasma franceze. Ndryshimi qëndron tek elementi i sigurisë. Tek dasma shqiptare edhe në mes të gëzimit e të këngëve, të hovit shpirtëror të valleve rreziku është i pranishëm, është në formë ankthi, në fromë pasigurie, përkohshmërie, për të mos thënë në formën e kobit. I zoti i dasmës i merrte leje hasmit për tri ditët e dasmës, pastaj mbyllej, si përherë. Pra, edhe nëse do të kishte lumturi, ajo do dë ishte e përkohshme, e shkurtër. Dhëndëri mund të vritej pas tri ditësh. Po të vritej dhëndëri, siç ka ndodhur shpesh, nusja do të martohej në tjetër derë. Kadareja nuk hyn në këto hollësi se as që i duheshin, por ai thotë hapur dhe qartë se dasma "mund të bëhej për shumë arsye, por lumturia e çiftit ishte e fundit që merrej parasysh". Vërtet kështu ishte. Nuk kishte kohë për të qenë i lumtur. Kënga e Rexhës që njihet në gjithë Shqipërinë dhe përtej saj, edhe motivin edhe heroin i ka sa për të thënë, se Rexha, në fund të fundit, nuk pati ndonjë vdekje të hijshme, vdiq në grazhd të kalit, e vrau kali. Por forca e kësaj kënge nuk qëndron tek motivi, por tek ai shndërrim i befasishëm i lumturisë në fatkeqësi. Kjo është ajo forcë e madhe që e bën atë të paharruehsme dhe Rexhën sikur të ishte një hero i madh. Tragjikja përherë është e bukur, ka shumë forcë, të trondit. Njeriu vazhdimisht ka nevojë për tronditje. Tronditja të nxjerr nga banaliteti, nga ditëpërditshmëria.. por ka tronditje që të shkatërrojnë fare. Ka tërmet që ta dridh dhe ta lëkund ngrehinën, por ka prej atyre që ta lëshojnë në kokë. Forca shndërruese, - treguesi i paqëndrushmërisë së lumturrisë- është motiv heroik në vetvete. Kadareja thotë: "Gati gjysma e dasmave shqiptare kishin brenda një të papritur dramatike. Njerëzit e dinin këtë, ndaj ngazëllimi i tyre s'ishte kurrë banal. Këtyre dasmorëve, po t'u thoshe se mbi dasmën përgjojnë hyjnitë, ata që janë dashanmirës e ata që janë dashakeqas, kjo do t'u dukej atyre gjëja më normale". (Kadare: Vepra: 2009: 253)

Kurse dasma franceze ishte tjetër gjë, ajo ishte e sigurtë, atje lumturia nuk ishte e cënuar, të paktën nuk ishte e rrezikuar shpejt si tek dasmat shqiptare.Kur nuk ka lumturi as në dasmë, kur edhe aty gëzimi është i trazuar nga frika e përmbysjes, do të thotë që je popull i nëmur, sipas shprehejes së popullit, ose popull tragjik, sipas mendësisë së Angjelinit. "Ai i përkiste një populli me fat dyfish tragjik. Një populli të vonuar në histori. Një popull i ndarë më dysh, që lëngonte nën dy diktatura, njera më e keqe se tjetra". (Kadare: Vepra: 2009: 254)

Fati dyfish tragjik ishte edhe në simbolet e kombit shqiptar. "Sa herë në simbolet dhe shenjat e vendit të tij ai ndeshte dyfishimin, shqiponjën me dy kokë në flamur, dy brirët e dhisë në përkrenaren e Skënderbeut, vetë heroin sublim të kombit me dy emra, një të krishter dhe një myliman, Gjergj Kastriotin, kontin katolik të shndërruar në Skënderbe oriental, për t'u kthyer prapë më pas në katolik perëndimor, Angjelimit i vinte ndërmend dytragjedia e kombit të vet". (Kadare: Vepra: 2009: 254) .

* * *

Kadareja është i veçantë në gjithçka. Të gjithë, si shembull, e kritikojmë diktaturën, kritikojmë edhe mënyrën dhe mjetet se si ajo ndikoi mbi letërsinë dhe artin që ato t'i shërbenin asaj. Që t'i shërbeje diktaturës do të thoshte se nuk kishim letërsi e arte, ose kishim letërsi dhe arte të shëmtuara. Por këtë kritikë shumëkush e bën në mënyrë naive dhe banale. Nëse mbledhim fjalimet, shkrimet, madje edhe librat që janë shkruar dhe vazhdojnë të shkruhen sot kundër diktaturës komuniste, më të egërs dhe më të paftyrës në botë, pra, të një diktature të veçantë, që të jep dorë për të thënë diçka të re, për çudi gjithë ky mal me letër është disi vulgar, banal dhe pa ide. Kjo vjen ngaqë thuhen të njejtat fjalë, më shumë shahet se sa argumentohet, ngase mungojnë kënde të ndryshme shikimi, mungon filozofia për të vënë në lëvizje ato mekanizma që përdorte diktaura për të realizuar qëllimet e saj. Unë kam jetuar shumë kohë në bazë, siç thuhej atëherë, më pranë popullit, siç mund të thuhet realisht. Atëherë bëja çudi pse diktatura vinte në krye të punëve njerëzit më injorantë, ata më pak të shkolluar, ata që ishin shumë nën mesataren njerëzore, për të mos thënë bërllokun. Tani e kuptoj se ata ishin njerëzit më të përshtashëm për diktaturën sepse ata nuk kishin sesnin e punëve dhe nuk kishin mëshirë. Ata i besonin diktaturës dhe vetëm atë njihnin për Zot. Po Intelektualët? Pjesa më e madhe konformohej, të tjerët shtypeshin nga të konformuarit. Kadare e ka bërë kritikën e diktaturës jo në një libër të vetëm, por më të gjithë librat që ka shkruar mbas shembjes së saj. Po ajo më kryesorja është se ai e ka bërë një gjë të tillë, edhe kur diktatura ishte gjallë. Unë nuk jam për ekzagjerime, si ato që thonë se të gjithë librat e Kadaresë vrisnin kështu e vrisnin ashtu, me një fjalë, ta fusnin ujin nën hasër, por kam bindjen që disa prej tyre vërtet të tillë ishin. Ai të gjithëve na ka paralajmëruar në çfarë rendi dhe sistemi jetonim, por kumtet rrallë herë kuptohen. Megjithatë, librat nuk e shembin diktaturën. Ata kanë efekt paralajmërues.

Po le të kthehemi tek libri që kemi në duar. Kadare e di mirë se ç'plagë ka marrë arti shqiptar. Në letërsi doli heroi i neveritshëm pozitiv, një mostër sipas modeleve të letërsisë sovjetike dhe të jetës kineze. Letërsia u godit e para se ajo ishte edhe më e kontrollueshme.Redaktorët, shefat, dhe gjithëfarë njerëzish nën ta dhe përmbi ta kishin mprehur shpatat dhe bënin kërdinë mbi letërsinë. Kadare ka shkruar një vjershë "Romanvrasësi", nuk di me cilin redaktor apo shef e kishte, por ata për vijën e partisë ishin të gjithë njëlloj. Në një ekspozitë pikture të piktorëve shqiptarë në Paris, Kadare thotë se kritikët, por edhe njerëzit e thjeshtë u tallën me përçudnimin e artit shqiptar, mbasi më shumë se me pikturë kishte të bëje "me një koleksion modelesh mustaqesh burrërore, tendosje muskujsh e shikime optimiste të heronjve drejt të ardhmes. Muzika përpiqej të mbahej disi, ngaqë nuk qe e detyruar të përdorte fjalën ose imazhin e drejtpërdejtë, por edhe ajo po mbushej me marshe histerike dhe me një surrogato kinse muzikë e lehtë, që më shumë i afrohej oratorios dhe kantatës." (Kadare: Vepra: 2009: 257) Degradoi edhe koreografia sepse "në shfaqeje vinin udhëheqësit me gratë, e, sidomos me shijen e tyre vulgare. Të kapërdisur nëpër lozha e veçanta, këta injorantë të pashoq, pasi kishin shkatërruar ekonominë e vendit, pasi kishin mbushur burgjet me viktima dhe pasi kishin prishur atje ku kishin mundur jetën njerëzore, vinin të thanin edhe atë gëzim të paktë që mund të jepte vallëzimi njerëzor...skenat nisën të mbusheshin me personazhe me kasketa punëtorësh dhe me rroba ushtarake , me femra që bënin gjeste burrash, me një histeri të pafund lëvizjesh, që jepte gjoja dinamizmin dhe optimizmin e jetës socialiste.". (Kadare: Vepra: 2009: 260) Ky është një përshkrim i saktë që i bën Kadareja artit që u zhvillua nën diktaturë. Po ne nuk kemi dalë ende tek e veçanta e Kadaresë. Kritikën e mësipërme mund ta bënte çdo shkrimtar tjetër. Nga kjo del që edhe Kadareja, në krijimtari vende – vende është "si të gjithë të tjerët". Proza e tij bëhet me të vërtetë elitare, brilante me gjetjet e mrekullueshme që bën ky autor, me zbritjen e tij deri në ato thellësi ku të nuk mund ta përfytyrojnë, pale më të nisen dhe të shkojnë. Vetvetiu lind pyetja: përse regjimi diktatorial nuk e donte vallen, vallen natyrore, desha të them, jo atë të denatyrizuar? Nuk e donin se vallja ka ritmin dhe harmoninë. "Regjimet e egra nuk e donin vallen, - thotë Kadare, - pikërisht për këtë. Ata qenë përpjekur t'i mbushnin mendjen vetes dhe të tjerëve, se jeta njerëzore nuk rregullohej prej kurrëfarë harmonie të epërme, por prej ligjeve të shpikura prej tyre ose prej diktaturave të tyre të egra. Për to, jeta njerëzore nuk mund të përftohej veçse e gjymtuar prej luftës së klasave, prej urrejtjes, egërisë dhe ndërprerjeve tragjike. Por ata nuk e donin vallen sidomos për zbutjen dhe fisnikërinë që ajo e kishte të vetvetishme. Valle do të thoshte përkitje e kujdesshme e tjetrit, afrim dhe largim harmonioz, rikthim i përhershëm tek njeriu. Ajo ishte një qortim i përhershëm i brutalitetit. Krahun edhe shkelmin që godiste, ajo e moliste, e çarmatoste. Ajo të ftonte për marrëveshje dhe për lutje. Lutja është e mirë për gjunjët, pra, edhe për vallen, kishte thënë Merce Cunnigham. Por pikërisht lutjes dhe providencës diktatorët i trembeshin më shumë se gjithshkaje" (Kadre: Vepra: 2009: 260) Ja,për këto perla mendimi adhurohet Kadare. Tek këto perla ajo që të rri në mendje dhe nuk të shqitet nga truri është sidomos fjalia: "Ajo (vallja) ishte një qortim i përhershëm i brutalitetit", ose perla të tjera si: vallja është dehëse gati si pija dhe në të dyja "ndiesia e ikjes nga realiteti është tepër e fortë". Imagjinata e Kadaresë është kaq e fuqishme sa përkufizimi i tij për vallen tani nuk është tokësor por kap galaktikat, se këto dëshmojnë që gjithë universi është një valle e madhe. "Mendimi i parë që të vjen është rrotullimi i rruzullit tokësor rreth vetvetes, pra, një lloj vallëzimi i tij. Ky rrotullim nuk mund të ndërpritet. Siç thonë, bën pjesë në një valle më të madhe, në atë të galaktikës dhe galaktika vetë nuk është veçse pjesëmarrëse në një tjetër vallëzim: në atë të universit. Duam apo nuk duam, ne jemi të rrethur prej vallzimit". (Kadare: Vepra: 2009: 261) Ja, këto perla e çmendin lexuesit, e bëjnë atë "rob" të Kadaresë, se ai e ushqen njeriun me të papriturën e freskët, duke e larguar nga vulgariteti i përditshëm i thënieve të njëllojtja, i përsëritjeve tepër të mërzitshme ku nuk ka gjë tjetër veçse një shkretërirë mendimi. Po merre me mend se sa gëzohet syri, shpirti dhe zemra e njeriut, kur në mes të kësaj shkretërire gjen një oaz me ujë, me hije dhe gjelbërim. Ja, kështu oazesh ka pa fund në veprat e Kadaresë.


Mbasi vallen e ka parë tek galaktikat dhe të universi, Kadareja me atë imagjinatën e tij pa fre e pa fund, e zret atë në tokë, atje ku vallja, në të vërtet nis dhe mbaron: "Ti je i detyruar gjatë kërcimit të kthehesh dhe të rikthehesh tek toka, sepse tij je njeri. Afati që ajo të të jep është i shkrutër, ndaj edhe vallëzimi s'është veçse bashkimi i mijëra afateve të tilla, në secilën prej të cilave toka, njëlloj si zyrat e kontrollit të vizave nëpër aeroporte, vë vulën e saj". (Kadare: Vepra: 2009: 26) Nuk të vjen të thuash gjë tjetër veçse: "Të faleminderit Kadare, që këtë jetën tonë të varfër dhe të mjerë e bën disi më të bukur me veprën tënde të jashtëzakonshme".

Fund

Shkëputur nga libri i prof. asoc. dr. Vesel Hoxha "SHËNIME NË ÇADËR",

Mysafir i ri në çadër

Nga **VESEL HOXHA**



Botimet M&B, Tiranë 2020
ISBN: 978-9928-307-19-4

Dibra në çdo kohë ka nxjerrë specialistë në fushën e gjeologjisë me kontribute të vlerësuara kombëtare, veçanërisht nga ish punonjësit e ish Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë. Këtu solla mes kujtimeve Alban (Ahmet) Çollakun me origjinë nga Sllatina e Sllovës në rrëzën e Malit të Bardhë evaporitik, në rrëzën e këtij gjeomonumenti natyror me vlera të jashtëzakonshme rajonale e europiane, me dukuri të rralla erozionale, karstike, mineralogjike, strukturore dhe sidomos tektonike, për të cilat nuk ka harruar të shkruajë profesor Albani në revista shkencore autoritare të njohura të Francës dhe Europës, për të saktësuar "rrënjët gjeologjike të vendlindjes", autoktoninë apo alloktoninë e tyre.

Me 6 qershor të vitit 1980 erdhi në ekspeditë apo ekip një mysafir i ri, stazhieri Alban (Ahmet) Çollaku. Ishte student në vit të dytë të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave në Tiranë. Me banim ishte nga fshati Sllatinë i Sllovës së Dibrës. Fshati i tij ka një histori të madhe, për të cilën poeti i këngëve patriotike dhe shumë gjinive të tjera letrare, i pavdekshmi Naim Plaku, ka shkruar një libër për të, ndaj këtu nuk kam çfarë të shtoj. Dua vetëm të tregoj një histori të vogël rreth origjinës së emrit Sllatinë. Variante të shumta janë dhënë për përkthimin në shqip të këtij emri. Një mik nga Bullgaria, që kam pasur fatin ta shoqëroj nga fshati Sllatinë në Malin e Korabit e më gjerë, kur i kam shqiptuar emrin e vendit "Sllatinë" me humor më tha: E dini kuptimin e kësaj fjale? Ndonëse e kisha mësuar nga shkrimtari e poeti i talentuar dibran Agron Tufa, atij ju përgjigja se nuk e di edhe pse me të komunikoja në gjuhë sllave.

- Ëmbëlsirë - e ka kuptimin në shqip, - u përgjigj kolegu bullgar.

E saktë, thashë me vete. E falënderova për kuptimin e fjalës. Kështu më kishte thënë edhe i madhi Tufa. Them "i madhi", pasi ashtu është pozicionuar ai në letërsinë e sotme shqipe.

Albanin e takoja për herë të parë. Një djalë me trup mesatar, elegant dhe me një shikim të ëmbël si vetë emri i fshatit nga vinte. U paraqit ashtu thjeshtë, siç vijnë në fillim gjithë studentët, por me një ndryshim nga të tjerët, që nuk e pata të vështirë ta kuptoja që në takimin e parë. Ndërsa bisedonte me mua dhe më jepte lajmet e fundit nga Tirana, nga përgjigjet që më jepte për pyetjet që i bëja kuptoja se mezi priste të shikonte gurët në qoshin e tavolinës sime të punës. Njeriu kurioz e me prirje të veçanta njihet që në takimin e parë. Më vonë do të mësoja se ishte ndër studentët e shkëlqyer në mësime në fakultet dhe ky fakt më gëzoi shumë, ndonëse nuk e pata të vështirë që në ditët e para të praktikës mësimore, të kuptoja pasionin dhe dëshirën e tij për të përvetësuar sa më shumë në praktikë të fshehtat e profesionit të gjerë e të pafund të gjeologut.

Porosita kuzhinierin (që asokohe kryente dhe detyrën e magazinierit të ekipit, pasi shumica e punëtorëve ishin vendas, kësisoj nuk bëheshim shumë veta që do të na gatuante në ekip), që të merrte masat për ta pajisur me rrobat e fjetjes dhe nuk harrova t'i kujtoj çarçafët e rinj të papërdorur.

- Jo - ndërhyri në bisedë ai - nëse keni vështirësi ka dhe një zgjidhje tjetër, unë jam djalë i ri dhe mundem të shkoj në shtëpi çdo natë e kthehem nesër në mëngjes përsëri në ekip. Më këmbë Sllatina prej ekipit ishte dy orë e gjysmë larg për të ardhur, ndërsa në kthim ishte pak më lehtë, pasi maloret pakësoheshin shumë në rrugën këmbësore drejt fshatit. Asokohe makina nuk llogaritej.

- Jo, - i them unë, - do të qëndroni në ekip për ditët që unë do të jem këtu, pastaj do të veprosh sipas atij varianti, ndonëse ka lodhje të madhe, edhe pse jeni i ri. Me largimin tim nga ekipi do të kesh më pak punë për të kryer si për vete, ashtu dhe për nevojat dokumentuese të ekipit. Ashtu ramë dakord. Atë pasdite, pasi pushoi pak, u mor me lexime dhe herë pas herë vinte pranë meje dhe më ngacmonte me pyetje nga më të ndryshmet rreth mineralit, rezultateve të punimeve gjeologo-kërkuese, perspektivës etj. Ishte kurioz të dinte shumë gjëra ndaj bënte dhe shumë pyetje. Të nesërmen u ngritëm herët. Shkuam në një nga Bjeshkët e Kalasë së Dodës, konkretisht në Malin e Sorokolit fillimisht afër Rrafshit të Radomirës, mbi Kruan e Mbretit dhe pasditen e vonë kaluan në objektin Gurët e Kodrës, ku kishim të përqendruar shumicën e punimeve kryesore gjeologo-kërkuese që do të na garantonin rezervat e planifikuara për atë vit për mineralet oksido – silikate të hekurit, që në zhargonin e kohës thirreshin me emërtimin "hekur pa nikel".

I shpjegova mendimet e mia mbi zhvillimin e fushës xeherore të Sorokolit (prerjen stratigrafike të vendburimit të cilën e kishim konsultuar me profesor Kodrën edhe me specialistët e ISPGJ në Tiranë), e cila paraqitej si një brahisinklinal i madh i copëtuar nga të gjitha anët nga shkëputjet tektonike deri në pjesë të trupave xeherore të lëvizur dhe të "qerrëzuar", duke e shoqëruar shpjegimin me një mori skicash. Në këtë strukturë brasinklinale i shpjegova mikut më të ri të ekipit gjeologjik shtrirjen dhe rënien e disa trupave xeherorë kryesor hekur-mbajtës të zbuluar.

U mundova t'i tregoj në detaje tre llojet minerale që dominonin trupin xeheror si shamozitin, hematitin dhe turingitin, minerale silikate dhe okside të hekurit me ngjyrë nga jeshile në të errët deri në të zezë kafe. Në ditët në vazhdim, kur kishim për të dokumentuar kanale apo puse minerare, i vura detyrë të bënte dokumentimet dhe përshkrimet gjeologjike të punimeve që kryenim si dhe gjatë kohës kur punonim në rilevim, atë të dokumentimit të zhveshjeve.

Edhe në marshutat e lira që kryenim në zonën e Sorokolit për të saktësuar me imtësi pjesët e copëtuara tektonike të buzëve të brahisinklinalit të VB të Sorokolit e pata vënë të bënte vetë disa procese pune deri dhe dokumentimin e shpimeve apo hedhjen në hartë të disa detajeve gjeologjike dhe linjave tektonike. Pyetjet që bënte më vunë më shumë në lëvizje për të përshpejtuar punimet në realizimin e detyrave të kohës të ekipit gjeologjik.

Shkurt, me ardhjen e Albanit unë e rrita pak ritmin e punës në terren jo vetëm për faktin se duhej ta ndihmoja në realizimin e programit të tij të praktikës, por ishin dhe punët tona shtetërore që ma diktonin të nxitoja në realizimin e detyrave, pasi gjeologu në verë ka më shumë angazhime në terren se në stinët e tjera. Kësisoj, duhej t'i kryenim me patjetër disa punë aq më tepër në zona malore ku koha të tradhton shpejt. Çdo ditë në terren duhet të punosh sa për dy ditë, ndryshe je i humbur në të gjitha drejtimet e planet të mbetën në letër, plus që jeta ka të papriturat e veta.

Në njërin nga ato ditë pune intensive do të shkoja në terren së bashku me Albanin (në atë kohë ne e thërrisnim Ahmet, por mesa duket, vite më vonë ai e ktheu "Alban", për t'u identifikuar më lehtë se ishte shqiptar) në një zonë pak larg punimeve ku dhe ngritëm për disa ditë dy çadra italiane me ngjyrë jeshile si bari i Bjeshkëve të Korabit. Punuam pa orar nga mëngjesi deri në perëndim të diellit, aq sa që të dy ndjenim lodhje fizike, pasi lodhjen mendore nuk e llogarisnim. Asnjëherë nuk e kam kuptuar pse ndodhte kjo gjë sidomos gjatë punimeve fushore. Ndoshta nga terreni i vështirë, lodhja fizike predominonte, e bënte të vetën, duke mos lënë vend për të diskutuar për gjëra të tjera. Në perëndim të diellit, rrugës duke u kthyer në çadër, Albani më pyet: A shkon shpesh në shtëpi inxhinier? Një herë në muaj ose një herë në dy javë, sipas rastit dhe rezultateve të punës – i përgjigjem shkurt unë.

Mirë, mirë, - belbëzoi nën buzë, por nuk më dha shpjegim pse ma bëri atë pyetje. As unë nuk e pyeta. Të them të drejtën, gjatë ditës e vura disa herë në provë në doku-

shënime në çadër



Në foto: "Mysafiri i ri në çadrën e gjeologëve" të ekipit gjeologjik të hekurit në Sorokol, prof. Alban Çollaku, por me një "ndryshim të vogël", asokohe ishte fare i ri dhe ballin e kishte plotë e përplotë me flokë, kurse sot vitet e kanë bërë punën e tyre edhe pse ai nuk e tregon moshën falë faktit të angazhimit në punë me plotë pasion dhe shumë energjik.

mentime të pavarura dhe herë pas here ia verifikoja ato që bënte. Ishin kohë të tjera, kur pa pagesë bënim punë me përkushtim, duke ndjerë përgjegjësi dhe njëherësh dhe kënaqësi, sidomos kur kishin stazhier të përgatitur si Albani.

Në një çast pune të asaj dite i kontrollova vizatimet që bënte në shërbim e sqarim të dokumentimeve gjeologjike që i kisha ngarkuar. Më bëri shumë përshtypje saktësia me të cilën vizatonte. I thashë: "Ju vizatoni apo fotografoni". Buzëqeshi pakëz, por nuk foli. Dhe vijoi: "Nëse ju më lejoni, dua të kthehem përsëri nesër, se nuk arrita t'i mbaroj të gjitha dokumentimet plotësisht sipas merakut tim" - ma kërkoi me shumë seriozitet. Albanit nuk i kisha shprehur asnjë konsideratë për punën që bënte, pasi desha të mos ndikoja tek ai hëpërhë me opinione, aq më tepër se kam dhe mendimin se nganjëherë opinionet janë perde e realitetit dhe, për të qenë të sakta ato duhet të mbarosh një thes me kripë me personin që punon -thonë fjalët e urta të popullit tonë. Kisha menduar në fund t'i shprehja disa konsiderata të matura nga puna e tij në praktikë dhe vlerësimet zyrtare për të do t'i bëja me shkrim, siç ishin rregullat strikte në atë kohë, që, për hir të vërtetës, për arsimin kishte një kujdesje e rregull, kërkesë të lartë dhe objektivitet sa i përket vlerësimeve, jo si në ditët e sotme ku ka shumë padrejtësi e parregullsi. Gjatë praktikës u mundova të ruaja seriozitetin.

Kjo formë pune mendoja unë i ndihmonte së tepërmi praktikantët për të përvetësuar më shumë dije. Familjariteti me ta duhej t'i përkiste një periudhe më të vonë. Këtë metodë e aplikoja më të gjithë praktikantët. Kisha parasysh edhe periudhat kur kisha qenë vetë student, mendësitë që kisha apo paragjykimet për punën dhe për sjelljet e inxhinierëve të asaj kohe gjatë praktikave që bënim në ekipe të ndryshme gjeologjike të vendit apo dhe përvojën me pedagogët e fakultetit. Desha të isha vetvetja. As që e shkoja ndërmend në atë kohë se do të vinte ajo ditë që unë do të jepja mësim në auditorët e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, edhe pse e kisha atë dëshirë, por e shikoja si të pamundur.

Ja që jeta ma plotësoi shumë vite më vonë dëshirën. Krahas punës në Institutin e Gjeoshkencave, në vitin 2009 fillova të jepja leksione si pedagog i jashtëm në fakultet në lëndën "Rilevim Gjeologjik dhe Gjeomorfologjik" (në degën e Gjeoinformatikës). Disa vite më vonë edhe në lëndën "Vendburimet e Mineraleve të Dobishme të Ngurta dhe Kërkimi i Tyre" (në degët Inxhinieri gjeologjike dhe Gjeoinformatikë). Kësisoj, ndjeva nga afër përgjegjësinë e madhe të asaj pune me pasion që kisha bërë me gjithë praktikantët në ato vite të largëta dhe që do më ndihmonte aq shumë në procesin e mësimdhënies në drejtim të materializimit të leksioneve. Bëje në det, se e gjen në kripë – thotë një fjalë e urtë nga i pagabueshmi popull.

Ne një nga pasdarket e atyre ditëve të zjarrta të punëve në terren, kur midis nesh kishte filluar të kristalizohej një miqësi e re dhe që premtonte se do të jetonte gjatë, erdhi e u ul pranë meje dhe filloi një bisedë sa shoqërore, aq dhe familjare, duke filluar të më shpjegojë se atë vit kishte qenë kandidat për të studiuar në Francë dhe në momentin e fundit e kishin hequr nga lista. Kishte takuar Ministren e Arsimit të asaj kohe, zonjën Tefta Cami, për të sqaruar përse e kishin hequr. Më shpjegoi me hollësi të gjithë historinë, por dukej i qetë dhe i bindur se një ditë ëndrra do t'i realizohej. Mua më dukej e pamundur, por e dëgjoja me shumë vëmendje, sepse më kujtoheshin vështirësitë e mia për të shkuar asokohe në shkollë të lartë disa vite më parë, jo më jashtë shtetit, që as e kam shkuar në mendje, pasi do duhen shumë faqe libri për ta përshkruar atë kalvar të babait tim për të më plotësuar dëshirën më të zjarrtë të jetës, shkollimin deri në mbarimin e fakultetit.

Më fliste me shumë pasion për historinë e Francës, librat e Jules Verne, Voltaire, Victor Hygo etj., sikur të kishte lindur atje. Unë përgjithësisht lexoj libra dhe jam sistematik në leximin e tyre, por të them të drejtën vetëm Hygoin kisha lexuar në atë kohë që po bisedoja me Albanin.

I thashë që ka pasur raste që studentët që kanë shkuar për studime jashtë nuk janë kthyer ose më saktë shumica nuk janë kthyer. "Unë e dua shumë Shqipërinë dhe familjen dhe asnjëherë nuk do t'i tradhtoj" - m`u përgjigj ai. Pastaj shtoi: "Dibranët nuk ikin, nëse duan të ikin, nuk kanë nevojë për të shkuar në Francë, kufiri me Jugosllavinë është shumë afër".

Arsyetova pozitivisht përgjigjen e tij, por nuk vazhdova më tej. Asokohe bisedat politike ishin me zarar me vëllanë, jo më me të tjerët. Ai ishte fare i ri dhe me shumë ëndrra për të ardhmen, aq më tepër se një shkëndijë për mirë e kishte të freskët. Pse të mos ishte optimist se ajo shkëndijë do të ndizte zjarrin e perspektivës së tij. Kaluan shpejt ditët e praktikës. Një muaj ikën shpejt, aq më tepër kur është i ngarkuar më punë, me të papritura të shumta e biseda profesionale tepër mbresëlënëse.

Nga kjo kohë e largët një miqësi e sinqertë u vendos midis nesh dhe që premtonte vazhdimin. Ashtu ndodhi. Miqësia dhe bashkëpunimi vazhdojnë dhe sot e kësaj dite. Pas atij kontakti dhe asaj praktike e pune me të, që nuk do t'i harroj kurrë, e kam ndjekur nga larg karrierën e tij jo vetëm si mik, por edhe si dibran.

Në vitin e largët 1983 Albani mbaron me rezultate të shkëlqyera Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në Tiranë dhe po atë vit emërohet pedagog në Katedrën e Gjeologjisë së Shqipërisë që drejtohej nga i shumërespektuari profesor Luan Peza. Albani ishte pedagogu më i ri në Universitetin Shtetëror të Tiranës, pjesë e të cilit ishte edhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave.

Në një nga shërbimet e mia në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave në marsin e vitit 1984, u gjenda për konsultime pranë Katedrës së Vendburimeve të Mineraleve të Dobishme, ku takova profesor Luan Pezën. Ai ishte një nga themeluesit e gjeologjisë së Shqipërisë, gjeologu që përktheu nga gjermanishtja veprat e Novakut, studiuesi i pasionuar, pedagogu i palodhur dhe një figurë e lartë njerëzore. Duke zbritur me të shkallët e mermerta të fakultetit më tha: "Kam zgjedhur një malësor nga zonat tuaja për të më zëvendësuar kur të dal në pension dhe vijoi, deri tani jam shumë i kënaqur nga puna e Albanit". I përgjigjem: "Është një vlerësim që na ke bërë ne të gjithë studentëve, jo vetëm nga veriu, por nga gjithë Shqipëria, na ke dhënë shpresa se ky vend ka dhe njerëz të drejtë që vlerësojnë punën pa paragjykime, pa miqësira e pa tarafe. Të jesh i sigurt se Albani do ta justifikojë besimin që i keni dhënë". Tani them me vete: Ka sot njerëz të tillë?! Nuk ka ose ka shumë pak. E ndjeva që fjalët e mia të sinqerta e prekën pa masë.

I shkëlqyen sytë dhe lëshoi një psherëtimë: Ah, ju dibranët, ju dibranët!

- E dini se unë e kam gruan nga Dibra e Madhe – m'u drejtua profesori.

- Jo, - i them. Qeshi pak duke më tundur kokën, por nuk foli. U përshëndetëm duke u përqafuam në shkallët hyrëse të godinës monumentale të fakultetit. Isha ndarë për herë të fundit me këtë personalitet të shquar të gjeologjisë dhe mësimdhënies. Si sot e kam të freskët atë takim. E ku ta dija unë se do ta takoja për herë të fundit të madhin Luan Peza!

Në vitin 1986 shteti shqiptar e dërgoi Albanin për studime pasuniversitare në Francë. M'u kujtua biseda në çadër e vitit 1980 që pata zhvilluar me të. Si një njeri që kam ruajtur gjithmonë në zemër besimin te Zoti, thashë me vete: "Kjo është shenjë e një drejtësie hyjnore që ju realizua ëndrra". Vitin e parë studion në Universitetin "Claude Bernard" të Lionit dhe nga aty në shtator të vitit 1987 arrin aty ku dëshironte, në Universitetin "Pierre dhe Marie Curie" të Parisit, ku do të punonte nën drejtimin e gjeologut të madh francez Jean Aubouin, i cili me vonë do të emërohet Kryetar i Akademisë së Shkencave të Francës. Një tjetër shkencëtar i madh si Jean Paul Cadet zëvendëson Jean Aubouin në detyrën e Shefit të Departamentit të Gjeologjisë Strukturore në Paris 6.

Në qershor të vitit 1989 takohem në Peshkopi me Albanin së bashku me profesorin francez Jean Paul Cadet që e kishte udhëheqës, të cilët do të punonin në terren në ndihmë të përgatitjes së doktoratës së tij me teme: "Zhvillimi geodinamik i Shqipërisë së Veriut". Ishin po ashtu edhe të respektuarit profesor Vangjel Melo dhe Aleks Vranaj, udhëheqës të doktoratës së Albanit nga ana shqiptare.

Si sot e kujtoj debatin që zhvilluam para Hotel Turizmit në Peshkopi me profesorin francez Jean Paul Cadet (Albani na përkthente rrjedhshëm nga frëngjishtja me një theks të lakmueshëm), në lidhje me alloktoninë apo autoktoninë e ofioliteve. Në atë kohë isha i ri dhe, kur thonë, i merrja pak me rrëmbim gjërat, edhe pse isha vetvetja në atë ide që mbroja. Edhe sot e kësaj dite jam me po ato mendime, për të cilat profesor Alaudin Kodra dhe unë, kemi dorëzuar për botim një artikull në numrin e parë të Revistës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2019.

Një vit më vonë botoi artikullin e parë me profesorët Jean Paul Cadet, Vangjel Melo, Aleks Vranaj dhe Michel Bonneau mbi dritaret tektonike të Peshkopisë: "Sur l'allochtonie des zones internes albanaises: mise en évidence de fenêtres a l'arrière de la nappe ophiolitique de la Mirdita (Albanie)", botime të tjera do të kishte nga Albani në vitet në vazhdim.

Në një nga botimet, duke u bazuar në të dhënat fushore si dhe në përcaktimet faunistike nga specialistët më të mirë francezë, Albani propozon hipotezën se gjipset e Malit të Bardhë, flishi paleogjenik me numulite në fshatin Sllatinë, Venisht etj., flishi Jurasiko-kretak me copa ofiolitesh etj., në Kallë, Vleshë, afër Sllovës e Sllatinës etj., që i rrethojnë ato, dalin në formën e dritareve tektonike të emërtuara: "Dritaret tektonike të Peshkopisë dhe të Sllatinës" (sot emërtimi përdoret edhe Dritarja e Malit të Bardhe apo e Përroit të Gramës etj., varësisht nga autorët). Brezat e ardhshëm të gjeologëve do të vërtetojnë nëse kjo hipotezë është e drejtë apo e gabuar.

Në prill të vitit 1992 mbron me sukses doktoratën në Universitetin "Pierre e Marie Curie" (Paris 6) me vlerësimin "Tres Honorable", vlerësimi më i lartë në Francë. Në shtator të këtij viti Albani kthehet në Tiranë për të rifilluar si pedagog. Shefi i Katedrës së Gjeologjisë së Shqipërisë, profesor Selam Meço, i njohur për kërkesën e lartë dhe korrektesën në mësimdhënie, ia kishte ruajtur vendin e punës. Ndryshimet dhe zhvillimet demokratike të pas vitit 1991 në Shqipëri jua kthyen lirinë njerëzve. Në ato ditë të fillimit, të gjithë e kishin mendjen për të ikur dhe çuditërisht, Albani habit me kthimin e tij në Shqipëri. Në vitin 1994 takohemi përsëri në Tiranë, ku ishte ngarkuar me detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të kompanisë franceze "Coparex" për kërkimin e Naftës në Shqipërinë e Mesme, në rajonin Peqin - Tiranë - Milot. Në vitin 2003 kompania "Coparex" blihet nga kompania suedeze "Lundin Petroleum". Por grupi i ri, i kënaqur nga puna e bërë në Shqipëri, vazhdon ta mbajë Albanin në krye të filialit të saj. Në vitin 2004 "Lundin Petroleum" shet interesat e saj në Shqipëri. Në këtë vit Albani krijon kompaninë e tij "Geoprofil", e cila realizon disa projekte të rëndësishme me kompaninë zvicerane "Pertomanas" dhe kompaninë kanadeze "Sherhood".

Në vitin 2006 Albani fluturon për në Bukuresht, pasi pranon ofertën e kompanisë "Schlumberger", kompania më e madhe në botë në fushën e shërbimeve në naftë, në detyrën e Drejtorit të Studimeve për Evropën dhe Afrikën. Në vitin 2007 "Schlumberger" e dërgon në vendburimin e naftës Hassi Messaoud në Algjeri, një nga vendburimet më të mëdha në botë. Në dy vitet e para drejton ekipin e gjeologjisë dhe gjeofizikës për perspektivën e pjesës jugore të vendburimit, ku propozon disa puse të suksesshme. Me mbarimin e projektit në shtator të vitit 2010 transferohet në Kongo, i bazuar në qytetin bregdetar Pointe Noire, drejton punimet për zhvillimin e një vendburimi nafte. Në vitin 2011, me bazim në Francë, drejton një ekip me një shumicë specialistësh amerikanë për vlerësimin e perspektivës për naftë dhe gazmbajtje të shisteve të Algjerisë.

Me kërkesë të kompanisë kombëtare algjeriane "Sonatrach", Albani rikthehet përsëri në Algjeri, ku vazhdon kërkimet për naftë dhe gaz me të njëjtin pasion dhe këmbëngulje si në vitet e rinisë, katër dekada më parë gjatë stazhit në Bjeshkët e nalta të Korabit.

Dibra në çdo kohë ka nxjerrë specialistë në fushën e gjeologjisë me kontribute të vlerësuara kombëtare, veçanërisht nga ish punonjësit e ish Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë. Këtu solla mes kujtimeve Alban (Ahmet) Çollakun me origjinë nga Sllatina e Sllovës në rrëzën e Malit të Bardhë evaporitik, në rrëzën e këtij gjeomonumenti natyror me vlera të jashtëzakonshme rajonale e europiane, me dukuri të rralla erozionale, karstike, mineralogjike, strukturore dhe sidomos tektonike, për të cilat nuk ka harruar të shkruajë profesor Albani në revista shkencore autoritare të njohura të Francës dhe Europës, për të saktësuar "rrënjët gjeologjike të vendlindjes", autoktoninë apo alloktoninë e tyre. Sa herë vjen në Tiranë, nuk harron të më takojë dhe bisedat "humbasin" në bjeshkët e pafundme të Korabit dhe çadrat me ngjyrën e bjeshkëve që zbukuronin dhe konkurronin natyrën e atyre naltësive malore madhështore e të pafundme.

Marrë nga libri i ***prof. asoc. dr. Vesel Hoxha*** *"Shënime në çadër",*

Ramiz Lela, edhe tani që është në pension, ai është në kohë, është i respektuar dhe dinjitoz, më i respektuar dhe më dinjitoz se vetë koha. Ai ecën me kohën, ecën para kohës, i paraprin asaj.

profil

Ramiz Lela, *drejtuesi i suksesshëm i arsimit*

Nga **SHAQIR ÇERPJA**

Njerëzit jetojnë në kohë dhe ecin bashkë me kohën. Kohën e bëjnë njerëzit; ata e përcaktojnë dhe i japin jetë kohës, por koha i formon, i njeh, i provon, i çmon dhe i vlerëson njerëzit. Nuk është thjeshtë fat, por është fakt që, vetëm me meritën e tij dhe vetëm për meritën e tij, Ramiz Lela, edhe tani që është në pension, ai është në kohë, është i respektuar dhe dinjitoz, më i respektuar dhe më dinjitoz se vetë koha. Ai ecën me kohën, ecën para kohës, i paraprin asaj. Ndodh kështu, sepse ai, puna, roli dhe kontributi i tij në zhvillimin e arsimit në Dibër, por edhe në Durrës, çmohen dhe vlerësohen maksimalisht, nga njerëzit, të cilët, kanë njohur Ramizin dhe produktin e punës së tij shumëvjeçare, si drejtues i arsimit.

Megjithëse ishte në moshë shumë të re, kur nisi dhe filloi karrierën e tij si drejtues arsimi, fillimisht drejtor shkolle në shkollën e mesme Zall-Dardhë dhe në shkollën e mesme të përgjithshme Peshkopi, pastaj, për shumë vite me radhë, drejtoi arsimin në rrethin e Dibrës, me detyrën e përgjegjësit të seksionit të arsimit dhe kulturës në Peshkopi, ai, që në fillimet e punës dhe karrierës së tij, tregoi përgatitje të lartë profesionale dhe shkencore, manifestoi vullnet dhe përkushtim dhe dëshmoi aftësi dhe zotësi drejtuese dhe organizuese dhe, shumë shpejt, u afirmua si një intelektual me formim të gjithanshëm dhe si një drejtues arsimi shumë i suksesshëm.

Detyra e përgjegjësit të seksionit të arsimit dhe kulturës, që kryente Ramizi, nuk ishte privilegj dhe detyrë e lehtë, që mund të përmbushej vetëm duke njohur, studiuar, analizuar dhe kalkuluar statistikat arsimore, por përkundrazi, ishte një detyrë me përgjegjësi të madhe dhe shumë e vështirë, sepse kjo periudhë përkoi me një kohë të ngjeshur dhe të vrullshme pune, përkushtimi dhe mobilizimi të gjithanshëm për masivizimin, përhapjen dhe shtrirjen e arsimit të mesëm në të gjithë zonat e vendit, por edhe për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të gjithë procesit mësimor dhe edukativ në shkolla, për ta bërë shkollën një vatër të rëndësishme mësimi, edukimi dhe emancipimi shoqëror.

Puna dhe mobilizimi i gjithanshëm, veç të tjerave, konsistonte edhe në zgjidhjen e problemit të infrastrukturës, përmirësimin, përshtatjen dhe zgjerimin e objekteve shkollore ekzistuese, por edhe ndërtimin dhe ngritjen e godinave të reja shkollore disa katshe, në disa zona të rrethit, si dhe ngritjen dhe pajisjen me laboratorë modern të klasave në të gjitha shkollat. Aq më e vështirë bëhej detyra e drejtuesit të arsimit, nga fakti se Dibra ishte një rreth me shtrirje dhe hapësirë të madhe gjeografike, duke filluar nga Stebleva, në kufi me Librazhdin dhe deri në Kala të Dodës e Reç, në kufi me Kukësin dhe që, megjithë përparimet e bëra dhe sukseset e arritura, përsëri Dibra trashëgonte probleme dhe problematika të shumta, me specifika të veçanta për çdo zonë.

Në punën e tij drejtuese, Ramiz Lela nuk u mbështet vetëm në zbatimin me korrektësi dhe përpikmëri të normave ligjore, të rregullave dhe rregulloreve, por, në radhë të parë, duke qenë vetë shembull dhe model i përkryer i përkushtimit, korrektësisë, këmbënguljes dhe mobilizimit për realizimin e detyrave dhe objektivave. Ai ishte vizionar dhe largpamës dhe i parandiente zhvillimet, prandaj me punë dhe organizim i paraprinte zhvillimit, duke punuar me objektiva të qarta dhe konkrete për çdo ditë, javë, muaj e vit. Jo vetëm në punë, por edhe në jetën e përditshme, ai ishte njeri autoritar dhe autoriteti i tij, përveç formimit të tij intelektual, lidhej, rridhte e vinte nga karakteri, serioziteti, korrektësia dhe vetëdisiplina e tij shembullore. Në punë dhe në jetë, ai udhëhiqej nga ambicia, që, gjithmonë e vazhdimisht, të përfaqësohej jo vetëm nga prania e tij, por edhe në mungesë të pranisë së tij, kudo e kurdoherë të përfaqësohej nga puna dhe rezultatet, nga sukseset dhe veprat. Egoja e tij profesionale për punë dhe sukses, për përparim dhe progres shihej me simpati dhe admirim, çmohej e vlerësohej maksimalisht dhe shpërblehej me mirënjohje dhe respekt nga njerëzit.



Në punën e tij drejtuese, Ramiz Lela nuk u mbështet vetëm në zbatimin me korrektësi dhe përpikmëri të normave ligjore, të rregullave dhe rregulloreve, por, në radhë të parë, duke qenë vetë shembull dhe model i përkryer i përkushtimit, korrektësisë, këmbënguljes dhe mobilizimit për realizimin e detyrave dhe objektivave. Ai ishte vizionar dhe largpamës dhe i parandiente zhvillimet, prandaj me punë dhe organizim i paraprinte zhvillimit, duke punuar me objektiva të qarta dhe konkrete për çdo ditë, javë, muaj e vit.


Nga Dr. Xhevdet Sula, ish nxënës i Ramiz Lelës:

Për mua dhe për brezin tim, ishte fat i madh, që u shkolluam në kohën, kur arsimi dhe arsimimi i njerëzve ishte prioritet parësor dhe shumë i rëndësishëm i kohës dhe shkolla ishte shumë cilësore dhe, kjo lidhej e vinte dhe nga fakti se personeli mësimdhënës, përveçse ishte shumë i përgatitur profesionalisht, ishte edhe i përkushtuar maksimalisht për punë dhe sukses.

Në mendimin dhe vlerësimin tim, por edhe të tjerëve, Ramiz Lela ishte dhe mbetet njeriu, intelektuali dhe drejtuesi shumë i suksesshëm i shkollës dhe arsimit në Dibër. Megjithëse karrierën e tij drejtuese e filloi në moshë të re, përveçse shumë i përgatitur profesionalisht, ai ishte shumë i përkushtuar, korrekt, serioz dhe autoritar. Figura dhe personaliteti i tij ishin impresionues dhe shumë të vlerësuar, jo vetëm nga nxënësit dhe mësuesit, por edhe nga njerëzit e tjerë, edhe nga drejtuesit politik e shtetëror, jo vetëm në Dibër, por edhe në dikasterin e arsimit në Tiranë. Megjithëse vazhdimisht ka punuar e drejtuar në institucione të rëndësishme, ai, gjithmonë respektonte, vlerësonte, përkrahte, mbështeste dhe ndihmonte njerëzit e thjeshtë, punëtorin dhe fshatarin, minatorin e muratorin, bujkun dhe blegtorin, …

Vazhdimisht, por veçanërisht, kur ishte përgjegjës i seksionit të arsimit dhe kulturës dhe drejtonte arsimin në Dibër, ai i dha shtytje të madhe cilësore, zhvillimit të arsimit në Dibër, duke i dhënë prioritet arsimimit të nxënësve me rezultate të larta dhe duke krijuar një armatë të madhe intelektualësh dibranë, mjaftë të suksesshëm.

Ramiz Lela ishte, është dhe mbetet njeri shumë i vlerësuar dhe respektuar.



Edhe pse kanë kaluar më shumë se tridhjetë vjet, qëkur Ramizi u largua nga Dibra për të jetuar dhe punuar në Durrës, në Dibër çmohet dhe vlerësohet puna dhe gjurmët e kontributit të tij shumëvjeçar në drejtimin e arsimit. Në përgatitjen, në formimin dhe rritjen profesionale, në përparimin dhe suksesin e sa e sa dibranëve të shkolluar e arsimuar në shkollat dhe universitete të vendit tonë, të cilët punojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, sigurisht është kontributi, mendimi, vendimi, dora dhe firma e Ramiz Lelës.

Pas shumë vitesh pune dhe karriere të suksesshme në rrethin e Dibrës, Ramizi transferohet për të jetuar në Durrës, ku vazhdoi punën dhe karrierën, fillimisht drejtor shkolle në shkollën e mesme, pastaj për shumë vite punoi në Drejtorinë Rajonale të ISSH, Durrës. Ashtu si në Dibër, edhe në Durrës punoi me përkushtim, korrektësi dhe seriozitet. Në punë dhe jashtë punës, ai vazhdimisht ka qenë dhe është mbështetje për komunitetin e madh dibran, në Durrës dhe në zonat përreth.

Nuk e kam vetëm mendim, por e kam bindje të qëndrueshme dhe të konsoliduar se, në veçanti, ne, Dardha dhe dërnjanët, duhet t'i jemi mirënjohës, ashtu siç dhe i jemi, Ramiz Lelës, i cili, jo vetëm kur punonte në Zall-Dardhë, por edhe pasi u largua, asnjëherë nuk e harroi dhe nuk e shkëputi vëmendjen nga Dardha. Sigurisht, pa mënjanuar, shmangur dhe anashkaluar përcaktimet dhe normat ligjore, Ramizi e ka përkrahur dhe mbështetur me përparësi Dardhën, jo vetëm për arsimimin e djemve dhe vajzave dërnjane, por edhe përmirësimin e infrastrukturës shkollore. Qënia e Ramizit në drejtimin e arsimit në Dibër, për Dardhën dhe dërnjanët ishte një avantazh shumë i favorshëm.


E kam thënë dhe e kam përmendur edhe më parë, në takime dhe biseda shoqërore rastësore, por nuk e shmang dhe nuk mund ta fsheh mendimin tim kritik për pushtetin vendor Zall-Dardhë, të djathtë dhe të majtë, të cilët, sipas mendimit tim, duhet të ishin kujtuar dhe të kishin menduar që me një vendim, i cili do të ishte plotësisht i arsyetuar dhe i justifikuar, për të vlerësuar dhe për t'i dhënë Ramiz Lelës mirënjohje publike institucionale. Ky shkrim i shkurtër, as nuk synon, as nuk përfaqëson dhe as nuk plotëson mungesën e mirënjohjes publike institucionale për Ramiz Lelën, por thjeshtë është kujtesë mirënjohje a, ndoshta, nxit dikë a disa, që mund të marrin iniciativë dhe gjejnë ndonjë formë dhe mundësi për vlerësim dhe mirënjohje publike për Ramiz Lelën.

histori

Me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet.

Vendi i Dibrës në Kongresin e Lushnjës

Nga Prof. dr. **BAJRAM XHAFA** *



Kur flasim për Kongresin e Lushnjës (janar 1920) kemi parasysh ngritjen e shtetit të parë shqiptar, shtetit kombëtar. Kjo e bën rëndësinë e kësaj ngjarjeje të pakrahasueshme me simotrat e saj dhe e klasifikon atë si më të madhen në historinë e shqiptarëve. Që këtej, pyetja sugjestionuese: Kush e bëri atë Kongres? Përgjigja edhe më sugjestionuese dhe paksa provokuese: Nisesos Kongresi i Lushnjës ka qenë vepër e Zogut, vepër e përkryer e Ahmet Zogut, e kurrkujt tjetër. "Zogu qe ***shtylla ushtarake e politike e Kongresit të Lushnjes*** (nënvizimi B Xh) shkruan *Miftar Spahija*...Klika, një grup terrorist dashti me e zhdukë me plum...". "Ky njeri i habitshëm kishte lemë me *sunue*..." Edhe sundoi deri më 1939-n.

Karakteri: Kongresi i Lushnjës ishte një kongres mirëfilli kombëtar dhe "shteti i dalë nga Lushnja ishte një shtet mirëfilli kombëtar, ndryshe nga krijesa e Fuqive të Mëdha në vitet 1912-1914", shkruan prof. *Arben Puto*. Në Lushnje *Shteti Shqiptar u ngrit*, nuk u ringrit.

"Pa Lushnjën nuk do të kishte ndodhë mrekullia e Vlorës...[1]. Janë të lidhura në mënyrë kauzale. Edhe kjo ishte vepër e Zogut. Ekskluzivisht. S. Delvina ishte "kryeministër nominal", ndërsa në krye ishte Zogu", shkruan Mustafa Kruja.[2]

Pyetje: Po "s*hoq*", mik apo aleat kush iu bë Shqipërisë? Kush e kurdisi zemrekun e sahatit? Përgjigje: *Britania e Madhe*. Misionarët e saj: Konsulli Eden i Inteligjenc Services, që i ranë kambët duke i rënë rrotull Shqipërisë. Gjenerali ***Filips***, ish komandant i trupave aleate në Shkodër më 1913-14 dhe vjen si aleat në Shkodër më 1919. Vetëm ky mund t'i ujdiste punët në Shkodër. "Luani britanik" është edhe i frikshëm. Ishte dhe një tjetër: ***Josef Haven,*** delegat (nga Presidenti Ëilson) për të bërë hetimet e nevojshme në Shqipëri. Austro – Hungaria nuk ishte më në sofrën politike, kishte vdekë. Këta misionarë i "këshillonin" shqiptarët të bënin një kongres, të ngrinin një qeveri kombëtare, të rrëzonin qeverinë proitaliane të Durrësit dhe të çlironin Vlorën. Të tjerat pastaj i bënin vetë.

Në Lushnje fryma e mbledhjes ishte *katërcipërisht lundëritaliane*, shkruan Eqrem bej Vlora, një filoitalian e proteksionis i thekur. Ishte një kongres kryengritës. Pa Kongresin e Lushnjës, "Pavarësia do të kishte qenë një akt iluzor, i paqendrueshëm", ashtu siç, pa Lushnjën nuk do të kishte pasur as Mbretëri Shqiptare, as shtet shqiptar. Edhe Lushnjën (Kongresin), edhe shtetin, edhe Mbretërinë i bëri Zogu, Ahmet bej Zogu.

Përveç vokacionit kombëtar, me platformën e Lushnjes sheherlinjtë e Dibrës i lidhte edhe një miqësi familjare me Zogun që në fillimet e shekullit XX kur Xhemal Pasha shërbente në Dibër të Madhe (alias Sheheri i Dibrës) si funksionar i Perandorisë Osmane. Miqtë e vjetër të babës u bënë edhe për të birin. Shkulur e shpërgulur me dhunë ushtarake prej trollit të tyre shumëshekullor nga soldateska serbe dhe, shumica grumbulluar në Tiranë, në "Rrugën e Dibrës", dibranët përbënin ajkën e qytetarisë së kryeqytetit.

Nëse rrëzoheshin kërkesat italiane për Vlorën dhe protektoratin italin mbi Shqipërinë, binin poshtë edhe pretendimet e fqinjëve të tjerë, të Jugosllavisë dhe Greqisë. Prandaj ky është quajtur edhe Kongresi i Shpëtimit.

Më 1920 shqiptarët ndodheshin para detyrës së vendosjes së pavarësisë (më 1912 ajo vetën se qe shpallur) dhe sigurimi i tërësisë tokësore brenda kufijve të 1913-s. Këtë detyrë e mori përsipër Kongresi i Lushnjës në janar 1920 dhe e zgjidhi Lëvizja Çlirimtare e shqiptarëve, hallka të së cilës ishin Lufta e Vlorës, Lufta e Dibrës dhe ajo e Koplikut, të vitit 1920, të cilat ishin shprehje e zbatimit të vendimeve të Kongresit të Lushnjës. Të gjitha lidhen me një emër: Ahmet Zogu.

Pyetje: Vendi i Dibrës në Kongresin e Lushnjës.

Kur përmendim Dibrën na vijnë në mendje dy përcaktime në trajtë deduksioni:

1. Më 1908 konsulli i Austrisë në Manastir *August Kral* i shkruante Vienës: "Sytë e gjithë shqiptarëve janë drejtuar nga Dibra, dhe në të vërtetë këtu gjendet pika e gravitetit të situatës së Shqipërisë".

2. Statisti i shquar *Ferit Pashë Vlora*, ish – kryeministër i Perandorisë Osmane (1903-1908) shkruan: "Në dy Dibrat është zemra e Shqipërisë, Porta e vërtetë e Shqipërisë është atje, Kurdoherë"[3].

Delegatët e Dibrës në kongres kanë qenë: Ramiz Daci, ndërsa nga paria nacionaliste ishin Dine Dema e Dine Maqellara (Nasufi).[4]

Dibranët iu bashkuan me zjarr e me shpirt idealit të "Lushnjës". Por edhe me forca. Pushkën e mbanin në krahë. Nga qytetaria e Dibrës: Ramiz Bej Dibra i Iliaz Pashës, (kështu e quan vazhdimisht I. Strazimiri në "Kujtimet..." e tij), bejlerët e Maqellarës, Dine Bej Maqellara, Izet Bej Maqellara, Fiqiri Dine; Ramiz Daci, Jashar Erebara, Ismail Strazimiri (Dibër), sheherlinjtë e Dibrës së Madhe grumbulluar në Tiranë, Elbasan e Peshkopi: Myftiu i Dibrës Vehbi Dibra (Agolli) e Hafiz Sherif Langu, Abdurrahman Dibra e Shefki Shatku, Izet Dibra (Shatku) e Faik Shatku, vëllezërit Selim e Riza Rusi, Zenepe Çoku (e shoqja e Dervish Himës) e Aziz Menzelxhiu, Hasan Ballanca e Sheh Latifi, e patriotë të tjerë dibranë: Kadri Fishta e Eqrem Cami, Ibrahim Xhidri e Abdullah Tërshana, Ibrahim Jegeni e shehlerët e Peshkopisë, etj. etj.

Përveç vokacionit kombëtar, me platformën e Lushnjes sheherlinjtë e Dibrës i lidhte edhe një miqësi familjare me Zogun që në fillimet e shekullit XX kur Xhemal Pasha shërbente në Dibër të Madhe (alias Sheheri i Dibrës) si funksionar i Perandorisë Osmane. Miqtë e vjetër të babës u bënë edhe për të birin. Shkulur e shpërgulur me dhunë ushtarake prej trollit të tyre shumëshekullor nga soldateska serbe dhe, shumica grumbulluar në Tiranë, në "Rrugën e Dibrës", dibranët përbënin ajkën e qytetarisë së kryeqytetit.

Lidhur fort pas atdheut dhe besimit, ata u bënë bashkidealistë e bashkluftëtarë të çështjes kombëtare dhe të projektit të Zogut në sendërtuartimin e platformës së Lushnjës. Njëherazi ata ishin burra të kultivuar bukur mirë dhe esnafë në punët e qeverisë e të njerëzisë. Nuk është e rastit që ata më vonë u ngritën në detyra të larta e me përgjegjësi në administratën e Shtetit të parë Shqiptar. Nga Shehërlinjtë e Dibrës ka protagonistë të shumtë si administratorë të zotë e burra shteti. Ata u bënë shtylla të shtetndërtimit dhe të kombformimit shqiptar. Një përcaktim të saktë dhe me kompetencë për këtë fenomen na e japin dy personalitete në kohë të ndryshme: Terenc Toçi i viteve '20 kur për Zogun thotë se, ishte ai që i bëri fiset komb dhe kombin shtet. I dyti është historiani amerikan *Bernd Fischer*: "Pavarësisht se ç'farë mendojnë për ***Mbretin Zog, ai qartazi ishte një figurë vendimtare në zhvillimet (ngritjen) e shtetit dhe kombit shqiptar".*** Në këtë proces historik dibranët kanë rol të dorës së parë në të gjitha drejtimet, politik, ushtarak, shoqëror e kulturor. Kjo fillon me Kongresin e Lushnjës. Me të drejtë dy presidentët e fundit (Nishani dhe Meta) disave prej tyre u kanë akorduar titullin më të lartë "Nderi i Kombit". Duhet përgëzuar këtu edhe puna e kujdesshme e Shoqatës "Bashkimi Dibran" me drejtues prof. Bujar Kapexhiu dhe Saimir Shatku. Peng i shoqatës duhet të mbesë vlerësimi i Abdurrahman Dibrës dhe sidomos i të birit të tij, Qenanit, të cilin diktatura e pushkatoi në lulen e rinisë si monarkist i bindur dhe i ndërgjegjshëm. Qenan Dibra është nacionalisti e antikomunisti më i panjollë.

Nga pjesa e krahut të armatosur të lëvizjes së shtetndërtimit dhe kombformimit në Dibër kanë qenë sidomos shtresa e mesme, agallarët si: Demet e Homeshit, Dine e Shaqir Dema, Selim Dema etj; nga dera e Selman Alisë, pasardhës të Salë Demirit, Dine Hoxha e Ali Tahiri (Pira)-Muhurr, Maliq Kërçishti (Agolli), Dan Cami (i Sepetovës) dhe Camet e Viçishtit, Kaloshet e Sinës e të Kandrit, Ndretë e Elezit Isufit e Suf Xhelili në Sllovë, Riza e Dervish Lusha (Arras), Murat Kaloshi e Selim Noka (Kandër), Haxhi Noka (Grykë Nokë), Sali e Selim Kaloshi (Sinë), Selman e Hakik Mena (bajraktari i Lurës), Selë Bajraktari (Arras) e Lita i Ploshtanit, Shehu i Zerqanit e Duriçi i Bulqizës, Kazihani i Selishtës (Tafa) e Llan Destani - Ndregjoni (Lukan), Kurt e Dik Spata (Grykë Nokë), Mehmet (Dedja) Skepi e Daci i Kalisit, etj., etj. Një ansambël figurash e Dyersh të fuqishme, vërtet ashtu siç i quante Edith Durhami, "Tigrat e Dibrës". Këta bënë Kryengritjen antiserbe të shtatorit 1913, Kuvendin e Arrasit, Kryengritjen antiserbe të 15 gushtit 1920 dhe, të gjithë bashkë, Dibra e Madhe e Dibra e Vogël, Malësia e Topalltia, paria e halia (vegjëlia), më mend e me kuvend, me krisma e me pushkë, me gjak e me djersë materializuan vendimet e Lushnjës për pavarësinë dhe integritetin e Shtetit Shqiptar dhe u bënë shtylla të shtetndërtimit e të kombformimit shqiptar në vitet 1920-1939.

P.S. Edhe Tiranën kryeqytet e bëri Zogu. Në fillim, "të përkohshëm, se ashtu e solli puna" dhe më pas të "përhershëm" e me rrugë e rregulla Kushtetuese. Kongresi i Lushnjës nuk di të ketë diskutuar problemin e kryeqytetit dhe të ndryshimit të tij. (Shënim: Mosmirënjohja është kryevesi i veseve).

Shkodër, 10. 02. 2020

** Mbajtur në veprimtarinë shkencore të organizuar me 11 shkurt 2020 në sallën e Teatrit Kombëtar Tiranë organizuar nga Shoqata "Bashkësia dibrane" me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet i Shqipërisë.*

1 Arben Puto, "Shqipëria Politike", Botimet Toena, Tiranë 2009, f278.

2 A. Puto, po aty, f. 278-279.

3 Marrë nga Faik Xhani, Hatixhe Erebara, "I përkushtuari"; botime M&B, Tiranë, 2012, f. 20

4H. Stërmilli, " Dibra në prag të historisë" , vepër e përmendur, cituar sipas "Kujtime dhe këngë...", f. 218.

**Analizë kritike e jetës
dhe veprës së Skenderbeut**

Epoka e Gjergj Kastriotit,
bazament i vetëdijes kombëtare shqiptare



Dr ENVER HALILI
Melburn, Australi

(vijon nga numri i kaluar)

Kastrioti gjithmonë e potenconte se "shumë ushtri janë shkatërruar më tepër nga pritat se sa në luftë të hapur" (Barleti, 1508, f.170).

Në luftë reparti i Skënderbeut gjithmonë e merrte pozicionin kryesor. Personalisht ai çdoherë hidhej i pari në luftë dhe shpeshherë i fundit e lëshonte fushë-betejën. Ai e zbatonte taktiken luftarake "në sulm pas meje". Kjo moto luftarake u ruajt dhe zbatua me dinjitet nga të gjithë luftëtarët e lirisë deri në ditët e sotme. U zbatua nga Marko Boçari, Oso Kuka, Sulejman Vokshi, Mic Sokoli, Isa Boletini, Idriz Seferi, Shote e Azem Galica, Abaz Kupi, Shaban Polluzha, Hysen Terpeza, Xheme Gostivari e deri te Adem e Hamzë Jashari.

Kujdesi ndaj ushtarëve të rrezikuar ishte një obligim i posaçëm për secilin dhe Kastrioti i këshillonte oficerët dhe ushtarët që të bëjnë gjithçka që të plagosurit mos të bien në duart e armikut. Në momentet më të vështira edhe vetë Skënderbeu u shkonte në ndihmë ushtarëve të rrezikuar dhe u shpëtonte jetën. Kujdes të jashtëzakonshëm u kushtonte të plagosurve ata gjithmonë i vizitonte, përkëdhelte dhe u jepte zemër dhe i shpërblente. Ai e sillej më shumë si ushtar se sa si komandant! Në luftë Skënderbeu çdo herë mbështetej në normat humane të luftës, respektonte kundërshtarin dhe sidomos robërit e luftës i trajtonte me dinjitet. Vlerat e larta humane, dhe thjeshtësia prej komandanti bënë siç thotë Noli (1964) që Skënderbeu të gëzojë autoritet të madh jo vetëm në popullin arbërore por edhe më gjerë.

Dhënia e meritave dhe shpërblimeve ushtarëve më të suksesshëm zinte një vend të rëndësishëm në praktikën ushtarake të Kastriotit. Ai ishte një gjeneral i kalitur me edukatën e lashtë arbërore, meritat dhe shpërblimet i ndante kudo që ato arriheshin (Bebja, 2016). Pas çdo fitore organizonte dhënien e dekoratave të cilat ua dhuronte oficerëve dhe ushtarëve të merituar. Konfiskimet e pasurive të armikut asnjëherë nuk i merrte për vete, por gjithmonë ua shpërndante ushtarëve dhe popullit (Noli, 1964). Me të drejtë populli i dedikoi Kastriotit epitetin e famshëm "Trimi i mirë me shokë shumë" të cilin e ruan të freskët edhe në ditët e sotme.

Skënderbeu ishte një gjeneral largpamës dhe një rëndësi të veçantë i kushton sigurimit dhe mbledhjes së informatave rreth operacioneve të armikut. Njësitë ushtarake për grumbullimin e informatave e kishin detyrë kryesore t'i sigurojnë dhe mbledhin informatat e nevojshme, të sakta dhe në kohë të duhur rreth planeve të armikut. Kastrioti arrinte të sigurojë informata të mjaftueshme rreth kahjeve të marshimit të ushtrisë së armikut. Sidomos kur armiku përgatiste ekspeditat sulmuese, ushtarët e repartit të zbulimit arrinin të mësonin për kahjet dhe rrugët të cilat do të merrte ushtria e armikut.

Kastrioti e njihte mirë dinakërinë e osmanëve dhe gjithmonë përgatitej për të papriturat që mund të ndodhnin. Ai zbatonte metodën tradicionale të vigjilencës së lartë se 'uji fle-armiku nuk fle' dhe urdhëronte që ushtria të vëzhgonte dhe mbante nën kontroll terrenin në mënyrë permanente. Repartet e vëzhgimit dhe mbrojtës arrinin me sukses t'i kontrollojnë dhe monitorojnë të gjitha veprimet ushtarake të armikut. Skënderbeu nuk i lejonte asgjë rastësisë dhe kujdes të veçantë i kushtonte zonave kufitare të vendit. Ai vazhdimisht punonte në rritjen vigjilencës dhe në përforcimin e mbrojtjes së brezin kufitar sidomos atij lindor dhe jugor.

"Skënderbeun e kishte nxjerre Zoti luftëtarin më të mirë në botë" (Barleti, 1508, f. 451). Ai ishte një komandant vigjilent dhe përdorte taktika luftarake sipas rrethanave përkatëse të secilës betejë. Ai shpeshherë ndërronte taktikat luftarake me qëllim që të krijohej huti te ushtarët e armikut dhe kështu arrinte të përcaktojë momentin më të përshtatshëm për të sulmuar. Taktikat kryesore luftarake të Gjergj Kastriotit mund të karakterizohet në tri mënyra: sulmo-tërhiqu-sulmo; bëj sikur tërhiqesh-kthehu dhe sulmo; fute armikun në grackë (Barletit, 1508; Nolit, 1944; Hadrit, 1995).

Por taktika kryesore luftarake të Skënderbeut e cila u zbatua në të gjitha luftërat karakterizohej me sulmet e befasishme dhe shumë të fuqishme të cilat krijonte një huti e panik tek ushtarët e armikut por gjithashtu shkaktonin edhe dëme shumë të mëdha. Aftësitë e Kastriotit për të zbatuar taktika origjinale në fushëbetejë i mundësoi ushtrisë arbërore të arrijë çdo herë fitore të lavdishme. Andaj me plot të drejtë mund të thuhet se Kastrioti ishte pasardhës i gjeneralëve të mëdhenj të cilët i kishte nxjerrë trolli iliro-pellazge, si Aleksandri i Maqedonisë dhe Pirro i Epirit.

Kastrioti ishte një komandant i urtë, i dashur dhe shumë i respektueshëm nga të gjithë, oficerët, ushtarët e populli Epirit dhe gëzonte një admirim të jashtëzakonshëm ndër popujt liridashës. Ai kishte një zemër të madhe, kishte karakter të fortë dhe qëndronte i pathyer edhe në situata shumë të rënda. Kjo vërtetohet sidomos në ato 'motet e mbrapshta' kur dy komandantët e tij dështuan dhe ia kthyen shpinën atdheut. Por udhëheqësi i mençur e çmonte vlerën dhe dinte edhe të falte kur ishte nevoja sikurse ndodhi me rastin e kthimit të Moisiut dhe Hamzës në atdhe. Veçanarisht peruljen e Moisiut nuk mundi ta durojë, e kapi atë për dore dhe me lot në sy të dy u përqafuan. Kastrioti nuk e harroi kontributin e madh që Moisi Golemi kishte dhënë në fushëbetejë dhe mbrojtjen e suksesshme të brezit kufitar lindor. Golemi ishte ndër komandantët më të shquar të ushtrisë arbërore dhe roli i tij shpesh ishte vendimtar në fushëbetejë. Të dy trimat u pajtuan dhe Skënderbeu ia ktheu Moisiut të gjitha kompetencat ushtarake dhe pasuritë të cilën e posedonte më parë. Në fund Kastrioti mori vendim që askush mos t'ia përmendë këtë gjë Moisiut. Faljen dhe riaktivizimin e këtyre dy komandantëve tregon për virtytet e larta njerëzore dhe dinjitetin mbretëror të Kastriotit.

2.4.3 Administrimi- drejtësia në shtetin e Gjergj Kastriotit

Shteti i Gjergj Kastriotit ishte organizuar në bazë të legjislacionit të së Drejtës Arbërore i trashëguar nga e kaluara paraprake e cila ishte i ndikuar nga e Drejta Romake. Nga praktika e Legjislacionit Romak shtetet ishin të organizuara në formë të mbretërive siç ishin ato të Romës, Napolit, Venedikut, e të tjera. Në përgjithësi dominonte forma parlamentare e organizimit të shteteve dhe një formë e tillë u zbatua edhe nga Skënderbeu. Skënderbeu në Kuvendin e Lezhës thirri princat arbëror të cilët në bazë vullnetare u bashkuan dhe krijuan një shtet të përbashkët bazuar në formën e mbretërisë parlamentare. Skënderbeu zyrtarisht u shpall Mbret i Arbërisë. Por praktikisht Ai ishte një udhëheqës shumë i respektueshëm si nga princat arbërorë ashtu edhe nga populli si dhe autoritetet eouropiane. Ai shhpeshherë potenconte: "*nuk është sipërfaqja e vendit ajo që e bën një fron të respektueshëm, por aftësia e atij që ulet mbi të*" (Barleti, 1508).

Këshilli i Fisnikeve ishte organi më i lartë juridik i cili merrte vendime të rëndësishme shtetërore. Ky Këshill mblidhej sipas nevojave dhe shqyrtonte çështjet e kohës dhe merrte vendime të cilat ishin të obligueshme për të gjithë fisnikët e vendit. Këshilli i Fisnikëve arbëror operoi me sukses gjatë gjithë kohës sa operoi Mbretëria e Arbërit. *Këshilli i Lartë* ishte po ashtu një organ i rëndësishëm shtetëror, i cili qëndronte afër Skënderbeut dhe shqyrtonte çështjet e rëndësishme si ato të brendshme edhe ato të jashtme. Anëtar të Këshillit ishin Pal Engjelli, Kont Urani, Tanush Topia, dhe Moisi Golemi. Ndërsa *Këshilli i Luftës* kishte një fushëveprimi më specifik dhe kryesisht shqyrtonte çështjet ushtarake dhe luftarake.

Në bazë të vendimeve të Kuvendit të Lezhës



Skanderbeg, by Dominicus Custos, Foto ilustruese

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, ishte në krye të shtetit të Arbërve dhe dispononte të gjitha të drejtat e Mbretit. Titulli zyrtar për Skënderbeun që nga vendimi i marrë unanimisht nga gjithë princat arbëror ishte "Zot i Arbërisë" (Dominus Albania). Duke pasur parasysh rrethanat e asaj kohe dhe rolin e Papatit në Europë, të gjitha shtetet kristiane ishin të ndërlidhura me qendrën e saj në Romë. Kështu në vitin 1464 Papa Piut II ishte dakorduar që Skënderbeun të kurorëzohej "Mbret i Epirit". Një ceremoni e veçantë për këtë ngjarje të rëndësishme ishte parashikuar të organizohej me rastin e ardhjes të Papa Piut II në Arbëri ku Skënderbeu do të emërohej komandant i përgjithshëm i ushtrisë europiane.

Skënderbeu ishte Mbret i Epirit dhe ushtronte funksionin e tij në të gjitha fushat e administrimit shtetërore, si në raport me administratorët e lartë dhe të mesëm, me princat, dhe me nënshtetasit e vet. Në bashkëpunim me organet pleqnare Kastrioti zgjidhte ambasadorët të cilët do t'i përfaqësonin interesat e Mbretërisë me vendet tjera. Skënderbeu shpallte dekrete, akte ligjore, dhe rregulla të ndryshme juridike për rregullimin e çështjeve të ndryshme civile, si për shembull, nxjerrja e dekreteve civile, ligjeve rreth obligimeve tatimor, doganore dhe detyrime të tjera. Sipas së drejtës së asaj kohe, nxjerrja e ligjeve me karakter shtetëror ishin nën kompetencat e Mbretit të cilat ishin obligative dhe zbatoheshin njësoj të gjithë principatat dhe nga të gjithë shtetasit e Arbërisë.

Mbretëria Arbërore kishte edhe aparatin gjyqësor funksional i cili ishte drejtpërdrejt i varur prej Skënderbeut. Dihet se në rrethanat e luftës shumë akte juridike janë nën kompetencat e mbretit. Për shembull dhënia e shpërblimeve, dekoratave, gradave të ndryshme ushtarake, dënimit e rënda, vendimet mbi konfiskimin e pasurisë, si dhe vendimet për faljet e ndryshme në raste të shkeljeve të ligjeve duhej të merreshin nga Skënderbeu.

Kastrioti ishte Mbret dinjitoz me një kulturë dhe moral të lartë dhe një vend të posaçëm i jepte drejtësisë e cila ishte baza mbi të cilën ngrehej shteti arbëror. Kjo vërtetohet veçanërisht në rastin e këshillave të cilat Skënderbeu i tha të birit të tij Gjonit në momentet e fundit të jetës se tij, ku thotë: *"o biri im Gjon,...respekto para së gjithash drejtësinë" ..." sapo të keni marrë drejtimin e pushtetit, ju do të kujdeseni për Drejtësinë, e cila është themeli i te gjitha virtyteve*. Këto këshilla janë të një rëndësie të veçantë për arsye se i biri i Skënderbeut ishte trashëgimtar i fronit mbretëror. Kështu për Gjonin si dhe Gjergjin e Ri ishte shumë e rëndësishme të ushtronin sistemin e drejtësisë arbërore. Sistemi mbretëror i drejtësisë ishte i kodifikuar dhe përbënte bazën juridike të shtetit epirot i cili mundësoi të funksiononte në mënyrë efektive. Sistemi juridik i Kastriotit bazohej në kodet e traditës arbërore dhe zbatohej nga të gjithë, si nga komandantët, administratorët po ashtu edhe nga populli. Për shkak të efikasitetit të lartë sistem juridik i Kastriotit do të mbijetojë për pesë shekuj në mendjen e popullit tonë deri në ditët e sotme.

2.4.4 Ekonomia dhe ndërtimi i vendit në kohën e Gjegj Kastriotit

Skënderbeu ishte jo vetëm strateg ushtarak por dhe shtet-ndërtues i shkëlqyeshëm. Qysh në Kuvendin e Lezhës Ai i kushtoi një rëndësi të madhe edhe aspekteve të tjera shtetërore veçanërisht ekonomisë së vendit. Organizimi i një ekonomie funksionale ishte shumë e nevojshme për të siguruar një bazë materiale mbi të cilën ngrihet e tërë superstruktura shtetërore dhe ushtarake e shtetit të Arbërisë. Skënderbeu e njihte mirë fuqinë ekonomike të Perandorisë Osmane si dhe fondet kolosale që ajo ndante për financimin e ushtrisë së saj. Andaj, vetëm një bazë e fortë materiale do të mundësonte financimin e suksesshëm të ushtrisë arbërore për t'i përballuar sulmeve të armikut.

Në Kuvendin e Lezhës u diskutua shumë për rëndësinë e organizimit të ekonomisë dhe u vendos të krijohet një arkë (thesari) shtetërore. Përgjegjës i Parë i thesarit u zgjodh Andrea Suma nga Shkodra (Frashëri, 2012). Kuvendi po ashtu diskutoi edhe për krijimin e një monedhe të mbretërisë e cila do të përdorej për të kryer këmbimet monetare dhe transaksionet e brendshme tregtare, kryerjen e pagesave dhe mbushjen e thesarit të shtetit. Për shkak të rrethanave të luftës në transaksionet monetare përdoreshin edhe valutat e vendeve tjera si ato të Venedikut, Napolit, etj.

Me qëllim që shteti të krijonte një ekonomi të suksesshme Skënderbeu i kushtonte rëndësi të madhe forcimit të mbrojtjes së brezit kufitar. Mbrojtja e kufirit veri-lindor dhe jugor u mundësoi banorëve në brendi të vendit të zhvillonin veprimtari të ndryshme prodhuese, dhe shërbimet e nevojshme tregtare dhe zejtare. Krijimin e kushteve për një ekonomi normale mundësonte shfrytëzimin e resurseve të brendshme materiale për sigurimin e ushqimit dhe artikujve të tjerë të domosdoshëm për popullin dhe ushtrinë. Prodhimi i armëve, materialit tjetër ushtarak, barnave dhe ushqimit ishin detyrat kryesore të shtetit të Kastriotit. Burimet kryesore të ekonomisë ishin, bujqësia, blegtoria, peshkataria, industria manifakturale, zejtaria dhe tregtia të cilat ishin nën pronësinë familjeve dhe principatave. Industria manifakturale merrej me prodhimin e barnave, ushqimit, veshmbathjeve, armëve dhe materialit të domosdoshëm për ushtrinë dhe popullin. Punëtoritë zejtare të cilat ishin në pronësinë e familjeve epirote luajtën një rol kyç në mirëmbajtjen dhe riparimin e armëve, veglave dhe mjeteve të tjera të luftëtarëve. Zejtarët gjithmonë bënë punë të rëndësishme për popullin dhe ushtrinë sidomos bënë shërbime për kalorësit, këmbësorinë dhe shigjetarët. Kastrioti udhëzonte që të gjithë njerëzit e aftë për punë të punojnë me zell në prodhimin dhe sigurimin e ushqimit, veshmbathjeve, materialit tjetër jetësor si për ushtrinë ashtu edhe për popullin në përgjithësi.

Një vend të rëndësishëm iu kushtua edhe çështjes së buxhetit të shtetit. Buxheti i Mbretërisë së Arbërit krijohej nga arkëtimi i taksave dhe kontributeve publike të cilat duhej të grumbulloheshin në baza vullnetare dhe të obligueshme me qëllim të mbulimit të shpenzimeve shtetërore dhe të financimit të luftës. Kuvendi i Lezhës vendosi për krijim buxhetin e shtetit i cili do të mbushej nga kontributet të cilat do t'i paguanin të gjitha principatat anëtare. Secila principatë ishte e obliguar të kontribuojë në mbushjen e buxhetit

→

Themelet e forta të vetëdijes shtet-formuese të skalitura nga dijetarët dhe gjeneralët më të njohur të historisë u mundësuan paraardhësve arbëror-epirot të bëjnë vepra të paharruara dhe stimuluan arbërit dhe shqiptarët t'i sfidojnë sulmet e shumta gjatë gjithë historisë deri në ditët tona.

"Po ju lë një mbretëri me forca të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të virtytshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj…Duhet të jetë virtyti themel i fronit… Të virtytshëm, ju mund të mbani lehtë perandorinë që po ju lë të tronditur nga lufta e vazhdueshme; ta përforconi, ta rimëkëmbni nëpërmjet pushimit dhe qetësisë…

të shtetit sipas kuotave të caktuara. Po ashtu buxheti i shtetit do të mbushej edhe nga taksat dhe kontributet doganore dhe të transaksioneve të ndryshme tregtare të cilat bëheshin me vendet e tjera. Për shembull, taksat që paguanin kriporet e Shën Kollit pranë grykëderdhjes së lumit Mat të cilat ishin nën pronësinë e Gjergj Kastriotit paraqisnin një burim të rëndësishëm të të hyrave buxhetore të shtetit arbëror (Histori e Popullit Shqiptar, 2002).

Prodhimi i materialit dhe kryerja e shërbimeve ndërtimore gjithashtu kishte një rëndësi te jashtëzakonshme. Materiali ndërtimor ishte shumë i nevojshëm për ndërtimin dhe riparimin e shtëpive të banimit, përforcimin e kështjellave, kullave, objekteve dhe pozicioneve ushtarake të cilat dëmtoheshin gjatë luftërave të shpeshta. Rindërtimi i vendit ishte një çështje akute dhe duhej të bëhej në mënyrë permanente. Andaj rindërtimi i objekteve të shkatërruara si dhe ndërtimi i fortifikatave të reja ishin obligimi kryesor jo vetëm i mjeshtrave ndërtimorë por edhe i popullit në përgjithësi. Edhe forcat ushtarake shpeshherë angazhoheshin në riparimin e objekteve ndërtimore dhe ndërtimin e barrierave të ndryshme. Punë ndërtimore dhe përforcimet e fortifikate mbrojtëse bëheshin në çdo kohë dhe në mënyrë kontinuele. Sidomos në periudhën e paqes gjatë viteve 1457-1462 në tërë vendin u bënë ndërtime të reja të fortifikatave dhe rindërtime shumë të rëndësishme të objekteve të ndryshme. Në atë kohë u bënë restaurime dhe përforcime të rëndësishme në shumë kështjella, kala dhe objekte tjera të dëmtuara gjatë luftës. Punë shumë e rëndësishme u bë në përforcimin e mureve të kështjellës së Krujës e cila ishte caku kryesor i sulmeve të ushtrisë osmane.

Këto përgatitje u bënë sepse armikut nuk mund t'i besohej dhe se ushtria arbërore duhej të ishte e përgatitur të përballej me të. Populli gjithashtu duhej të kishin kushte banimi dhe rezerva të mjaftueshme të ushqimit dhe materialit jetësor për të mbijetuar në rast të bllokadave dhe rrethimeve të cilat mund të ndodhnin në çdo kohë. Kështu që u punua mjaft shumë në prodhimin dhe grumbullimin e ushqimit, veshmbathjes dhe armëve si nga prodhuesit vendas ashtu edhe nga importimi tyre prej vendeve të tjera.

2.4.5 Strategjia Diplomatike e Gjergj Kastriotit

Skënderbeu shquhej jo vetëm si gjeneral i pashoq i kohës së tij por edhe si burrë shteti në takimet diplomatike me udhëheqësit e vendeve ballkanike dhe evropiane. Zgjuarsia, qëndrimi prej një mbreti dinjitoz, oratoria, aftësia diplomatike dhe pamja madhështore prej gjenerali impresiononte të gjithë burrështetasit e kohës së tij. Siç shkruante Gjon Muzaka, kur Papa Piu II e priti Skënderbeun në Romë ai u mahnit kur para tij doli një mbret madhështor dhe nuk e lejoi që ai të përulet, por e puthi në ballë dhe e bekoi. Papa Piut II, për shkak të aftësive të jashtëzakonshme ushtarake dhe diplomatike të cilat tregoi, vendosi ta kurorëzonte Skënderbeun Mbret të Epirit-Maqedonisë dhe ta emëronte komandant të përgjithshëm të forcave europiane.

Në kuadrin e aleancave me shtetet tjera, një vend të veçantë kishin ato me mbretëritë italiane si dhe ajo me Hungarinë dhe Bosnjën. Lufta e epirotëve nën udhëheqjen e Skënderbeut konsiderohej si një barrierë e pathyeshme që e pengonte depërtimin e ushtrisë osmane në drejtim të Italisë dhe Evropës. Sukseset e jashtëzakonshme në fushëbetejë i hapën Kastriotit rrugën për krijimin e kontakteve diplomatike dhe përfitimin e përkrahjes jo vetëm politike por edhe ushtarake nga shtetet e Europës. Në vitin 1451 Skënderbeu lidhi traktat me mbretin Alfonsi V, Venedikun, Romën, Raguzën, Bosnjën dhe Hungarinë me qëllim që të luftojnë të bashkuar kundër osmaneve.

Po ashtu një sukses i rëndësishëm i diplomacisë së Kastriotit është Marrëveshja e bashkëpunimit ushtarak me Venedikun me 20 gusht 1463. Ndihmat e vendeve aleate sidomos nga ato italiane ishin shumë të nevojshme për ushtrinë e Epirit. Vendet aleate si Venediku, Napoli, e të tjera i dhanë Skënderbeut ndihma të shumëllojshme si në ekspertë ushtarak, armatim, ushtarë, material lufte dhe ushqim.

Duke pasur të qartë se superfuqisë osmane mund t'i bëhej ballë vetëm me bashkimin e evropianëve në një front unik, Skënderbeu kërkoi pareshtur pjesëmarrjen e vendeve të Evropës në luftë kundër armikut të përbashkët. Në projektin antiosman të hartuara nga mbreti Alfonsi V, Papa Nikolla V, Papa Kaliksi III, Papa Piu II, princat e mbretërit Gjermanë e Hungarezë, një vend qendror i jepet ushtrisë epirote të Skënderbeut. Në projektin e Papa Piut II, parashikohej të formohej një front i përbashkët evropian i cili do të vepronte në dy drejtime. Në Frontin Verior (të Danubit) do të luftonin hungarezët, kurse në Frontin Jugor (të Mesdheut) do të sulmonte flota e shteteve Italiane. Papa Piu II, për shkak të suksesit të arritur ndër vite vendosi që Skënderbeu ta emërojë komandant i përgjithshëm i forcave Europiane. Këtë ide të Papa Piut II, Skënderbeu e priti me dëshirë të madhe dhe u angazhua seriozisht për realizimin saj. Fatkeqësisht në vitin 1464 kur Papa Piu II shkoi në Ankonë për të pritur ushtritë evropiane që do të tuboheshin aty për të kaluar në Raguzë ai papritur ndërroi jetë. Më 14 gusht 1464 në Ankonë bashkë me Papa Piun II u varrosën përfundimisht edhe përpjekjet për organizimin e një fronti ushtarak antiosman në shkallë evropiane.

Skënderbeu kishte një qëndrimi dinjitoz diplomatik jo vetëm në takimet me liderët dhe mbretëritë e vendeve aleate por edhe në negociata me delegacionet osmane. Gjate bisedave të shumta me të deleguarit e sulltanit, Ai ishte vigjilent, i matur dhe asnjëherë jo vetëm nuk iu frikësua kërcënimeve të sulltanit, por as nuk u lëkund fare ndaj ofertave marramendëse të tij. Në letërkëmbimet e Kastriotit me Sulltanin të prezantuara nga Barleti (1508) duket qartë qëndrimi i një diplomati të nivelit të lartë. Në një prej përgjigjeve të para drejtuar Muratit I, në mes të tjerash Kastrioti thoshte: *"Mbretërinë atërore ma rrëmbeve, vëllezërit m'i vrave dhe mua vete,…më kishe taksuar…për vdekje mizore…. Prandaj, ne nuk kërkojmë këshilla nga armiku për ç'ka duhet të bëjmë,…ne me ndihmën e perëndive fitoren e kërkojmë"* (Barleti, 1508, f. 91). Skënderbeu pra, kërkonte vetëm që Arbëria të jetë e lirë dhe në asnjë mënyrë nuk e pranonte nënshtrimin apo ndonjë shërbim prej vasali ndaj sulltanit.

Niveli i lartë diplomatik i Gjergj Kastriotit vërehet edhe në fjalorin dhe terminologjinë e zgjedhur dhe mënyrën e përgjigjes ndaj kërkesave, ofertave dhe kërcënimeve të sulltanit. Kastrioti ishte i patrembur nga kërcënimet e sulltanit dhe asnjëherë nuk pranoi ofertat dhe nuk lakmoi dhuratat kolosale të tij. Skënderbeu ishte i pa kompromis me tiranin si në fushëbetejë, ashtu edhe në procesin e negociatave të shumta të cilat ai i zhvilloi gjatë gjithë asaj periudhe përmes delegacioneve dhe letërkëmbimeve. Atdhedashuria dhe vizioni fisnik për çlirimin e vendit dhe krijimin e shtetit kombëtar ia trasuan rrugën dhe i dhanë forcë shpirtërore e fizike për realizimin e qëllimeve të larta kombëtare.

2.4.6 Këshillat e Gjergj Kastriotit

Gjergji Kastrioti ishte i lindur me dhunti natyrore- ai ishte hyjnor. Aftësitë e tij mbinjerëzore i mundësuan ta parandiejnë fundin e jetës se vet. Në janar të vitit 1468 Skënderbeu thirri një Kuvend në Lezhë dhe po atë ditë papritmas u sëmur nga ethet. Kastrioti e kuptoi keqësimin e gjendjes së tij shëndetësore dhe në mënyrë krejtësisht normale e pranoi veprimin e ligjeve të natyrës. Kryetrimit nuk iu ligështua zemra e as nuk iu dridh zëri kur e pa se nuk mund të shkonte në fushëbetejë me ushtarët e tij. Skënderbeu i shtrirë në shtrat, thirri trimat epirot dhe të birin e tij dhe ngadalë e me kujdes u dha këshilla shumë të vlefshme. Vetëm një njeri me veti hyjnore mund të jetë në gjendje që në momentet e fundit të jetës të japë këshilla e thotë fjalë aq kuptim plotë. Ato këshilla të shtrenjta do të mbeteshin përgjithmonë të freskëta në kujtesën e arbërve.

Në këshillat e tij të fundit ilustrohen më së miri virtytet e jashtëzakonshme të Kastriotit si një udhëheqës dhe mbret dinjitoz, ku në mes të tjerash thotë: *"Jam në prag të varrit"*. Më tutje ai potencon: *"Po ju lë një mbretëri me forca të afta për ta mbrojtur, por me një pasardhës të paaftë nga mosha për ta drejtuar. Megjithatë, në qoftë se në të ardhmen ju bëheni trima dhe të virtytshëm, ju mund të përballoni të gjitha sulmet e armiqve tuaj…Duhet të jetë virtyti themel i fronit…Të virtytshëm, ju mund të mbani lehtë perandorinë që po ju lë të tronditur nga lufta e vazhdueshme; ta përforconi, ta rimëkëmbni nëpërmjet pushimit dhe qetësisë…"* (Zannovich, 1779).

Në këtë fjalim vërehet shumë qartë morali i fortë njerëzor i një mbreti me dinjitet të lartë. Ai i këshilloi bashkëluftetarët e vet që të jenë të vendosur në përballjen e vështirësive dhe të qëndrojnë të pa lëkundur kundrejt armikut qoftë kur ai kërcënon dhe sulmon me mijëra ushtarë, qoftë kur ofron pozita të larta apo dhurata me vlerë marramendëse. Mbi të gjitha Kastrioti këshillon që komandantët e ushtrisë së arbërit gjithmonë duhet të jenë të virtytshëm dhe të jenë të pakompromise me armikun. Ai sugjeronte se nëse ju ndërtoni një lidership mbi themelet e virtyteve humane, Mbretëria Arbërore mund t'i përballojë dallgëve të luftës. Udhëheqësit dhe sidomos komandantët duhet të veprojnë me dinjitet dhe të sillet në bazë të normave dhe moralit tradicional arbëror, këshillonte Kastrioti.

Rëndësia e moralit dhe humanizmit të Kastrioti shihet veçanërisht në rastin e këshillave të cilat Skënderbeu i dha të birit, ku thotë: *"O biri im Gjon, të jesh i mirë, mos vë gjë para mirësisë dhe virtytit!... Respekto para se gjithash drejtësinë… Mos e duro qetësinë qull dhe plogështinë e zhburrnuar…Plogështia është burimi i të gjitha të këqijave…Ushtarët e tu mos i lër të kalben në plogështi, por ushtroi me punë;…mos i përdor ata si shërbëtorë, por si shokë e bashkëluftëtarë…Ji i duruar në mundime dhe i patrembur në rreziqe… Fatin më të keq duroje…s'ka më keq për një kapedan… se sa t'ia zbulojë tronditjen e shpirtit fytyra…Largoju pabesive, largoju dhelpërive të njerëzve të pabesë: përbuze miqësinë, dhuratat e tyre…Të marrësh gjithmonë këshilla nga këshilltarë të njohur besnikë dhe të dashur"* (Barleti, 1508, f. 487-490).

Në këta rreshta shihet qartazi se virtyti, dinjiteti dhe drejtësia janë ato veti të cilat i mundësuan Kastriotit të qëndrojë heroikisht para tiranit shumë herë më të fuqisht ushtarakisht dhe të korrë fitore të lavdishme në çdo betejë. *"Virtyti"* ishte bazamenti mbi të cilin u ngrit dhe krijua personaliteti i Kastriotit. Virtyti, drejtësia dhe respekti të trashëguara nga edukata e lashtë arbërore ishin mjetet kryesore me të cilat Kastrioti përgatiti ushtrinë e tij. Skënderbeu i trajtonte ushtarët e tij jo si robër por si bashkëluftëtarë dhe mbrojtës të lirisë së Epirit. Vërtetë ushtria osmane ishte shumë e madhe në numër dhe e përforcuar me teknikë luftarake, por ushtarëve osmanë u mungonte virtyti dhe morali njerëzor në fushëbetejë. Mungesa e moralit njerëzor ushtrinë osmane e shoqëronte çdo herë, kjo vërtetohet sidomos me barbarinë e shfrenuar të ushtarëve osmanë ndaj robërve të luftës sidomos të plagosurve. Kjo më së miri argumentohet me aktet barbare të ushtrisë osmane në betejën e Beratit në korrik të vitit 1455 kur ata pa fije turpi i masakruan robërit dhe të plagosurit e paaftë dhe të pambrojtur.

Me tutje Gjergji vazhdoi ta këshillojë të birin e tij Gjonin, me këta fjalë: "*Këto janë o drita ime, o biri im, porositë dhe mësimet që unë vetë i kam marrë e kam mësuar nga prindi im, mësuesi më i merituar* " (Barleti, 1508, f. 490). Madhështia e figurës së Kastriotit qëndron në të vërtetën që ai tregoi se ato këshilla të shtrenjta i kishte marrë nga prindërit e tij. Pra vlerën dhe rëndësinë e edukatës dhe kulturës arbërore Kastrioti ia atribuon jo vetvetes por paraardhësve të tij. Kastrioti me të drejtë potencon se mësimet e jetës i mori nga prindërit e vet. Skënderbeu vërteton se edukata dhe kultura arbërore është universale në aspektin kohor dhe i ka rrënjët thellë në historinë e lashtë të popullit arbëror. Edukata dhe kultura e lartë humane ishte transferuar nga prindërit te fëmijët me shekuj e milleniume nga gjenerata në gjeneratë.

Skënderbeu kishte një qëndrimi dinjitoz diplomatik jo vetëm në takimet me liderët dhe mbretëritë e vendeve aleate por edhe në negociata me delegacionet osmane. Gjate bisedave të shumta me të deleguarit e sulltanit, Ai ishte vigjilent, i matur dhe asnjëherë jo vetëm nuk iu frikësua kërcënimeve të sulltanit, por as nuk u lëkund fare ndaj ofertave marramendëse të tij.

Rëndësia e këtyre fjalive qëndron po ashtu në atë se si Gjergji e porosiste të birin e tij jo vetëm që këto këshilla t'i zbatojë në jetë, por ato t'i transferojë te fëmijët e tij në të ardhmen. Kështu këto këshilla të çmueshme sugjeronte Kastrioti, duhet të barten nga një brez në tjetrin me qëllim jo vetëm që gjeneratat e reja të edukohen por mbi të gjitha, që kultura dhe edukata tradicionale e popullit tonë të lashtë të mbijetojë duke u transferuar nga prindërit te fëmijët e tyre.

Skënderbeu ishte një njohës shumë i mirë i dinakërisë osmane dhe gjithashtu jep këshilla shumë të vlefshme për arbërit duke porositur se strategjia politike osmane para së gjithash mbështetet në formulën "përçaj e sundo". Kastrioti i jep një vend të posaçëm kësaj strategjie famëkeqe dhe potenconte se osmanët para së gjithash janë të prirur në mbjelljen e përçarjen në mes princave të krishterë dhe i gjithë suksesi i tyre është rezultat i kësaj politike degresive. Në fund Kastrioti dha porosinë e cila ishte mësim mbi mësimet për arbërit: ***"Luftoni gjithmonë të bashkuar"*** (Barleti, 1508). Kjo porosi ruhet e freskët në mendjen e popullit shqiptar dhe kujtohet me respekt të veçantë. Kjo këshillë është një porosi e shenjtë e lënë nga heroi ynë, e cila u bart me krenari ndër shekuj nga një brez në tjetrin deri në ditët tona. ***"Jeni të bashkuar"*** është formula e vetme e cila u mundësoi jo vetëm shqiptarëve por të gjithë popujve liridashës të mbijetojnë dhe arrijnë fitoren e lirisë. Në jetën reale kjo formulë shumë herë është vërtetuar se vetëm kur një komb është i bashkuar dhe lufton e punon drejt një qëllimi ai arrin jo vetëm të mbijetojë por edhe mund të bëhet një faktor i rëndësishëm vendimmarrës në përmasat rajonale e më gjerë.

Pas përfundimit të dhënies së këshillave epokale, më në fund më 17 Janar 1468, ***Gjergj Kastrioti kaloi në përjetësi!*** Më 17 Janar të vitit 1468 Kastrioti u shndërrua në engjëll dhe fluturoi mbi Krujën legjendare. Engjëlli u ngrit lart në qiell dhe me krahët e tij vigan mbuloi gjithë Arbërinë. Vepra e lavdishme e Kastriotit u fut thellë në mendjet dhe zemrat shqiptare dhe do të jetojë për jetë të jetëve. *Zoti e bekoi përjetësisht Kastriotin tone te Madh!*

3. VEPRA E KASTRIOTIT BAZAMENT I VETËDIJËS KOMBËTARE

Kombi shqiptar ndihet krenar jo vetëm se i ka rrënjët në lashtësinë e epokave iliro-pellazge por mbi të gjitha sepse vetëdija kombëtare është krijuar, ndërtuar dhe kultivuar mbi veprat e sublimet e figurave më të njohura të historisë së njerëzimit që nga Aleksandri i Madh e deri te Gjergj Kastrioti si dhe të dijetarëve më të njohur të antikës. Themelet e forta të vetëdijes shtet-formuese të skalitura nga dijetarët dhe gjeneralët më të njohur të historisë u mundësuan paraardhësve arbëror-epirot të bëjnë vepra të paharruara dhe stimuluan arbërit dhe shqiptarët t'i sfidojnë sulmet e shumta gjatë gjithë historisë deri në ditët tona.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 165

tregim

Detyrimi

Nga **SHAQIR SKARRA**

Në sistemin socialist, taksat bujqësore, quheshin detyrime. Me siguri, ky term i ri, ishte një huazim që si shumë të tjerë, hynë në gjuhën shqipe dhe e "pasuruan" atë me fjalë të "reja" që për të gjetë kuptimin e tyre, u bë i domosdoshëm fjalori.

Në vitet `50, për bujqit, u dekretua një detyrim shtesë mbi tokën. Në fakt ai ishte blegtoral dhe përfshinte mishin, leshin dhe vezët. Paradoksi për bujqit qëndronte që kjo taksë e re, i ngarkohej tokës dhe ishte llogaritur në kurriz të saj. Bujqit e patën "pranuar" detyrimin për bereqetin dhe tatim fitimin dhe u mësuan me të. Detyrimi i ri që toka duhej të paguante edhe mishin, leshin dhe vezët, u dukej absurde dhe nuk pranohej me logjikën e tyre.

Në çdo fillim viti shpërndaheshin fletët e reja të detyrimit. Atë vit që u aplikua për herë të parë detyrimi i ri shtesë, pati reagime dhe protesta nga bujqit. Kështu ndodhi edhe në krahinën malore të Brinjës. Kur i deleguari i Komitetit të rrethit erdhi të shpërndaj fletët e detyrimit, bujqit malësor, nuk pranuan ti marrin dhe kundërshtuan me plot gojën. Në asnjë mbretëri, nuk ishte parë e dëgjuar ky bidat i ri, që toka bëkërka mish, lesh dhe vezë. Hokatari Cen Roka, me fletën e detyrimit në dorë, ju drejtua të deleguarit:

-Shoku i deleguar! A mundet të na thoni se në ç`vend të botës, toka prodhon edhe drithëra, edhe mish, edhe lesh, edhe vezë? Nëse ekziston ky vend, na sillni rasatin e tyre dhe ta provojmë edhe ne në tokat tona...

Ironia e Cen Rokës, e zemëroi keq të deleguarin, i cili me t`u kthyer në Komitet, raportoi se malësorët e Brinjës, ishin kundër detyrimit të ri dhe nuk pranuan të marrin fletëdetyrimet. Ai nuk harroi të përmendi edhe ironinë e Cen Rokës. Dy ditë më vonë, hokatarit Cen Roka i vunë hekurat dhe e rrasën brenda për ta bërë si shembull.

Edhe pse shteti mori masa drastike deri në sekuestrime dhe arrestime, gjendja në këtë zonë, mbeti problematike. Komiteti i Partisë i rrethit, bëri me dije Presidentin e Republikës dhe kërkoi ndihmën e tij se Brinjasi ishte jo vetëm vendlindja, por edhe zona e tij elektorale. Kjo e solli presidentin në Brinjas.

Natën e parë që ai mbërriti këtu, i shoqëruar nga suita e tij, u bëri konak Liman Lisi që ishte edhe sekretari i partisë për zonën. Presidentin e shoqëronte edhe shkrimtari S.D, një personalitet i letrave dhe i politikës.

I zoti i shtëpisë, veç berrit që preu dhe darkës me të gjitha të mirat, pati thirrë edhe disa këngëtarë të ri me çifteli, për ta bërë darkën sa më festive. Shkrimtari S. u kërkoi këngëtarëve të këndonin ndonjë këngë të vjetër që bënte fjalë për krahinën e tyre. Ata ja plotësuan dëshirën dhe kënduan këngën e "Sufë Murrës" të vrarë nga turqit. Shkrimtarit i pëlqeu dhe i la mbresa të thella kjo këngë epike, tekstin e së cilës e hodhi në bllok. Pyeti:

-A dini të më thoni pse u vra Sufë Murra?

Asnjëri nga të pranishmit që ishin në moshë të re, nuk e dinin të vërtetën. Shkrimtarit i mbeti kalemi në dorë. Ndërhyri i zoti i shtëpisë:

-Kam komshi plakun Zenel Lokën, i cili bashkë me Sufë Murrën ka humbur edhe gjyshin e tij. Nëse nuk e keni bezdi, shkoj e jua sjellë tani.

Presidenti e njihte mirë Zenel Lokën, sepse kishte shërbyer do kohë, si roje personale e atit të tij. Urdhëroi:

-Shkoni e silleni. Miku im është i interesuar të dijë hollësirat për këtë këngë.

Zenel Loka, hyri pa u ndjerë dhe u ul në fund të odës. Shkrimtarit, i bëri përshtypje pamja e tij. Ju duk tejet i plakur, i lodhur dhe i drobitur. Nuk shpresonte që ky burrë sa një grusht do të ja plotësonte kershërin e tij. Pas përshëndetjes, e pyeti:

-A din të më thuash, pse u vra Sufë Murra?

Plaku, u mendua një hop dhe u përgjigj:

-Sufë Murrën e vrau turku, shok, se ai nuk pranonte të paguante mish, lesh e vezë!...

Përgjigja e Zenelit, ra si bombë në atë mjedis. Të pranishmit ja ngulën shikimin të shastisur, a menduan se plaku i gjori paska lajthitur. Presidenti i shfryu me inat:

-Ç'po na prrallis kështu? Mos mendon se do të mbajë krahun se i ke shërbyer babës tim? Gabohesh. Për sa thatë, nesër në mëngjez do të var me dorën time në degën e manit të Liman Lisit...

-Do ta dijë shumë për nder nëse e bën këtë- pranoi i qetë plaku.

Ndërhyri shkrimtari me të butë:

-Ta marrim shtruar Zenel! Unë ju pyeta për kohën kur u vra Sufë Murra, se kjo këngë ka vlera historike. Unë desha të mësoj arsyet që e çuan në këtë vrasje, prandaj të munduam sonte.

Fjalët e këtij burri të urtë që fliste shtruar, e "zbutën" Zenelin, i cili ndjeu respekt për të. U përgjigj:

-Sufë Murra u vra se nuk pranoi ti paguante turkut detyrimet: xhelepin, vergin, të dhjetën... dhe nuk ja dha djemtë nizam.

Shkrimtari u mor një copë herë me Zenelin rreth kësaj kohe dhe mbeti i kënaqur me të dhënat që i dha ai. Shkrimtarin e habiti ky plak i drobitur, por mendjen e kthjellët dhe me një memorie për të ja patur zili.

Presidenti, kur vuri se Zeneli mbaroi punë me shkrimtarin, ju kthye përsëri shpotis së Zenelit për detyrimin. E pyeti:

-Si e pate atë muhabetin shpotitës për mishin,leshin e vezët? A e din se për atë punë kam ardhë deri këtu?

-Po më ardhka keq për mundin që paske bërë- e ironizoi Zeneli. -Ky detyrim na ka bërë të flasim me vete, ta shohim në ëndërr, se nuk na mbushet kaptina për këtë bidat të ri.

Presidenti ngriti tonin:

-Lerini ëndërrat, shlyeni detyrimin ndaj shtetit. Unë nuk kam ardhë këtu t`u lutem e t`u bëjë rixha dhe as të ju mbushi kaptinën tuaj se toka nuk prodhon mish, lesh e vezë. Jam këtu që ju detyrimisht duhet të shlyeni këto detyrime.

Zenel Loka nuk pati dëshirë t`a zgjasi më tej muhabetin. Sapo bëhej gadi të ngrihej, kryetari i Komitetit të rrethit e pyeti:

-Ti Zenel a ke ndër mend të shlyesh detyrimet?

-Jo shoku kryetar!

-Pse nuk dashke? - vazhdoi kryetari.

-Jo se nuk dua, por nuk kam me se ti shlyej.

Presidenti ndërhyri përsëri:

-Mos na u shtir si shpirt i keq. I ke mundësitë për ti paguar, bile me një këmbë dhe qysh nesër.

Ky plak i vogël sa një grusht, kishte një kurajo që të habiste. Shkrimtari, shihte tek Zeneli, përfaqësuesin tipik të malësorit trim e të palodhur, siç kishin qenë personazhet e këngës. Zeneli, duke ju shmangur presidentit, ju drejtua kryetarit:

- E lamë fjalën në gjysëm pse nuk kam mundësi të paguaj. Po jua rrëfej: Kam gjashtë dynym tokë në të thatë, dy dhi, një gomar dhe tri pula. Kjo është pasuria ime. Në fletën e detyrimeve që ju keni sjellë, unë i detyrohe shtetit 220 kg bereqet, 60 kg mish, 10 kg lesh, 58 kokrra vezë dhe 4800 lek tatim fitim. Të gjitha këto janë në shpinë të tokës, e cila nuk më siguron as bukën e përditshme, jo më të prodhojë mish, lesh e vezë. Ta zëmë se do ti paguaj. Dy dhitë e mia nuk i kanë 40 kg mish. Kërkoni lesh. Po të qethi dy dhitë e mia dhe gomarin, nuk i mbushin as dy okë. Sa për vezët, ato tre pula të flamosura, që kur kanë marrë vesh se toka bëka vezë, janë zemëruar dhe nuk pjellin më...

- Mjaft na përrallise...e ndërpreu presidenti, detyrimi është ligj dhe do t`a paguash se s`bën.

- Po sikur të mos e paguaj?- pyeti plaku.

Presidenti e humbi durimin.

- Nuk kam ndër mend të merre gjithë natën me ty. Zgjidh: o detyrimin ose burgun. Me ty do ta nisi i pari që të bëjë shembull për gjithë zonën. Me atë llapë helm që ke e me ato mendime armiqësore që ke në kokë, në burg do të përfundosh...

Debati, mori kthesë keq. Zenel Loka, pa e prishë gjakun, i qetë, futin kutinë e duhanit në xhep, u ngrit dhe që nga dera, ju drejtua kryetarit të shtetit:

- Burgu për burra është. E ke lënë një fjalë peng, mbaje: jep urdhër që nesër në sabah të më varin në degën e manit të Liman Lisit. Shembull më të mirë për të mbledhë detyrimet nuk do të gjeni. Si të keni mbaruar punë me mua, shkoni në Tiranë e merruni me punët e shtetit, se është duke më ardh' keq që Presidenti i Republikës, paska ardhë të mbledhi mishin, leshin dhe vezët...

- Dil jashtë, shporru që këtej- u çua i tërbuar presidenti.

Plaku doli pa u ndjerë nga dhoma.

Të nesërmen, para popullit i vunë prangat.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË!

dërgo email në:
rrugaearberit@gmail.com

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Veliu Bici lindi më 2 korrik të vitit 1938 në fshatin Strikçan të Dibrës.

Ndërron jetë **Veli Bici**, *Doktor i Shkencave Filologjike*

Më 16 dhjetor të vitit të kaluar vjen nga përtej Oqeanit në Tiranë një lajm i hidhur e trondítës. Kishte mbyllur sytë jashtë atdheut njëherë e përgjithmonë, në mënyrë të papritur e të parakohshme, kolegu ynë, mësuesi e bashkëpunëtori shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, dr. Veli Bici.

Veliu lindi më 2 korrik të vitit 1938 në fshatin Strikçan të Dibrës. Arsimin fillor e shtatëvjeçar i kreu në fshatin e tij të lindjes dhe në Shupenzë, ndërsa arsimin e mesëm e mbaroi në viti 1958 në Shkollën Pedagogjike të Peshkopisë. Me përfundimin shkollës së mesme ndoqi drejtpërdrejt arsimin e lartë në vitet 1958-1962, në degën gjuhë shqipe e letërsi në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Në vitet e shkollimit parauniversitar e universitar u dallua për rezultate shumë të mira në të gjitha lëndët shkollore.

Sapo mbaroi studimet e larta u emërua mësues e drejtor në shkollën 7-vjeçare të Maqellarës në rrethin e Dibrës, ku u dallua jo vetëm si mësues e metodist i aftë, por dhe si organizator i zoti në një shkollë me tradita ku jepnin mësim mësues me përvojë të gjatë pedagogjike e që atë vit punonin nën drejtimin e këtij mësuesi të ri, që vinte në drejtim të shkollës së tyre drejtpërdrejt nga bankat e universitetit, ku kishte marrë një përgatitje solide shkencore, por edhe e pedagogjike, në sajë të lëndëve përkatëse dhe të praktikave pedagogjike nëpër shkollat e Tiranës, që në atë kohë ishin të detyrueshme si pjesë e përgatitjes për mësuesit e ardhshëm. Ç'e shtynte mësuesin e ri të punonte me aq zell në profesionin për të cilin ishte përgatitur në auditorët e universitetit? Thjesht pasioni për të hyrë në të fshehtat e këtij profesioni, që përgatiste brezat e ardhshëm me dije e me kulturë sa më të gjerë, përpjekja për të vënë në jetë dijet e fituara nga shkolla, ndërgjegjja e dëshira për t'u dhënë nxënësve të tij më të mirën në lëndët e gjuhës dhe të letërsisë, duke i bërë orët e mësimeve sa më të larmishme e interesante.

Një vit më vonë Seksioni i Arsimit dhe i Kulturës i Rrethit, duke parë aftësitë dhe përgatitjen e tij, e tërhoqi në gjirin e tij si inspektor metodist. Në këtë detyrë ai qëndroi deri në vitin 1969. Gjatë 6 viteve që punoi në Seksionin e Arsimit e të Kulturës të Peshkopisë, ai inspektoi e udhëzoi thuajse të gjitha shkollat e Dibrës e të Bulqizës. Gjatë këtyre viteve u shqua për kompetencë të dallueshme në fushën e arsimit, ku me përgatitjen e përvojën e tij dhe me njohuritë e pasura gjuhësore, solli një ndihmesë të mirë në mbarëvajtjen e arsimit në Dibër dhe në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet udhëzimeve që jepte gjatë inspektimeve të shumta e kontrolleve pothuajse në të gjitha shkollat e Dibrës e të Bulqizës. Të mos harrojmë se Veliu, ashtu si dhe gjithë aparati i arsimit në atë kohë, kanë përfituar shumë, në mënyrë të jashtëzakonshme, nga shefi i Seksionit të asaj kohe, Mësuesi i Popullit, Selim Alliu, përgatitja profesionale, pedagogjike e metodike e të cilit ishte e një shkalle shumë të lartë. Selim Alliu ishte një nga pedagogët, në kuptimi e mirëfilltë të termit, i cili dijet dhe përvojën e grumbulluar nëpër vite, nuk i mbante për vete, por me dashamirësi të jashtëzakonshme ua kalonte jo veetëm bashkëpunëtorëve të tij në aparatin e arsimit në qendër, por dhe çdo arsimtari që takonte në vëzhgimet e shpeshta nëpër shkolla. Në këtë kuptim, në ngritjen e aftësimin e mëtejshëm të punës së Veliut dhe kolegëve të tij si specialistë të arsimit ka lënë gjurmë dhe përkujdesja e vazhdueshme e këtij mjeshtri të profesionit të mësuesisë.



Në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave Veli Bici u inkuadrua shumë shpejt në jetën shkencore në fushën e terminologjisë. Ai ka marrë pjesë si gjuhëtar në komisionet e hartimit të fjalorëve terminologjikë, në hartimin e disa veprave të rëndësishme të leksikografisë terminologjike. Ai ka bashkëpunuar në hartimin e një vargu fjalorësh terminologjikë të fushave të ndryshme, përfshirë edhe ato të terminologjisë ushtarake. Gjatë viteve të punës në Institut ai ka marrë pjesë dhe në mjaft ekspedita gjuhësore në terren për mbledhjen e terminologjisë popullore të fushave të ndryshme. Në vitin 1980 ka dhënë mësim në kurset verore tek arbëreshët i Italisë për gjuhën dhe kulturën shqiptare, duke shkëmbyer dhe përvojat e tyre me ato të kolegëve arbëreshë. Me kujdesin e tij, u krijua mbi baza shkencore kartoteka e emërtimeve në shkallë vendi. Tezën e doktoratës me titull *Zhvillimi i terminologjisë së gjeografisë në gjuhën shqipe deri në vitin 1944*, e mbrojti me sukses në vitin 1996 dhe mori dhe gradën shkencore "Doktor i shkencave".

Në vitin 1969 Veli Bici u përfshi në programet dhe projektet shkencore të departamentit të Terminologjisë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Gjatë viteve që punoi në Peshkopi ai ka qenë një bashkëpunëtor i jashtëm i rregullt i Institutit, duke mbledhur dhe shpjeguar me qindra fjalë të rralla, që sot gjenden në Kartotekën e Leksikut të Shqipes të këtij Instituti. Në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave ai u inkuadrua shumë shpejt në jetën shkencore në fushën e terminologjisë. Ai ka marrë pjesë si gjuhëtar në komisionet e hartimit të fjalorëve terminologjikë, krahas emrave të njohur të kësaj fushe si Lirak Dodbiba, Ferdinand Leka, Emil Lafe, Sofika Morcka e Hëna Pasho, në hartimin e disa veprave të rëndësishme të leksikografisë terminologjike. Ai ka bashkëpunuar në hartimin e një vargu fjalorësh terminologjikë të fushave të ndryshme të tilla si *Fjalor i termave të histologjisë dhe të embriologjisë, Fjalor i termave të ekonomisë politike, Fjalor i termave statistikës, Fjalor i termave financës dhe kontabilitetit, Fjalor i termave të së drejtës, Fjalor i termave të tregtisë së jashtme, Fjalor i termave të planifikimit, Fjalor i termave të gjeografisë, Fjalori i termave të anatomisë, Fjalori i termave të obstetrikës dhe gjinekologjisë, Fjalori i termave të stomatologjisë* etj. Ka qenë në të njëjtën kohë dhe anëtar i redaksisë në veprën *Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë*. Veli Bici u përfshi edhe në komisionet për hartimin e disa fjalorëve terminologjikë ushtarakë nën drejtimin e prof. Hasan Çipurit. Gjatë viteve të punës në Institut ai ka marrë pjesë dhe në mjaft ekspedita gjuhësore në terren për mbledhjen e terminologjisë popullore të fushave të ndryshme.

Në vitin 1980 bashkë me prof. Emil Lafen ka dhënë mësim në kurset verore tek arbëreshët i Italisë për gjuhën dhe kulturën shqiptare, duke shkëmbyer dhe përvojat e tyre me ato të kolegëve arbëreshë.

Në vitet 1983-1991 ai transferohet në aparatin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, si kryetar i Degës së Emërtimeve, degë që merrej me studimin e emrave të fshatrave, të rrugëve, institucioneve etj. Për këtë qëllim, edhe me kujdesin e tij, u krijua mbi baza shkencore kartoteka e emërtimeve në shkallë vendi, e cila në vitet e mëvonshme u bë pjesë e kartotekave të Institutit.

Ndërkohë që punonte bashkë me ekipet e gjuhëtarëve dhe të specialistëve për hartimin e veprave të ndryshme, nuk la pas dhe kualifikimin e tij duke dhënë me sukses të gjitha provimet e kualifikimit pasuniversitar, por dhe duke punuar në mënyrë sistematike nën drejtimin e prof. Emil Lafes për tezën e doktoratës me titull *Zhvillimi i terminologjisë së gjeografisë në gjuhën shqipe deri në vitin 1944*, të cilën e mbrojti me sukses në vitin 1996 dhe mori dhe gradën shkencore "Doktor i shkencave".

Ndërkohë emri i Veli Bicit shfaqet dhe në shtypin shkencor dhe në atë periodik, ku ka botuar artikuj shkencorë e divulgativë, recensione etj. në revista shkencore, në shtypin e përditshëm ose në përmbledhje të ndryshme, si në revistat *Studime filologjike, Gjuha jonë* e në shtypin e përditshëm, në gazetat *Mësuesi, Zëri i popullit* etj.

Veliu ishte në të njëjtën kohë dhe një bashkëpunëtor i zellshëm e një shok e mik i dashur me të gjithë kolegët dhe në të gjitha institucionet ku ka punuar ai ka lënë përshtypjet më të mira. Për ne që kemi punuar e jetuar aq shumë me njëri-tjetrin humbja e një miku e kolegu të vlefshëm ishte një dhimbje e madhe, ashtu si dhe për familjen e tij, që humbën në dhe të huaj njeriun e tyre më të dashur.

V. Bici krijoi familjen e vet duke u martuar me mësuesen e dalluar Hatixhe Gjoka-Bici. Të dy rritën e edukuan dy djem, që e kanë mbajtur lart emrin e mirë të prindërve të tyre.

Veliu do të kujtohet gjithmonë me mirënjohje për punën e vyer që ka lënë, për kujtimet që na lidhin me të jo vetëm ne si kolegë e shokë, por dhe shumë arsimtarë e bashkëpunëtorë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Ai do të mbetet si shembull **i një arsimtari pasionant e i një bashkëpunëtori modest e kokulur që punoi me përkushtim kudo që u angazhua gjatë gjithë jetës së tij.**

Prof. Enver Hysa
Prof. Emil Lafe
Prof. Remzi Përnaska

Veli Bici u shqua për kompetencë të dallueshme në fushën e arsimit, ku me përgatitjen e përvojën e tij dhe me njohuritë e pasura gjuhësore, solli një ndihmesë të mirë në mbarëvajtjen e arsimit në Dibër dhe në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet udhëzimeve që jepte gjatë inspektimeve të shumta e kontrolleve pothuajse në të gjitha shkollat e Dibrës e të Bulqizës. Veliu, ashtu si dhe gjithë aparati i arsimit në atë kohë, kanë përfituar shumë, në mënyrë të jashtëzakonshme, nga Mësuesi i Popullit Selim Alliu...

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

Foto Majtas tregon pamjen e parë të faqes zyrtare në Facebook të gazetës *Rruga e Arbërit*

NE nuk jemi gazetë e pavarur, NE jemi gazetë e lirë
dhe pavarësia dhe liria jonë garantohet
vetëm nga mbështetja e lexuesve...

BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.

Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

cyan magenta yelloë black